




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI"

**RREGULLORE E ORGANIZIMIT DHE VEPRIMTARISË MËSIMORE,
KËRKIMORE SHKENCORE E UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI"**

MIRATUAR:
SENATI AKADEMIK
KRYETARI
Prof. dr. ALI JASHARI



**RREGULLORE E ORGANIZIMIT DHE VEPRIMTARISË MËSIMORE,
KËRKIMORE SHKENCORE E UNIVERSITETIT “FAN S. NOLI”**

TABELA E PËRMBAJTJES

KREU I	
PARIME TË PËRGJITHSHME	8
Neni 1	8
Baza ligjore	
Neni 2	8
Juridiksioni	
 KREU II	
ORGANIZIMI I UNIVERSITETIT	8
Neni 3	8
Struktura organizative	
Neni 4	9
Organizimi i brendshëm	
Njësitë kryesore	
Neni 5	12
Njësitë bazë	
Neni 6	13
Hapja, riorganizimi, mbyllja e njësive kryesore dhe bazë	
Neni 7	14
Përbërja dhe funksionet e Senatit Akademik	
Neni 8	15
Mbarimi i mandatit të anëtarit të Senatit Akademik	
Neni 10	16
Komisionet e Përhershme të UK-së	
Neni 11	16
Rektorati	
Neni 12	17
Dekanati	
Neni 13	17
Këshilli i Etikës	
Neni 14	18
Bordi Këshillimor	
Neni 15	18
Rektori	
Neni 16	18
Zëvendësrektori/ët	
Neni 17	19
Largimi nga detyra i zëvendësrektorëve	
Neni 18	20
Dekani	
Neni 19	21
Zëvendësdekani	
Neni 20	21
Drejtuesi i njësive bazë	
Neni 21	22
Drejtuesi i Grupit Mësimor dhe Kërkimor	
Neni 22	23
Elementët përbërës të raportimit vjetor	

KREU IV	
ORGANET DHE AUTORITETET DREJTUESE ADMINISTRATIVE	26
Neni 23	26
Bordi i Administrimit	
Neni 24	26
Funksionet e Bordit të Administrimit	
Neni 25	27
Mbarimi i parakohshëm i mandatit të anëtarit të Bordit të Administrimit	
Neni 26	27
Përzgjedhja dhe statusi i Administratorit të UK-së	
Neni 27	28
Funksionet e Administratorit të UK-së	
Neni 28	28
Përzgjedhja, statusi dhe funksionete Administratorit të Njesisë Kryesore	

KREU V	
PERSONELI AKADEMIK, NDIHMËS AKADEMIK DHE ADMINISTRATIV	29
Neni 29	29
Të përgjithshme	
A-PERSONELI AKADEMIK, NDIHMËSAKADEMIK DHE ADMINISTRATIV	
Neni 30	29
Kategoritë e personelit akademik	
Neni 31	30
Statusi dhe trajtimi i veçantë i personelit akademik	
Neni 32	32
Punësimi i personelit akademik	
Neni 33	33
Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e personelit akademik	
Neni 34	34
Personeli akademik i ftuar	
Neni 35	34
Veprimtaria që kryen personeli akademik	
Neni 36	35
Ngarkesa mësimore vjetore për personelin akademik	
Neni 37	38
Viti akademik sabbatik	
Neni 38	38
Kohëzgjatja e punësimit të personelit akademik	
Neni 39	38
Masat disiplinore për personelin akademik	
Neni 40	39
Procedura për dhënien e masave disiplinore	
Neni 41	39
Personeli ndihmësakademik	
Neni 42	40
Personeli administrativ	
Neni 43	40
Zgjidhja e kontratës së punës	

B. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PUNONJËSIT NDIHMËSAKADEMIK DHE ADMINISTRATIV. DISIPLINA NË PUNË.....	41
Neni 44	41
Të drejtat e punonjësit ndihmësakademik dhe administrativ	
Neni 45	41
Detymimet e punonjësit ndihmësakademik dhe administrativ	
Neni 46	42
Shkeljet disiplinore	
Neni 47	42
Masat disiplinore	
KREU VI	
PROGRAMET E STUDIMIT DHE ORGANIZIMI I TYRE	42
Neni 48	42
Format e studimeve dhe pranimi i studentëve	
Neni 49	43
Hapja dhe riorganizimi i programeve të studimit	
Neni 50	43
Dokumentacioni për hapjen e programeve të reja të studimit për të gjitha ciklet	
Neni 51	45
Hapja e programeve të përbashkëta të studimit	
Neni 52	45
Procedura për shqyrtimin e aplikimeve për hapjen e programeve të reja të studimit të të gjitha cikleve	
Neni 53	46
Dokumentacioni për riorganizimin e programeve të studimit të të gjitha cikleve	
Neni 54	46
Procedura e shqyrtimit të riorganizimit të programeve të studimit	
Neni 55	47
Procedurat për mbylljen e programeve të studimit të të gjitha cikleve	
Neni 56	47
Programet e studimit në UK	
Neni 57	48
Programet e studimit me karakter profesional	
Neni 58	48
Programet e Ciklit të Parë të Studimeve	
Neni 59	48
Pranimi në Ciklin e Parë të Studimeve	
Neni 60	49
Programet e Ciklit të Dytë të Studimeve	
Neni 61	49
Pranimi në Programet e Ciklit të Dytë të Studimeve	
Neni 62	49
Programet e ciklit të tretë të studimeve	
Neni 63	50
Kriteret e posaçme për hapjen e programeve të reja të ciklit të tretë të studimit “Doktoratë”	
Neni 64	51
Personeli akademik i programit të studimit të ciklit të tretë “Doktoratë”	
Neni 65	51
Organizimi i programit të studimit të ciklit të tretë “Doktoratë”	

Neni 66	52
Kriteret për fitimin e gradës shkencore “Doktor”	
Neni 67	54
Kriteret e posaçme për hapjen e programeve të reja të ciklit të tretë të studimit, “Master Ekzekutiv”	
Neni 68	55
Personeli akademik i programit të studimit të ciklit të tretë “Master Ekzekutiv”	
Neni 69	55
Organizimi i programit të studimit të ciklit të tretë “Master Ekzekutiv”	
Neni 70	56
Pranimi në programet e ciklit të tretë të studimeve	
Neni 71	56
Programet e përbashkëta të studimit	
Neni 72	57
Programet e studimeve të formimit të vazhduar	
Neni 73	57
Programet e studimit në fushën e mësuesisë	
Neni 74	57
Ndjekja e një programi të dytë studimi	
Neni 75	58
Profili i programit	
Neni 76	58
Ndryshimi i programeve të studimit	
Neni 77	59
Gjuha e studimeve	
Neni 78	59
Kohëzgjatja e studimeve	
Neni 79	59
Transferimi i studimeve	
Neni 80	61
Elementët e programeve të studimit të ofruara nga UK-ja	
Neni 81	61
Kreditet sipas ETSC-së	
Neni 82	61
Kontrolli i dijeve dhe instrumentet e vlerësimit	
Neni 83	62
Kontrolli përfundimtar i dijeve me provim	
Neni 84	62
Objektivat formuese dhe kompetencat profesionale	
Neni 85	63
Veprimtaritë formuese dhe përbërësit mësimore të programit të studimit	
Neni 86	63
Kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi	
Neni 87	64
Plani mësimor	
Neni 88	65
Kuotat e pranimit	
Neni 89	65
Grupet mësimoretë studentëve	
Neni 90	66

Programi lëndor (syllabuset)	
Neni 91	66
Diploma dhe suplementi	
Neni 92	67
Viti akademik dhe organizimi i mësimdhënies	
Neni 93	67
Frekuentimi	
Neni 94	67
Orari i mësimit	
Neni 95	67
Regjistri i pedagogut	
KREU VII	
PROCEDURAT E VLERËSIMIT TË STUDENTËVE	68
Neni 96	68
Organizimi i provimeve	
Neni 97	68
Provimet me gojë	
Neni 98	69
Provimet me shkrim	
Neni 99	69
Dokumentacioni i provimit	
Neni 100	69
Organizimi i provimit	
Neni 101	70
Kohëzgjatja e provimeve	
Neni 102	70
Mbarëvajtja e provimit	
Neni 103	71
Studenti mbetës dhe ankimimi për provim	
Neni 104	71
Sistemi i vlerësimit	
Neni 105	71
Njohja me rezultatet e provimit	
Neni 106	72
Riprovimet dhe mbartja e provimeve	
Neni 107	72
Mobilitetet kombëtare dhe ndërkombëtare	
Neni 108	72
Diplomimi	
Neni 109	73
Tërheqja e diplomës	
Neni 110	73
E drejta e studentit për përmirësim note	
Neni 111	74
Detyrimet e studentit	
Neni 112	74
Rastet e shkeljeve dhe masat që merren ndaj studentit	
Neni 113	74
Regjistrimi i studentit	

Neni 114	75
Ndërprerja dhe rifillimi i studimeve	
Neni 115	75
Praktika profesionale	
Neni 116	75
Organizimi i praktikës profesionale	
KREU VIII	
KËRKIMI SHKENCOR	76
Neni 117	76
Kërkimi shkencor në UK	
Neni 118	76
Veprimtaritë kërkimore në UK	
Neni 119	77
Planifikimi dhe vlerësimi i veprimtarive kërkimore	
Neni 120	78
Vlerësimi periodik i veprimtarive kërkimore-shkencore të njëjësive bazë në UK	
Neni 121	80
Organizimi i vlerësimit	
Neni 122	80
Detyrat dhe përgjegjësitë gjatë procesit të vlerësimit periodik të kërkimit shkencor	
Neni 123	80
Organizimi i procesit të vlerësimit periodik të kërkimit shkencor	
KREU IX	
DISPOZITA TË FUNDIT	81
Neni 124	81
Rregulloret e Fakulteteve	
Neni 125	81
Interpretimi i Rregullores	
Neni 126	81
Miratimi dhe ndryshimi i Rregullores	

KREU I PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Baza ligjore

Rregullorja e Universitetit “Fan S. Noli”, këtu më poshtë UK, mbështetet në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në aktet nënligjore në zbatim të ligjit, si dhe në Statutin e UK-së.

Neni 2 Juridiksioni

Kjo Rregullore i bashkëngjitet Statutit të UK-së dhe e shtrin veprimin e saj mbi të gjitha njësitë përbërëse të universitetit.

KREU II ORGANIZIMI I UNIVERSITETIT

Neni 3 Struktura organizative

1. UK-ja përbëhet nga njësi kryesore, njësi bazë, njësi ndihmëse dhe njësi administrative.
2. UK-ja ofron programe studimi në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve si dhe programe studimi me karakter profesional.
3. Struktura e brendshme akademike dhe administrative në UK organizohet si më poshtë:
 - **Strukturat akademike në nivel institucioni janë :**
 - a. Senati akademik;
 - b. Rektorati;
 - c. Rektori;
 - d. Zëvendësrektori/ët.
 - **Strukturat akademike në nivel njësie kryesore janë :**
 - a. Asambleja e personelit akademik;
 - b. Dekanati;
 - c. Dekani;
 - d. Zëvendësdekani/ët.
 - e.
 - **Strukturat akademike në nivel njësie bazë janë :**
 - a. Drejtuesi i departamentit;
 - b. Grupet mësimore/kërkimore shkencore
 - **Strukturat administrative në nivel institucioni janë :**
 - a. Bordi i administrimit
 - b. Administratori
 - c. Drejtoria Ekonomike

- d. Drejtoria e Financës
 - e. Njësia e Auditimit të Brendshëm
- **Strukturat ndihmësakademike me karakter administrativ në nivel institucioni janë :**
 - a. Drejtoria e Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor
 - b. Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit
 - c. Koordinator i projekteve Erasmus+
 - d. Qendra e Formimit të Vazhduar
 - e. Qendra rinore dhe sportive
 - f. Asistent i Rektorit
 - **Strukturat ndihmësakademike me karakter administrativ në nivel njësie kryesore janë:**
 - a. Njësia për sigurimin e cilësisë
 - b. Sekretaria mësimore
 - c. Biblioteka e Fakultetit
 - d. Asistent i Dekanit
 - **Strukturat ndihmësakademike me karakter akademik në nivel njësie bazë janë janë :**
 - a. Laborantët
 - b. EDE- Ekonomia Didaktike Eksperimentale
 - **Strukturat ndihmësakademike me karakter administrativ në nivel njësie bazë janë :**
 - a. Sekretaritë në departament.

Neni 4

Organizimi i brendshëm

Njësitë kryesore

1. Fakulteti është njësia kryesore që bashkërendon mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fusha mësimore-shkencore të përafërta ose të ndërthurura.
2. Fakulteti drejtohet nga Dekani.
3. Fakultetet miratojnë kriteret e pranimit të studentëve, për secilin program studimi, bazuar në propozimet e njësisë bazë, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.
4. Veprimtaria e fakultetit rregullohet nga rregullorja e brendshme e tij, e cila miratohet me vendim të Senatit Akademik.
5. UK-ja përbëhet nga këto njësi kryesore:

A-FAKULTETI I BUJQËSISË

Autoritetet drejtuese:

1. Dekani
2. Zv. Dekani
3. Drejtuesi i njësisë bazë

Organe kolegjiale drejtuese:

1. Asambleja e personelit akademik të Fakultetit të Bujqësisë.
2. Dekanati

Organe të tjera kolegiale:

1. Komisione të Përhershme të Fakultetit të Bujqësisë.

Njësitë bazë:

1. Departamenti i Agrobiznesit
2. Departamenti i Agronomisë;
3. Departamenti i Agroushqimit

Strukturat ndihmësakadematike me karakter administrativ në nivel njësie kryesore:

1. Njësia për sigurimin e cilësisë
2. Biblioteka e Fakultetit të Bujqësisë;
3. Ekonomia Didaktike Eksperimentale
4. Sekretaria mësimore
5. Asistent i dekanit

Strukturat ndihmësakadematike me karakter akademik në nivel njësie bazë:

1. Laborantët
2. EDE- Ekonomia Didaktike Eksperimentale

B-FAKULTETI I EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË

Autoritetet drejtuese:

1. Dekani
2. Zv. dekanit
3. Drejtuesi i njësisë bazë

Organe kolegiale drejtuese:

1. Asambleja e personelit akademik të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë.
2. Dekanati

Organe të tjera kolegiale:

1. Komisione të Përhershme të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë.

Njësitë bazë

1. Departamenti i Edukimit;
2. Departamenti i Gjuhëve të huaja; (Grupi mësimor i Gjuhësisë)
3. Departamenti i Gjuhë-Letërsisë;
4. Departamenti i Histori-Gjeografisë

Strukturat ndihmësakadematike me karakter administrativ në nivel njësie kryesore:

1. Njësia për sigurimin e cilësisë
2. Biblioteka e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë;
3. Sekretaria mësimore
4. Asistent i dekanit

Strukturat ndihmësakademike me karakter administrativ në nivel njësie bazë:

1. Sekretar/e departamenti

C-FAKULTETI I EKONOMISË

Autoritetet drejtuese:

1. Dekani
2. Zv. Dekani
3. Drejtuesi i njësisë bazë

Organe kolegjinale drejtuese:

1. Asambleja e personelit akademik të Fakultetit të Ekonomisë.
2. Dekanati

Organe të tjera kolegjinale:

1. Komisione të Përhershme të Fakultetit të Ekonomisë.

Njësitë bazë

1. Departamenti i Financë-Kontabilitetit;
2. Departamenti i Menaxhimit;
3. Departamenti i Marketing-Turizmit.

Strukturat ndihmësakademike me karakter administrativ në nivel njësie kryesore:

1. Njësia për sigurimin e cilësisë
2. Biblioteka e Fakultetit të Ekonomisë
3. Sekretaria mësimore
4. Asistent i dekanit

Strukturat ndihmësakademike me karakter administrativ në nivel njësie bazë:

1. Sekretar/e departamenti

D-FAKULTETI I SHKENCAVE NATYRORE DHE SHKENCAVE HUMANE

Autoritetet drejtuese:

1. Dekani
2. Zv. Dekani/ët
3. Drejtuesi i njësisë bazë

Organe kolegjinale drejtuese:

1. Asambleja e personelit akademik të Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane
2. Dekanati

Organe të tjera kolegjinale:

1. Komisione të Përhershme të Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane

Njësiti bazë

1. Departamenti i Shkencave sociale;
2. Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës; (Grupi mësimor Informatikë-Fizikë)
3. Departamenti i Biologji-Kimisë;
4. Departamenti i Infermierisë

Strukturat ndihmësakademike me karakter administrativ në nivel njësie kryesore:

1. Njësia për sigurimin e cilësisë
2. Biblioteka e Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane
3. Sekretaria mësimore
4. Asistent i dekanit

Strukturat ndihmësakademike me karakter administrativ në nivel njësie bazë:

1. Sekretar/e departamenti

Strukturat ndihmësakademike me karakter akademik në nivel njësie bazë:

1. Laborant

Neni 5 Njësiti bazë

1. Departamenti është njësi bazë mësimore-kërkimore në UK, që përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore përkatëse. Ai është përgjegjës për programet e studimit që ofron.

2. Autoriteti më i lartë akademik i njësisë bazë është drejtuesi i saj.

3. Njësia bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore-botuese ose artistike, duke respektuar liritë akademike të personelit akademik.

4. Njësia bazë përbëhet nga të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademikë. Njësia bazë mund të ketë në përbërjen e saj edhe personel ndihmësmësimor.

5. Njësia bazë organizohet në grupe mësimore dhe në grupe të përhershme ose të përkohshme me karakter kërkimor-shkencor, në përputhje me nevojat e njësisë kryesore. Këto grupe përbëhen nga jo më pak se 5 anëtarë, personel akademik me kohë të plotë.

6. Organizimi përcaktohet me vendim të Senatit Akademik mbi bazën e propozimit të dekanatit përkatës.

7. Titullarët e grupeve duhet t'i përkasin kategorisë "Lektor" dhe përzgjidhen me konkurrencë të hapur, të drejtuar nga një komision *ad hoc*, i ngritur nga titullari i njësisë kryesore me propozim të drejtuesit të njësisë bazë. Drejtuesi i njësisë bazë (departamentit), i propozon autoritetit drejtues të njësisë kryesore emërimin e kandidatit të renditur në vendin e parë të listës nga komisioni *ad hoc*, për një periudhë deri në 4 vjet. Kriteret dhe procedurat e konkurrencës specifikohe në rregulloren e njësisë kryesore.

8. Departamenti mblidhet të paktën një herë në muaj dhe kryen këto funksione:
 - a. Mbikëqyr veprimtaritë mësimore - shkencore në departament, në përputhje me planifikimin vjetor;
 - b. Analizon, ndjek respektimin e programeve të mësimdhënies;

- c. Mbikëqyr realizimin e ngarkesës mësimore të personelit akademik përkatës;
- d. Për lehtësimin e veprimtarive të njësisë, organizohet në grupe të posaçme;
- e. Organizon analiza periodike për raste e aspekte të veçanta në departament;
- f. Propozon komisionet e provimeve dhe komisionet e diplomimit;
- g. Propozon pedagogët mbikqyrës të praktikës mësimore;
- h. Propozon kriteret për plotësimin e vendeve vakant në departament;
- i. Propozon dhe shpall temat e diplomave në ciklin e parë dhe ciklin e dytë të studimit;
- j. Miraton temat dhe pedagogët udhëheqës të diplomave;
- k. Ofron shërbime për të tretë, si dhe zhvillon veprimtari të tjera, sipas legjislacionit në fuqi;
- l. Çdo funksion tjetër të parashikuar në Statutin e UK-së dhe në këtë Rregullore.

Neni 6

Hapja, riorganizimi, mbyllja e njësive kryesore dhe bazë

Hapja e njësive kryesore, riorganizimi ose mbyllja e tyre bëhen me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, në bazë të propozimit të institucionit, pas miratimit të Senatit Akademik dhe të Bordit të Administrimit.

Për riorganizimin e IAL-së respektohet procedura e mëposhtme:

1. Kërkesa dhe dokumentacioni depozitohen në ministrinë përgjegjëse për arsimin e lartë. Nisma për riorganizimin e IAL-së merret nga vetë IAL-ja, me vendim të organeve kolegjiale të saj.
2. Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë, cakton ekspertë të jashtëm nga lista e ASCAL-it për vlerësimin e dokumentacionit. Shpenzimet e ekspertit paguhen nga kërkuesi.
3. Eksperti/ASCAL-i brenda tri javëve dorëzon raportin e vlerësimit në MASR. Në rastet kur dokumentacioni është i paplotë, apo kur konstatohen mangësi/pasaktësi, ministria përgjegjëse për arsimin e lartë njofton subjektin për plotësimin e tij brenda dy javëve nga marrja e raportit të vlerësimit.
4. Në rast se tri javë pas njoftimit, dokumentacioni nuk plotësohet, kërkesa refuzohet dhe dosja e aplikimit arkivohet. Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë, në rastin e vlerësimit negativ, njoftonme shkrim institucionin kërkuar për vendimin e tij të argumentuar dhe praktika arkivohet.
5. Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë, në rast të vlerësimit pozitiv, nxjerr aktin e riorganizimit të institucionit të arsimit të lartë jo më vonë se 3 muaj pas dorëzimit të dokumentacionit.
6. Një IAL organizohet në njësi përbërëse kryesore dhe bazë, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për arsimin e lartë, duke respektuar llojin e institucionit.
7. Çdo njësi kryesore duhet të ketë, të paktën, tre njësi bazë, që grupojnë disiplina mësimore të përafërta ose të ndërthurura dhe që përfshijnë fusha kërkimi respektive.
8. Njësia bazë duhet të ketë në përbërje të saj, të paktën, shtatë anëtarë me kohë të plotë, si personel akademik, ndër të cilët, të paktën tre, duhet të jenë me gradë shkencore ose titull akademik.
9. Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për çdo program studimi.

KREU III

DETYRAT DHE FUNKSIONET E ORGANEVE DREJTUESE AKADEMIKE TË UK-së

Neni 7

Përbërja dhe funksionet e Senatit Akademik

1. Senati Akademik është organi më i lartë kolegjal vendimmarrës i UK-së, i cili përcakton politikat e zhvillimit të institucionit, programon, bashkërendon, drejton dhe kontrollon veprimtaritë e mësimdhënies e të kërkimit shkencor, si dhe vlerëson efikasitetin e tyre.
2. Kryetar i Senatit Akademik është rektori. Senati Akademik mbledhet në mënyrë periodike.
3. Anëtarët e Senatit Akademik të UK-së zgjidhen nga asamblatë e personelit akademik të njëjësive kryesore, me votim të përgjithshëm për një mandat katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje mes anëtarëve të personelit akademik me kohë të plotë të vetëkandiduar.
4. Anëtarët e Senatit Akademik të UK-së i përkasin kategorisë “Profesor” ose kanë gradën shkencore “Doktor” (“PhD”), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Në mungesë të autoriteteve drejtuese me këtë titull dhe për efekt përfaqësimi, kategoria mund të zbresë edhe në “Lektor” me gradën shkencore “Doktor”.
5. Në Senatin Akademik të UK-së bëjnë pjesë edhe studentë në masën 10% të numrit të anëtarëve të Senatit.
6. Senati Akademik përbëhet prej 19 anëtarësh, të ndarë sipas skemës në vijim :
 - a. Rektori i zgjedhur, i cili drejton Senatin Akademik sipas përcaktimeve të nenit 39, pika 4, të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.05.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë” ;
 - b. Katër përfaqësues nga secila njësi kryesore, të zgjedhur nga asambleja e personelit akademik e këtyre njëjësive, sipas përcaktimeve të nenit 37, pikat 3 dhe 4, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.05.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë” ;
 - c. Dy përfaqësues të studentëve, të zgjedhur sipas përcaktimeve të nenit 37, pika 4, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.05.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë”
7. Senati Akademik mbledhet në seanca të zakonshme, të paktën një herë në dy muaj. Seancat e jashtëzakonshme thirren kur rektori ose 1/3 e anëtarëve të tij e kërkojnë një gjë të tillë.
8. Mbledhjet e Senatit Akademik të UK-së zhvillohen konform Rregullores së funksionimit të tij, që miratohet nga vetë Senati Akademik.
9. Mbledhjet e Senatit Akademik zhvillohen kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve. Vendimet e tij merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, përveç rasteve të miratimit të çështjeve të veçanta, të përcaktuara në ligj, akte nënligjore apo akte të brendshme të institucionit, për të cilat duhet të merren vendime me shumicë të cilësuar. Në këto raste mbledhja e Senatit Akademik zhvillohet kur janë të pranishëm të paktën aq anëtarë, sa është numri i votave që kërkohen për miratimin e vendimeve për këto çështje.

10. Senati Akademik vendos për çështje të rëndësishme të universitetit në fushën e mësimit, kërkimit shkencor, administrativ. Senati akademik vendos edhe për çështje financiare pasi merr miratimin e Bordit të Administrimit sipas përcaktimeve të ligjit.
11. Garanton respektimin e parimeve të autonomisë dhe të mundësive të barabarta, të lirisë akademike, të kërkimit, si dhe të drejtat e studentëve.
12. Propozon planin strategjik të zhvillimit të UK-së.
13. Miraton Statutin e UK-së me 2/3 e votave të anëtarëve të tij, pasi të jetë marrë miratimi paraprak i Bordit të Administrimit.
14. Harton strukturën e përgjithshme të UK-së dhe i propozon Bordit të Administrimit numrin e personelit të UK-së në të gjitha nivelet.
15. Përgatit, në bashkëpunim me Bordin e Administrimit, raportin vjetor të strukturuar sipas fushës pëkatëse të kompetencës dhe e paraqet pranë MASR-së.
16. Miraton programet e reja të studimit, të kërkimit shkencor, ndryshimet, si dhe mbylljen e tyre. Programet e reja të studimit duhet të jenë të mbështetura në projektbuxhetin vjetor të UK-së.
17. Miraton hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive të UK-së, mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë. Në këto raste merr vlerësimin paraprak të Bordit të Administrimit.
18. Propozon mbylljen dhe riorganizimin e UK-së, si dhe ndarjen ose bashkimin e tij me një institucion tjetër të arsimit të lartë.
19. Miraton planin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore-shkencore të UK-së.
20. Funksionet e tjera të Senatit Akademik parashikohen në nenin 11 të Statutit të UK-së.

Neni 8

Mbarimi i mandatit të anëtarit të Senatit Akademik

1. Mandati i anëtarit të Senatit Akademik është me kohëzgjatje 4-vjeçare. Mandati i anëtarit të Senatit Akademik mbaron para kohe në rastet:
 - a. e pamundësisë për të kryer detyrën;
 - b. e shkeljeve të rënda të ligjit;
 - c. e ndryshimit të raporteve të përfaqësimit në Senat;
 - d. kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - e. kur jep dorëheqjen;
 - f. në raste paaftësie fizike apo mendore për të ushtruar funksionin;
 - g. me mungesën pa arsye në 3 (tre) seanca radhazi;
 - h. kur largohet nga universiteti.
2. Zëvendësimi i anëtarit të larguar bëhet me anë të zgjedhjeve të reja, brenda një muaji në njësinë që përfaqëson anëtari i larguar.

Neni 9

Asambleja e Personelit Akademik

1. Asambleja e personelit akademik përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë i UK-së.
2. Asambleja e personelit akademik të UK-së kryen këto funksione:
 - a. zgjedh anëtarët e Senatit Akademik;
 - b. zgjedh rektorin e UK-së;
 - c. zgjedh drejtuesin e njësisë kryesore në UK;

- d. krijon dhe zgjedh anëtarët e Komisioneve të Përhershme të njësisë kryesore;
 - e. ushtron të gjitha kompetencat e tjera, sipas përcaktimeve në statut dhe këtë rregullore.
3. Asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore kryen këto funksione:
- a. krijon, me propozim të dekanit të fakultetit, Komisionet e Përhershme të njësisë kryesore dhe zgjedh anëtarët e këtyre komisioneve sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren e njësisë kryesore;
 - b. zgjedh anëtarët përfaqësues të njësisë në Këshillin e Etikës;
 - c. ushtron të gjitha kompetencat e tjera, sipas përcaktimeve të statutit.

Neni 10 **Komisionet e Përhershme të UK-së**

1. Komisionet e Përhershme janë organe kolegjinale që kryejnë funksione në fushat që lidhen kryesisht me kualifikimin shkencor, garantimin e standardeve të cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit, me mbarëvajtjen e veprimtarisë së tij dhe marrëdhëniet me studentët, në përputhje me misionin dhe politikat e institucionit.
2. Komisionet e Përhershme krijohen me vendim të Senatit Akademik.
3. Komisionet e Përhershme në nivel institucioni përbëhen nga jo më pak se pesë anëtarë.
4. Pjesë e këtyre komisioneve është edhe njëstudent, i propozuar nga Këshilli Studentor, me përjashtim të Komisionit për dhënien e Gradës Shkencore « Doktor » dhe Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik.
5. Anëtarët e Komisioneve të Përhershme në nivel institucioni vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik me shumicë të thjeshtë votash, për një mandat 2-vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.
6. Kompetencat dhe sfera e veprimtarisë së këtyre komisioneve, si dhe funksionimi dhe organizimi i tyre përcaktohen në Rregulloren e çdo Komisioni që hartohet nga vetë ai dhe miratohet nga Senati Akademik.

Neni 11 **Rektorati**

1. Rektorati është organ kolegjal që drejtohet nga rektori dhe përbëhet nga:
 - a. rektori;
 - b. zëvendësrektorët;
 - c. administrator i institucionit
 - d. drejtuesit e njësive kryesore
2. Rektorati kryesohet nga rektori dhe thirret prej tij. Ai mblidhet rregullisht për të diskutuar çështjet kryesore të funksionimit të UK-së.
3. Zëvendësrektori zëvendëson rektorin në institucion në rast mungese të këtij të fundit dhe kryen çdo detyrë që i delegohet shprehimisht në formë shkresore nga ana e rektorit, përveç atyre që legjislacioni për arsimin e lartë dhe statuti i përcakton si ekskluzivitet i rektorit.
4. Funksionet e Rektoratit janë:

- a. harton planin strategjik të zhvillimit të institucionit, mbështetur në propozimet e njësisë bazë dhe kryesore të institucionit, si dhe ato të administratorëve të njësisë kryesore, dhe ia paraqet për miratim Senatit Akademik.
 - b. harton programin vjetor të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, mbi bazë të propozimeve të njësisë bazë dhe kryesore, si dhe ndjek zbatimin e tij pas miratimit nga Senati Akademik.
 - c. paraqet rekomandime për projektet për programet e studimeve, të kërkimit shkencor dhe ndryshimet e nevojshme strukturore për realizimin e tyre;
 - d. I propozon Bordit të Administrimit masa për nxitjen dhe promovimin e programeve të studimit me prioritet kombëtar.
 - e. zbaton të gjitha vendimet e miratuara nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit;
 - f. monitoron veprimtarinë e UK-së dhe publikon rezultatet e vlerësimit të tij.
 - g. ushtron kontrolle tematike, të organizuara apo spontane, në njësitë e universitetit për përmbushjen e qëllimeve të tij, si dhe për zbatimin e akteve të organeve të UK-së.
3. Funksione të tjera të Rektoratit janë parashikuar në nenin 17 të Statutit të UK-së.

Neni 12 Dekanati

1. Dekanati është organ kolegjal që drejtohet nga dekani dhe përbëhet nga:
 - a. dekani;
 - b. zëvendësdekanët;
 - c. administratori i njësisë kryesore;
 - d. drejtuesit e njësisë bazë.
2. Dekanati mblidhet të paktën një herë në muaj për të ndjekur veprimtarinë akademike dhe shkencore të njësisë kryesore.
3. Dekanati kryen të gjitha funksionet e përcaktuara në nenin 20 të Statutit të UK-së.
4. Funksione të tjera të Dekanatit, si dhe procedura e zhvillimit të mbledhjeve të këtij organi, parashikohen në rregulloren përkatëse të fakultetit.

Neni 13 Këshilli i Etikës

1. Këshilli i Etikës është organ kolegjal i universitetit, që promovon dhe shqyrton çështje që lidhen me etikën në veprimtarinë e procesit mësimor dhe atij kërkimor, si dhe në veprimtaritë e tjera institucionale.
2. Anëtarët e Këshillit të Etikës zgjidhen me shumicë të thjeshtë votash nga Senati Akademik, nga punonjësit mësimorë me tituj dhe/ose grada, të vetëkandiduar dhe/ose të propozuar nga vetë Senati Akademik.
3. Këshilli i Etikës së UK-së përbëhet nga 7 anëtarë.
 - a. Rektori, i cili është kryetar
 - b. Një përfaqësues nga çdo njësi kryesore
 - c. Një përfaqësues i studentëve
 - d. Një përfaqësues nga personeli ndihmësmësimor dhe administrativ
4. Kompetencat e Këshillit të Etikës janë të përcaktuara në Statutin e UK-së.
5. Këshilli i Etikës harton kodin e etikës pas diskutimeve në Asamblenë e personelit akademik. Ky kod miratohet në Senatin Akademik.

Neni 14 **Bordi Këshillimor**

1. Rektori i UK-së këshillohet herë pas here, kur ai e sheh të arsyeshme, me një bord këshillimor.
2. Në këtë bord ftohen nga rektori të marrin pjesë autoritetet drejtuese të institucioneve publike dhe jopublike rajonale.
3. Rektori ka të drejtë të thërrasë në konsultë, sipas fushave të veçanta, edhe ekspertë vendas apo të huaj.

Neni 15 **Rektori**

1. Rektori është autoriteti më i lartë akademik i UK-së, si dhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet akademike dhe protokollare.
2. Rektori zgjidhet nga anëtarët e asambleve të personelit akademik të njësive kryesore dhe studentët e UK-së, ka titullin “Profesor” dhe dekretohet nga Presidenti i Republikës.
3. Rektori ka këto kompetenca:
 - a. Është kryetar i Senatit për shkak të detyrës.
 - b. Emëron dhe shkarkon drejtuesit e njësisë kryesore dhe drejtuesit e njësisë bazë të UK-së sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
 - c. Lëshon diplomat e përfundimit të studimeve universitare për të gjitha ciklet e studimeve, por nuk ka të drejtën e delegimit të firmës personave të tjerë për këtë kompetencë;
 - d. Kryeson Këshillin e Etikës pranë UK-së për probleme të etikës së jetës universitare.
 - e. Propozon anëtarët e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për të realizuar kontrollin, matjen dhe zhvillimin e cilësisë në UK;
 - f. I bën kërkesë ASCAL-it për vlerësimin e jashtëm të cilësisë dhe akreditimin e programeve të studimit;
 - g. Merr masa disiplinore ndaj personelit akademik dhe ndihmësakademik në rast shkeljeje të parashikimeve në kontratën individuale të punës;
 - h. Kryen çdo funksion tjetër të parashikuar në nenin 13 të Statutit të UK-së.

Neni 16 **Zëvendësrektori/ët**

1. Numri i zëvendësrektorëve në UK është dy :
 - a. Zëvendësrektori për mësimin
 - b. Zëvendësrektori për shkencën dhe projektet
2. Zëvendësrektorët emërohen nga rektori, pas miratimit të kandidaturave të propozuara prej tij nga Senati Akademik. Shkarkimi i tyre bëhet nga rektori pas miratimit nga Senati Akademik.
3. Zëvendësrektorët duhet të mbajnë titullin akademik që i përket kategorisë “Profesor”, ose kanë gradën shkencore “Doktor” (“PHD”), të fituar pranë universiteteve të

- vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së.
4. Zëvendësrektorët janë anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë.
 5. Zëvendësrektorët kryejnë detyrat e përcaktuara me urdhër të rektorit, si dhe në mungesë dhe me porosi të tij nënshkruajnë aktet përkatëse.
 6. **Zëvendësrektori për mësimin** ka këto detyra dhe kompetenca:
 - a. Bashkërendon dhe kontrollon të gjithë veprimtarinë mësimore midis njësive bazë dhe atyre kryesore.
 - b. Ndjek dhe monitoron të gjithë procesin mësimor.
 - c. Drejton punën për hartimin e planeve mësimore dhe shpërndarjen e ngarkesave mësimore.
 - d. Bën analizën e të gjithë aspekteve të punës së njësive akademike dhe mban kontakte të vazhdueshme me dekanët për veprimtarinë mësimore.
 - e. Ndjek strategjinë e zhvillimit të institucionit.
 - f. Bashkërendon dhe kontrollon gjithë veprimtarinë e personelit ndihmësakademik në varësi, në nivel institucioni.
 - g. Bën analizën e të gjithë aspekteve të punës së sektorëve në varësi;
 - h. Drejton punën për përditësimin e informacionit përkatës dhe editimin e tij në faqen zyrtare të universitetit.
 - i. Kryen të gjitha detyrat e deleguara nga rektori.
 - j. Raporton tek rektori për veprimtarinë mësimore në UK.
 7. **Zëvendësrektori për shkencën dhe projektet** ka këto detyra dhe kompetenca:
 - a. Ndjek dhe kontrollon veprimtarinë shkencore të universitetit;
 - b. Nxit dhe ndjek gjithë projektet dhe programet shkencore në të cilat merr pjesë universiteti;
 - c. Bashkërendon veprimtarinë shkencore të universitetit me institucionet e tjera shkencore, njësitë qeveritare dhe komunitetin;
 - d. Ndjek dhe mbështet ecurinë e kualifikimit shkencor të personelit akademik;
 - e. Ndjek ecurinë e buletinit shkencor, revistave shkencore dhe konferencave që organizohen nga UK-ja;
 - f. Nxit integrimin e studentëve në projekte shkencore;
 - g. Nxit përfshirjen e projekteve shkencore në procesin e mësimdhënies;
 - h. Bashkërendon dhe kontrollon gjithë veprimtarinë e personelit ndihmësakademik në varësi në nivel institucioni;
 - i. Drejton punën për përditësimin e informacionit përkatës dhe editimin e tij në faqen zyrtare të universitetit;
 - j. Bën analizën e të gjithë aspekteve të punës së sektorëve në varësi;
 - k. Kryen gjithë detyrat e deleguara nga rektori;
 - l. Raporton te rektori për gjithë veprimtarinë kërkimore-shkencore në UK.
 8. Zëvendësrektorët kryejnë çdo funksion tjetër të parashikuar në Statutin e UK-së.

Neni 17

Largimi nga detyra i zëvendësrektorëve

1. Zëvendësrektorët largohen nga detyra në rastet:
 - a. kur dënohen me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - b. kur japin dorëheqjen;
 - c. e pamundësisë për të kryer detyrën;

- d. e shkeljeve të rënda të ligjit;
- e. kur bëhen të paaftë nga ana fizike apo mendore për të ushtruar funksionin;
- f. kur largohen nga universiteti.

Neni 18 **Dekani**

1. Dekani është autoriteti më i lartë akademik dhe përfaqësuesi i njësisë kryesore
2. Ai është personel akademik i kategorisë “Profesor” dhe mund të vijë nga radhët e personelit akademik të institucionit ose dhe jashtë tij.
3. Dekani zgjidhet nga asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore dhe studentët dhe emërohet nga rektori i UK-së.
4. Mandati i dekanit zgjat katër vjet. Ai shërben në detyrë për një mandat me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Pas përfundimit të mandatit ai vazhdon të jetë anëtar i personelit të njësisë bazë ku kryen veprimtarinë e tij akademike.
5. Dekani kryeson asamblenë e personelit akademik të njësisë kryesore;
6. Dekani kryen këto funksione:
 - a. koordinon veprimtarinë e njësive bazë dhe organeve të njësisë kryesore dhe zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet tyre;
 - b. përgatit propozimin përkatës për çdo vendimmarrje të njësisë bazë;
 - c. përgjigjet para Senatit Akademik për mbarëvajtjen e veprimtarisë së saj;
 - d. i propozon Senatit Akademik hapjen apo mbylljen e programeve të studimit si dhe reformimin e kurrikulave, të njësive bazë apo njësive të veçanta në fakultet;
 - e. i propozon rektorit shkarkimin e autoritetit drejtues të njësisë bazë në rastet e kryerjes së veprave penale flagrante ose të shkeljeve të rënda të ligjit, të pamundësisë për të kryer detyrën dhe për rastet e parashikuara në Kodin e Etikës së institucionit;
 - f. i propozon Administratorit të Përgjithshëm të UK-së shkarkimin e administratorit të njësisë kryesore ;
 - g. I propozon rektorit ngritjen dhe përbërjen e komisionit *ad hoc* për procedurën e rekrutimit të stafit akademik dhe ndihmësakademik në njësinë përkatëse;
 - h. I propozon Senatit Akademik kuotat e pranimit për çdo program studimi të ofruar nga njësia përkatëse të propozuara nga përgjegjësit e njësive bazë;
 - i. kryen çdo funksion tjetër të parashikuar në Statutin e UK-së.
7. Dekani mban përgjegjësi direkte lidhur me veprimtaritë si vijon:
 - a. Veprimtarinë mësimore dhe kërkimore-shkencore të fakultetit,
 - b. Organizimin e veprimtarive shkencore dhe promovuese,
 - c. Administrimin e rregullt të dokumentacionit mësimor dhe shkencor,
 - d. Zbatimin e programit mësimor-shkencor vjetor të fakultetit,
 - e. Disiplinimin e punës nga ana e personelit akademik dhe ndihmësakademik,
 - f. Rezultatet e vlerësimit të cilësisë së veprimtarisë së fakultetit,
 - g. Çështje të tjera të fakultetit të lidhura me procesin e akreditimit.
8. Kompetenca të tjera të dekanit, marrëdhëniet e tij me strukturat e tjera në nivel fakulteti parashikohen në Rregulloren e Fakultetit.
9. Dekani në ushtrim të kompetencave të tij, shprehet me urdhra dhe/ose udhëzime, të cilat bëhen publikebazuar në Ligjin nr. 9887, dt. 10.03.2008, « Për mbrojtjen e të dhënave personale»

Neni 19

Zëvendësdekani

1. Zëvendësdekani është anëtar i personelit akademik me kohë të plotë, i emëruar nga dekani pas miratimit të kandidaturave të propozuara prej tij në Dekanat.
2. Zëvendësdekani emërohet dhe shkarkohet nga dekani dhe me pëlqimin e dekanatit.
3. Numri i zëvendësdekanëve të një fakulteti përcaktohet nga Bordi i Administrimit.
4. Zëvendësdekani ndjek dhe zbaton detyrat sipas fushës që mbulon në fakultet. Fushat përcaktohen nga dekani.
5. Ai ushtron veprimtarinë e tij nën autoritetin e dekanit të fakultetit.
6. Në mungesë e me porosi të dekanit, zëvendësdekani nënshkruan aktet përkatëse me natyrë akademike dhe administrative që lejohen të delegohen për nënshkrim.
7. Zëvendësdekani ka detyrimin të marrë në vijimësi urdhra dhe orientime nga dekani i fakultetit, dhe të kryejë veprime me autorizim të tij në përmbushje të detyrave që i janë ngarkuar, sipas fushës që mbulon.
8. Zëvendësdekani ka të drejtë të marrë pjesë, të prezantojë mendime dhe rekomandime, të bëjë propozime në të gjitha mbledhjet e Dekanatit apo në struktura të tjera të fakultetit ku është i pranishëm, vetëm për fushën që i është ngarkuar nën përgjegjësi.
9. Zëvendësdekani nuk ndërmer asnjë nismë akademike apo administrative pa u konsultuar dhe marrë më parë pëlqimin e dekanit të fakultetit.
10. Dekani i fakultetit përcakton përshkrimin e punës të çdo zëvendësdekani për fushën që mbulon, duke bërë një ndarje të përgjegjësive dhe marrëdhënieve të tyre me organet e tjera drejtuese dhe vartëse të universitetit.
11. Të gjitha strukturat e fakultetit kanë detyrimin t'i përgjigjen në kohë dhe me përgjegjësi porosive, urdhrave dhe orientimeve të zëvendësdekanit kur ato janë në ushtrim të rregullt me detyrat e ngarkuara dhe për të cilat ka dijeni dekani i fakultetit.

Neni 20

Drejtuesi i njësisë bazë

1. Drejtuesi i njësisë bazë është autoriteti drejtues akademik dhe përfaqësues i saj. Ai zgjidhet nga asambleja e personelit akademik të njësisë bazë, dhe është personel akademik i kategorisë “Profesor” ose ka gradën shkencore “Doktor” (PhD), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Në rastet kur nuk ka kandidatë të kësaj kategorie, mund të kandidojë për drejtues edhe lektori, kur ky i fundit mban gradën shkencore “Doktor”.
2. Drejtuesi i njësisë bazë emërohet nga dekani. Ai mund të shërbejë në detyrë për një mandat katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.
3. Drejtuesi i njësisë bazë kryen këto funksione:
 - a. Drejton punën për hartimin e kurrikulave për të gjitha ciklet e studimeve të lëndëve që mbulon njësia bazë (departamenti), planeve mësimore dhe ndjek zbatimin e tyre;
 - b. Mbikëqyr veprimtaritë shkencore në departament, në përputhje me planifikimin vjetor, mban dokumentacionin e veprimtarisë mësimore-shkencore të personelit akademik të departamentit, pas raportimeve në analizën vjetore të tij;
 - c. Mbikëqyr respektimin e programeve të mësimdhënies në kohën dhe në mënyrën e caktuar dhe të veprimtarive të tjera të procesit mësimor;
 - d. I propozon dekanatit kriteret e posaçme të punësimit të personelit akademik për departamentin, pas miratimit në departament;

- e. Mbikëqyr realizimin e ngarkesës mësimore të personelit akademik përkatës;
 - f. Organizon analiza periodike për raste e aspekte të veçanta në departament dhe analizën vjetore të punës mësimore shkencore të tij;
 - g. I propozon dekanit përkatës kriteret për pranimin e studentëve në programet e studimit të fakultetit përkatës;
 - h. I propozon dekanit përkatës kuotat e pranimit të studentëve për programet e studimit të ofruara nga fakulteti përkatës;
 - i. Ngre dhe drejton grupin e punës për hartimin e rregullores së njësisë bazë;
 - j. Në emër të departamentit bën përpjekje të vazhdueshme për krijimin e lidhjeve me institucione homologe dhe për promovimin e departamentit;
 - k. bën të njohur arritjetedepartamentit nëpërmjet nxitjes së botimeve didaktike-shkencore, përfshirjes ose bashkëpunimit në projekte dhe përditësimin të rubrikave në faqen web të UK-së;
 - l. Kryen çdo funksion tjetër të parashikuar në Statutin e UK-së.
4. Mandati i përgjegjësit të zgjedhur, të njësisë bazë, mbaron para kohe në rastet:
- a. kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - b. kur jep dorëheqjen;
 - c. e pamundësisë për të kryer detyrën;
 - d. e shkeljeve të rënda të ligjit;
 - e. kur bëhet i paaftë nga ana fizike apo mendore për të ushtruar funksionin;
 - f. kur largohet nga universiteti ;
 - g. kur përfiton lejen sabatike.
5. Referuar Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, dekani i propozon rektorit shkarkimin e përgjegjësit të njësisë bazë në rastet e kryerjes së veprave penale flagrante ose të shkeljeve të rënda të ligjit, të pamundësisë për të kryer detyrën dhe për rastet e parashikuara në Kodin e Etikës së UK-së. Rektori shprehet brenda një muaji. Zëvendësuesi i përgjegjësit të njësisë bazë caktohet nga rektori, me propozimin e dekanit të njësisë kryesore përkatëse. Rektori shpall zgjedhje të parakohshme brenda gjashtë muajve nga data e shkarkimit.

Neni 21

Drejtuesi i Grupit Mësimor dhe Kërkimor

1. Përgjegjësi i grupit mësimor dhe kërkimor përzgjidhet me konkurs sipas përcaktimeve të Statutit të UK-së.
2. Detyrat e tij përcaktohen në Statutin e UK-së
 - a. Mbikëqyr procesin mësimor dhe kërkimor dhe i bën raport vjetor drejtuesit të njësisë bazë për realizimin e tij, duke pasqyruar dhe mendimin e grupit mësimor-kërkimor.
 - b. Organizon hartimin e programeve të lëndëve që mbulon grupi mësimor dhe i paraqit në departament për diskutim.
 - c. Drejton dhe ndjek veprimtarinë shkencore të anëtarëve të grupit mësimor dhe kërkimor dhe informon rregullisht në njësinë bazë. Organizon analizën vjetore të kësaj pune në grup dhe depoziton në departament dokumentacionin e veprimtarisë shkencore të secilit anëtar.

- d. Përgatit informacione për probleme pune të ngarkuara nga drejtuesi i njësisë bazë.
 - e. Informon drejtuesin e njësisë bazë për mungesa të papritura në procesin mësimor dhe kërkimor gjatë vitit dhe për shkeljet e disiplinës mësimore.
3. Mandati i përgjegjësit të zgjedhur të grupit mësimor- kërkimor, mbaron para kohe në rastet:
- a. kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - b. kur jep dorëheqjen;
 - c. e pamundësisë për të kryer detyrën;
 - d. e shkeljeve të rënda të ligjit;
 - e. kur bëhet i paaftë nga ana fizike apo mendore për të ushtruar funksionin;
 - f. kur grupi i ngritur për qëllime mësimore apo kërkimore shkrihet;
 - g. kur largohet nga universiteti ;
 - h. kur përfiton lejen sabatike.

Neni 22

Elementët përbërës të raportimit vjetor

1. Për çdo vit akademik, UK-ja paraqet pranë MASR-së raportet vjetore për veprimtarinë e kryer.
 2. Raportimi synon:
 - a. Të paraqesë informacione të qarta dhe transparente të veprimtarisë së UK-së në zbatim të misionit dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
 - b. Të ofrojë informacion për ministrinë mbi gjendjen financiare të UK-së, parashikimin për angazhimin e personelit akademik, tarifatat e shkollimit për vitin në vijim, për gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet për secilin program studimi që ato ofrojnë, si dhe elemente të tjera që lidhen me shërbimet që UK-ja ofron;
 - c. Të nxitë dhe të rritë përgjegjshmërinë, llogaridhënien dhe sigurinë e cilësisë së shërbimeve të ofruara;
 - d. Të paraqesë problemet e konstatuara nga çdo njësi në UK, me qëllim zgjidhjen e tyre, në bashkëpunim me strukturat shtetërore në fushën e arsimit.
 3. Raporti vjetor hartohet nga UK-ja në 1 (një) kopje origjinale në formë të shkruar dhe/ose elektronike dhe i dërgohet zyrtarisht ministrisë përgjegjëse për arsimin, brenda muajit shtator të çdo viti. Raporti vjetor mund të dorëzohet edhe në formë elektronike, sipas rastit, i skanuar në formatin PDF.
 4. Dekanati është përgjegjës për hartimin e raportit të njësisë respektive brenda datës të përcaktuar në udhëzimin përkatës të ministrisë përgjegjëse për arsimin.
 5. Pas raportimeve të bëra nga njësitë kryesore, përgatitet raporti vjetor përfundimtar nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit i UK-së, i strukturuar sipas fushës përkatëse të kompetencës ku trajtohen çështjet si më poshtë:
- A. Senati Akademik i UK-së
- a. Informacion mbi realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit. Raporte të vlerësimit të mësimdhënies, të nxënies, si dhe atë të kërkimit shkencor. Raporti specifikon strukturat përgjegjëse dhe afatet përkatëse për këto realizime me referencë planin strategjik afatgjatë dhe afatshkurtër të UK-së.

- b. Informacion mbi bashkëpunime ndërinstitucionale dhe projekte ku merr pjesë UK-ja, ku paraqiten të dhëna mbi institucionin bashkëpunues apo projektin; mbi kontratën, datën dhe formën e zyrtarizimit të bashkëpunimit apo të projektit; fusha e bashkëpunimit; detyrat e palëve dhe produktet, rezultatet apo përfitimet që priten nga ky bashkëpunim.
- c. Informacion mbi kërkimin shkencor në UK ose mbi projekte ku merr pjesë si palë aktive, i cili përfshin:
 - I. Politikat e kërkimit shkencor;
 - II. Të dhëna mbi lidhjet e kërkimit shkencor me mësimdhënien;
 - III. Produktet në fushën e kërkimit shkencor të paraqitura në formën e botimeve shkencore, artikujve, projekteve të fituara dhe të realizuara, pjesëmarrjes në veprimtari brenda dhe jashtë vendit, veprimtari shkencore të organizuara nga njësi bazë, bashkëpunime me institucione të tjera në nivel vendor, kombëtar apo ndërkombëtar të shoqëruara me të dhëna mbi datën, vendin dhe pjesëmarrësit;
 - IV. Të dhëna mbi infrastrukturën në shërbim të kërkimit shkencor.
- d. Të dhëna mbi programet e studimit.
 - I. UK-ja informon mbi të gjitha programet e studimit që ofron, përfshirë ato ndërdisiplinore dhe të përbashkëta, nëse ka. Në raport paraqiten programet e studimit që janë aktive, të pezulluara, të mbyllura, për të cilën/cilat është marrë leje për hapjen e tij/tyre, por nuk është aktivizuar.
 - II. UK-ja informon mbi marrjen e lejes për hapjen e programit të studimit që është në proces vlerësimi, si dhe për programe që ofrojnë formim të vazhdueshëm për të tretë apo për zhvillimin profesional të personelit të tij. Këto të dhëna shoqërohen me numrin dhe datën e aktit për hapjen, për pezullimin ose për mbylljen e programit të studimit.
 - III. UK-ja pasqyron në raportin vjetor përshtatshmërinë e programeve të studimit me misionin e institucionit, realizimin e synimeve të programit të studimit nga ana e përmbajtjes, si dhe lidhjen dhe rëndësinë e programeve të studimit nisur nga vlerësimi i nevojave për aftësi në tregun e punës.
- e. Ndryshimet në statutin apo rregulloret e UK-së, si dhe të dhëna për NJSBC-së.
- f. Parashikimin për angazhimin e personelit akademik, ngarkesën përkatëse, lëndën/t, dhe moduln/et që do të zhvillojë secili prej tyre për secilin semestër të vitit akademik.
- g. Të dhëna për gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet për secilin program studimi që UK-ja ofron, të shoqëruar me burimin e informacionit dhe adresën ku konfirmohet informacioni, duke specifikuar:
 - I. Përqindjen e punësimit të të diplomuarve, nëse institucioni deklaron se programet e ofruara përgatisin për një karrierë apo profesion të caktuar;
 - II. Përqindjen e të diplomuarve që kalojnë provimin e shtetit dhe licensohen, kur programi i studimit ka lidhje me një profesion të rregulluar.
- h. Të dhëna për këshillat studentore dhe përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të UK-së dhe në NJBSC.
- i. Vlerësime të universitetit dhe rekomandime të mundshme për ministrinë, si dhe një përshkrim të ndërveprimit të UK-së me strukturat e varësisë së ministrisë, duke përfshirë edhe:

- I. Një vlerësim të përgjithshëm të komunikimit me ministrinë dhe institucionet në varësi të saj, duke theksuar mbi përmirësimet e mundshme në këtë komunikim;
 - II. Vlerësime dhe rekomandime për ndryshime të sistemit apo akteve ligjore e nënligjore në fuqi që ndikojnë në veprimtarinë e UK-së, të shoqëruara me arsyetime të hollësishme.
- j. Të dhëna mbi studentët si:
- I. Numrin e përgjithshëm të studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar sipas niveleve dhe programeve të studimit;
 - II. Numrin e studentëve që ndjekin programe që përbëjnë prioritet kombëtar, të përcaktuar në dokumentin e prioriteteve të miratuar dhe të publikuar çdo vit nga ministria sipas drejtimeve kryesore.
 - III. Numrin e studentëve të shkëlqyer;
 - IV. Numrin e studentëve të çregjistruar ose të transferuar të shoqëruar me informacion mbi institucionin dhe programin e studimit ku transferohen;
 - V. Numrin e studentëve që kanë përfutur bursa dhe numrin e atyre që kanë përfutur nga përjashtimi apo reduktimi i tarifave të shkollimit;
 - VI. Pjesëmarrjen e studentëve në projekte bashkëpunimi ndërkombëtare dhe mbështetjen për lëvizshmërinë e tyre;
 - VII. Përqindjen e studentëve kalues në vit dhe përqindjen e atyre që diplomohen;
 - VIII. Një vlerësim të përgjithshëm mbi cilësinë e studentëve dhe vlerësimin e tyre për secilin cikël dhe program studimi.

B. Bordi i Administrimit i UK-së

- a. Të dhëna të përgjithshme mbi UK-në lidhur me strukturën e përgjithshme organizative, njësitë përbërëse dhe autoritetet drejtuese përkatëse etj.
 - b. Të dhëna për planin buxhetor afatmesëm, planin buxhetor njëvjeçar dhe planin strategjik të zhvillimit të UK-së.
 - c. Realizimin faktik të planit buxhetor të vitit paraardhës buxhetor sipas zërave të buxhetit, planin buxhetor të vitit pasardhës akademik, si dhe tarifave të shkollimit për vitin akademik në vijim.
 - d. Dokumentacionin e shlyerjes së detyrimeve tatimore, si dhe të sigurimeve shoqërore e shëndetësore.
 - e. Të dhëna mbi mobilitetin e personelit akademik të financuara nga UK-ja apo të realizuara në kuadër të projekteve ndërkombëtare.
 - f. Të dhëna për plotësimin e standardeve shtetërore akademike dhe infrastrukturore, në përputhje me Kodin e Cilësisë, ku përfshihen ndryshime në mjedise didaktike, kërkimore, politika të shpërndarjes së fondeve në funksion të përmirësimit të cilësisë, numri i teksteve dhe infrastruktura informatike në funksion të mësimin, në bashkëpunim me Senatit Akademik të UK-së.
6. Të dhënat e mësipërme miratohen në mbledhje të përbashkët të Senatit Akademik dhe të Bordit të Administrimit të UK-së dhe i dërgohen MASR-së me një raport të përbashkët.
7. Në rastet kur konstatohen pavërtetësi në të dhënat e paraqitura të raportit vjetor nga institucioni, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, vendos kushte ndaj IAL-së dhe/ose pezullon veprimtarinë e IAL-së, në rast se veprimi apo mosveprimi nuk përbën vepër penale.

KREU IV ORGANET DHE AUTORITETET DREJTUESE ADMINISTRATIVE

Neni 23 Bordi i Administrimit

1. Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të UK-së, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij.
2. Bordi i Administrimit të UK-së përbëhet nga shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të pjesshme, nga të cilët katër janë përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe tre janë anëtarë të stafit akademik të UK-së.
3. Përbërja e Bordit të Administrimit përcaktohet në varësi të planit buxhetor afatmesëm të institucionit, të miratuar nga Bordi i Administrimit, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë”.
4. Anëtarët përfaqësues të UK-së në Bordin e Administrimit, përzgjidhen nga Senati Akademik për një mandat pesëvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, prej listave të propozuara nga institucioni. Në listën e kandidatëve jepen të dhënat e individëve që vetëkandidojnë apo propozohen nga departamentet.

Neni 24 Funksionet e Bordit të Administrimit

1. Bordi i Administrimit (BA) ka këto funksione:
 - a. Garanton qëndrueshmërinë financiare të UK-së dhe përmbushjen e misionit të tij.
 - b. Me propozim të Senatit Akademik:
 - I. miraton planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tij;
 - II. miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;
 - III. miraton numrin e personelit në të gjitha nivelet.
 - IV. miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive përbërëse të UK-së.
 - V. vlerëson paraprakisht mbylljen dhe riorganizimin e institucionit, si dhe ndarjen ose bashkimin e UK-së me një institucion tjetër të arsimit të lartë.
 - VI. jep mendim për projektregulloren e universitetit dhe miraton rregulloren financiare të tij.
 - VII. përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron universiteti nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit.
 - c. është përgjegjës për caktimin e kritereve dhe të procedurave për punësimin e administratorëve dhe personelit administrativ, mbështetur në aktet e universitetit.
 - d. emëron dhe shkarkon administratorin e universitetit.
 - e. miraton paraprakisht Statutin e UK-së, para se t’i përcillet Senatit Akademik dhe vendimi merret me jo më pak se 3/5 e votave të anëtarëve, sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin

Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë”, neni 49, pika 1, shkronja “gj”.

- f. Përgatit, në kohën e përcaktuar në udhëzimin përkatës të ministrisë përgjegjëse për arsimin, së bashku me Senatën Akademik, raportin vjetor për veprimtarinë e kryer në UK-ja, të strukturur sipas fushës së tyre të kompetencës.
2. Mënyra e thirrjes së mbledhjeve të Bordit të Administrimit, rendi i ditës, pjesëmarrja, shumica për marrjen e vendimeve, votimi dhe çështje të tjera të lidhura me to, parashikohen në rregulloren e brendshme të Bordit të Administrimit.
3. Bordi i Administrimit vendos për publikimin ose jo të vendimeve të tij. Ky publikim bëhet sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe Ligjit nr.119/2014, datë 18.09.2014, “Për të drejtën e informimit”.

Neni 25

Mbarimi i parakohshëm i mandatit të anëtarit të Bordit të Administrimit

1. Mandati i anëtarit të Bordit të Administrimit mbaron para kohe në rastet :
 - a. e ndryshimit të raporteve të përfaqësimit në Bordin e Administrimit;
 - b. e pamundësisë për të kryer detyrën;
 - c. e shkeljeve të rënda të ligjit;
 - d. kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - e. e paaftësisë fizike apo mendore për të ushtruar funksionin;
 - f. e mungesës pa arsye në 3 (tre) seanca radhazi;
 - g. kur largohet nga universiteti;
 - h. kur anëtari i Bordit të Administrimit jep dorëheqjen.
2. Shkarkimi i anëtarëve të Bordit të Administrimit bëhet nga ministri përgjegjës për arsimin, me propozimin e organit që i zgjedh apo emëron.
3. Propozimi për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të UK-së, bëhet në rastet e përmendura në pikën 1, të këtij neni, nga Senati Akademik.

Neni 26

Përzgjedhja dhe statusi i Administratorit të UK-së

1. Administratori i UK-së është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të universitetit. Ai është përfaqësues ligjor i universitetit për çështjet financiare dhe administrative, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë”.
2. Administratori përzgjidhet me konkurs të hapur, sipas kriterëve të përcaktuara nga Bordi i Administrimit. Lista e kandidaturave që plotësojnë kriteret miratohet nga Senati Akademik. Emërimi i administratorit bëhet nga Bordi i Administrimit.
3. Administratori duhet të ketë arsim të lartë, së paku në nivelin “Master i shkencave” në fushën e drejtësisë ose ekonomisë dhe përvojë pune së paku shtatë vjet në këto fusha. Ai nuk mund të ushtrorë asnjë funksion tjetër akademik apo administrativ.
4. Administratori i UK-së përzgjidhet dhe shkarkohet nga Bordi i Administrimit me 2/3 e votave të anëtarëve të tij.

5. Administratori i raporton për veprimtarinë e tij Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik dy herë në vit.
6. Marrëdhëniet e administratorit me rektorin dhe organet e tjera në universitet, si dhe detyrat e tjera që mund t'i delegohen, përcaktohen në pjesë të veçanta të kësaj Rregulloreje, si dhe në Rregulloret e njësive kryesore të Universitetit "Fan S. Noli" të Korçës.

Neni 27

Funksionet e Administratorit të UK-së

1. Administratori i UK-së kryen këto funksione:
 - a. harton projektbuxhetin vjetor, mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë, mbështetur në planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe në planin buxhetor afatmesëm të tij;
 - b. propozon kriteret për administrimin e burimeve financiare dhe materiale, të cilat ia paraqet për miratim Bordit të Administrimit dhe mbikëqyr shpërndarjen e zbatimin e tyre;
 - c. ndjek dhe kontrollon zbatimin e buxhetit vjetor të institucionit në strukturat e tij të varësisë;
 - d. zbaton të gjitha vendimet e Bordit të Administrimit dhe të Senatit Akademik me karakter financiar dhe administrativ;
 - e. i raporton Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik mbi veprimtarinë financiare të institucionit;
 - f. bashkëpunon me strukturat dhe autoritetet e tjera të institucionit për çështje të administrimit të përditshëm;
 - g. emëron dhe shkarkon administratorët e njësive kryesore pas miratimit të Bordit të Administrimit;
 - h. mbikëqyr veprimtarinë e administratorëve të njësive kryesore;
 - i. plotëson kërkesat e rektorit, me qëllim përmbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare;
 - j. ngre komisionin *ad hoc* për vlerësimin e kërkesave të studentëve për bursa;
 - k. emëron dhe shkarkon drejtorët e drejtorive, përgjegjësit e sektorëve dhe zyrave në varësi të tij, si dhe personelin administrativ të institucionit;
 - l. nënshkruan kontratat e punës së personelit administrativ të institucionit;
 - m. ushtron të gjitha funksionet e tjera të përcaktuara në Statut.

Neni 28

Përzgjedhja, statusi dhe funksionete Administratorit të Njesisë Kryesore

1. Administratori i njësisë kryesore është përgjegjës për mirëfunksionimin financiar dhe administrativ të saj. Ai zgjidhet me konkurs, sipas procedurave dhe kriterëve të përcaktuara nga Bordi i Administrimit.
2. Administratori i njësisë kryesore duhet të ketë formim universitar, së paku në nivelin "Master i shkencave" në fushën e drejtësisë ose ekonomisë dhe përvojë pune, së paku pesë vjet në këto fusha.
3. Administratori i njësisë kryesore emërohet dhe shkarkohet nga administratori i UK-së, pas miratimit të Bordit të Administrimit. Procedura e emërimit dhe shkarkimit të tij përcaktohet në rregulloren e njësisë kryesore.

4. Administratori i njësisë kryesore nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër, akademik apo administrativ.
5. Administratori i njësisë kryesore i raporton për veprimtarinë e tij administratorit të institucionit, si dhe informon drejtuesin e njësisë kryesore.
6. Administratori i njësisë kryesore harton një raport vjetor mbi veprimtarinë financiare të njësisë kryesore, të cilin e depoziton pranë administratorit të institucionit dhe drejtuesit të njësisë kryesore.
7. Ushtron të gjitha funksionet e tjera të përcaktuara në Statut.

KREU V

A-PERSONELI AKADEMIK, NDIHMËS AKADEMIK DHE ADMINISTRATIV

Neni 29

Të përgjithshme

1. Personeli në UK përbëhet nga personeli akademik, personeli ndihmës-akademik dhe personeli administrativ.
2. Personeli në UK është i punësuar me kontratë, me kohëzgjatje të pacaktuar ose të caktuar, si edhe me angazhim me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, sipas Rregullores së UK-së për lidhjen e kontratave me punonjësit.
3. Personeli zhvillon veprimtarinë e tij në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë”, aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi, Statutin, Rregulloret e universitetit dhe të njësisë kryesore, dhe aktet e tjera të brendshme të UK-së.
4. Të drejtat dhe detyrimet e personelit në UK-së përcaktohen në Statut, në rregulloret e akte të tjera të brendshme të universitetit dhe/apo njësisë kryesore, si dhe në kontratat individuale të punës, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

PERSONELI AKADEMIK, NDIHMËSAKADEMIK DHE ADMINISTRATIV

Neni 30

Kategoritë e personelit akademik

1. Personeli akademik në UK kryen veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor, shërbime për mbështetje dhe zhvillim të UK-së, këshillim për studentët, konsulencë e trajnime për të tretët, si dhe veprimtari të tjera.
2. Personeli akademik në UK është me orientim mësimor dhe/ose kërkimor-shkencor. Njësitë bazë dhe njësitë kryesore kanë detyrimin që të bëjnë këtë klasifikim për UK-në dhe ta rinovojnë atë në mënyrë periodike.
3. Personeli akademik në UK, sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen, kategorizohet në:
 - a. Profesorë;
 - b. Lektorë;
 - c. Asistent-lektorë.

4. Në kategorinë “Profesorë” përfshihen anëtarët e personelit akademik, titullarë të lëndëve ose moduleve dhe udhëheqës të veprimtarisë kërkimore-shkencore. Anëtarët e personelit akademik të kësaj kategorie mbajnë titujt akademikë “Profesor” ose “Profesor i asociuar”. Kjo kategori punësohet me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar.
5. Në kategorinë “Lektorë” përfshihen anëtarët e personelit akademik, që zhvillojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore-shkencore. Në këtë kategori përfshihen anëtarët e personelit akademik që mbajnë gradën shkencore “Doktor”, kanë së paku tre vjet përvojë në mësimdhënie para ose pas fitimit të kësaj grade dhe përmbushin kriteret e përcaktuara në Statutin e UK-së. Kjo kategori punësohet me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar.
6. Në kategorinë “Asistent-lektorë” përfshihen anëtarët e personelit akademik që zhvillojnë veprimtari mësimore-kërkimore. Asistent-lektorët duhet të kenë së paku diplomën “Master i shkencave” dhe të përmbushin kriteret e përcaktuara në Statutin e UK-së. Asistent-lektori punësohet me kontratë me kohëzgjatje të caktuar.
7. Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës.
8. Raportet midis veprimtarive të ndryshme për personelin akademik, të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, përcaktohen nga UK-ja sipas përcaktimeve në udhëzimet përkatëse të ministrit përgjegjës për arsimin.
9. Ngarkesa e plotë mësimore për personelin akademik përcaktohet nga UK-ja, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin.

Neni 31

Statusi dhe trajtimi i veçantë i personelit akademik

1. Personeli akademik në UK gëzon status dhe trajtim të veçantë, që konsiston në liritë akademike, të drejtat ekonomiko-financiare, detyrimet e përgjegjësitë si dhe garancitë juridike e civile në zbatim të tyre.
2. Personeli akademik gëzon liri akademike në këto drejtime të veprimtarisë së tij, në:
 - a. mësimdhënie;
 - b. punë kërkimore-shkencore;
 - c. kontribut institucional;
 - d. kontribut profesional.
3. Liria akademike ushtrohet në kuadrin e përgjegjshmërisë pedagogjike e shkencore dhe nuk presupozon përjashtimin nga vlerësimi i performancës së personelit akademik.
4. Personeli akademik nuk mund të penalizohet për shkak të qëndrimeve të tij ndaj politikave të institucionit. Në të gjitha rastet, personeli akademik vepron brenda normave të etikës, në respekt të institucionit dhe kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi.
5. Personeli akademik e humbet statusin kur përfundon/zgjidhet kontrata.
6. Anëtarët e personelit akademik nuk mund të penalizohen nga insitucioni për shkak të rezultateve të vlerësimit të punës së tyre kërkimore-shkencore, të kryera në përputhje me fushën përkatëse dhe misionin e UK-së.
7. Në rast se anëtari i personelit akademik konstaton se i është cenuar liria akademike, dinjiteti profesional apo ka një qëndrim joetik ndaj tij, i drejtohet Këshillit të Etikës së UK-së, për këtë çështje. Procedura e trajtimit të ankesave kryhet në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme të UK-së. Vendimi i Këshillit të Etikës është gjithnjë i ankimeshëm në rrugë gjyqësore.

8. Anëtarët e personelit akademik të kategorive “Profesor” dhe “Lektorë”, punësohen në UK nëpërmjet një kontrate me kohëzgjatje të pacaktuar. Anëtarët e personelit akademik të kategorisë “Asistentë-lektorë”, punësohen në UK nëpërmjet një kontrate me kohëzgjatje të caktuar. Të tria këto kategori mund të punësohen me kohë të plotë apo me kohë të pjesshme.
9. Personeli akademik nuk mund të largohet apo të zëvendësohet, pa miratimin e tij, gjatë kryerjes së punës kërkimore-shkencore në një projekt të ndjekur prej tij, përveç rasteve të shkeljeve të rënda të vërtetuara, të parashikuara në Kodin e Punës dhe aktet e brendshme të UK-së.
10. Koha normale e punës së personelit akademik nuk mund të jetë më shumë se 1536 orë në vit. Ngarkesa mësimore e personelit akademik parashikohet në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin.
11. Leja vjetore e personelit akademik është jo më pak se 40 ditë pune (56 ditë kalendarike). Në rast se kjo leje nuk konsumohet nga personeli akademik, si pasojë e nevojës së institucionit dhe me propozimin e përgjegjësit të njësisë bazë dhe me miratimin e Bordit të Administrimit, jepet shpërblimi përkatës në të holla.
12. Personeli akademik, brenda kohës efektive të punës, mund të kryejë detyra akademike, shkencore ose në mbështetje institucionale ndaj të tretëve, në përputhje me statutin dhe rregulloret e UK-së.
13. Personeli akademik, për veprimtaritë që lidhen me drejtimit e punës së tij, sipas pikës 2, të këtij neni, ka të drejtën e përfitimit të një leje deri në dy javë, me miratim nga dekani, që informon, në çdo rast, rektorin. Për kohëzgjatje mbi dy javë, leja merret nga rektori. Në të gjitha rastet, kërkesat për leje duhet të jenë të dokumentuara dhe të justifikuara. Personeli akademik raporton përpara njësisë bazë mbi veprimtarinë e kryer gjatë lejes.
14. Personeli akademik mund të kryejë detyra të larta në administratën publike, vendase apo të huaj, për jo më shumë se 5 vjet, pa ndërprerje, duke ruajtur statusin e tij. Në funksion të ruajtjes së vendit të punës, sipas profilit akademik, nënshkruhet një marrëveshje e posaçme me rektorin e UK-së. Pas kësaj periudhe, anëtari i personelit akademik, me kërkesën e tij, rikthehet në vendin e mëparshëm të punës ose në një vend të barasvlefshëm.
15. Personeli akademik, me kohë të plotë apo të pjesshme, nuk mund të ushtrojë asnjë funksion administrimi në institucionin e arsimit të lartë ku është punësuar, me përjashtim të zgjedhjes anëtar në Bordin e Administrimit.
16. Pagat e personelit akademik të të gjitha kategorive përcaktohen nga Bordi i Administrimit, pasi ka marrë mendimin e Senatit Akademik, por jo më shumë se kufijtë maksimalë të pagës për funksion/titull, të përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë”.
17. Personeli akademik përfiton kompensim e rimbursim financiar, kur punon për veprimtaritë e parashikuara në drejtimit e përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, në masën dhe sipas procedurave të përcaktuara nga Bordi i Administrimit dhe kuadrit ligjor në fuqi.
18. Personeli akademik mund të kërkojë leje, pa të drejtë page, për arsye shëndetësore apo familjare. Kohëzgjatja maksimale e të gjitha lejeve të papaguara, brenda një viti kalendarik, nuk mund të jetë më shumë se 30 ditë.

Neni 32

Punësimi i personelit akademik

1. Punësimi i personelit akademik bëhet me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, bazuar në aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, si dhe legjislacionin që rregullon marrëdhëniet e punës.
2. Punësimi realizohet me procedurë të konkurrimit të hapur publik, në një proces transparent dhe të paanshëm.
3. Kriteret e përgjithshme të punësimit të personelit akademik janë:
 - A. Për kategorinë “Profesor” të:
 - a. zotërojë titullin akademik “Profesor” ose “Profesor i asociuar” në fushën përkatëse;
 - b. ketë të paktën 5 vite përvojë pune në mësimdhënie në institucionet e arsimit të lartë brenda apo jashtë vendit;
 - c. ketë veprimtari kërkimore– shkencore dhe botime në disiplinën përkatëse;
 - d. plotësojë kriteret e propozuara nga njësia bazë përkatëse;
 - e. përmbushë kriteret që përcaktohen nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;
 - B. Për kategorinë “Lektorë” të:
 - a. zotërojë gradën shkencore “Doktor” në fushën përkatëse;
 - b. zotërojë diploma të tjera universitare në fushën përkatëse;
 - c. ketë të paktën 3 vite përvojë pune në mësimdhënie në institucionet e arsimit të lartë brenda apo jashtë vendit;
 - d. ketë veprimtari kërkimore– shkencore dhe botime në disiplinën përkatëse;
 - e. plotësojë kriteret e propozuara nga njësia bazë përkatëse;
 - f. përmbushë kriteret që përcaktohen nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;
 - C. Për kategorinë “Asistent- lektorë” të:
 - a. zotërojë diplomën “Master i shkencave” në fushën përkatëse;
 - b. zotërojë diploma të tjera universitare në fushën përkatëse;
 - c. ketë të paktën 1 vit përvojë pune;
 - d. plotësojë kriteret e propozuara nga njësia bazë përkatëse;
 - e. përmbushë kriteret që përcaktohen nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;
4. Procedura e punësimit të personelit akademik është e parashikuar në nenin 40 të Statutit të UK-së
5. Kontratat e punës së personelit akademik dhe ndihmësakademik nënshkruhen nga rektori.
6. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në UK nuk mund të punësohet si personel akademik me kohë të plotë në një institucion tjetër të arsimit të lartë, brenda dhe jashtë vendit.
7. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në UK mund të angazhohet me kohë të pjesshme vetëm në një institucion tjetër të arsimit të lartë, me:
 - a. marrëveshje mes dy institucioneve
 - b. miratimin e drejtuesit të njësisë bazë
 - c. miratimin e rektorit.

Neni 33

Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e personelit akademik

- 1. Personeli akademik i UK-së ka këto të drejta:**
 - a.** Të përparojë në karrierën akademike, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
 - b.** Të trajnohet, të kualifikohet në institucionet akademike e kërkimore shkencore, brenda dhe jashtë vendit, sipas legjislacionit në fuqi dhe në përputhje me profilin;
 - c.** Të zgjedhë dhe të zgjidhet në organet e UK-së, duke kryer veprimtari zgjedhore në përputhje me statutin dhe rregulloret e tjera të institucionit;
 - d.** Të shfrytëzojë të gjitha mundësitë ekzistuese në universitet, fakultet e departament, duke respektuar të gjitha rregullat e vendosura;
 - e.** Në funksion të zhvillimit të programit të lëndës, pedagogu ka të drejtë të përdorë forma sa më të larmishme në mësimdhënie me qëllim që të mundësojë arritjen e objektivave të përcaktuara;
 - f.** Të kërkojë nga studentët respektimin e kërkesave të ligjit, statutit dhe rregulloreve të institucionit, duke mos lejuar në asnjë rast shkeljen e tyre;
 - g.** Të kërkojnë nga studentët një frymë etiko-morale të tillë që të jetë në pajtueshmëri me traditën, si edhe me legjislacionin tonë në fuqi në fushën e së drejtës;
 - h.** Të kërkojë nga organet drejtuese të departamentit, fakultetit, e universitetit, respektimin prej tyre të të gjitha të drejtave që u siguron atyre Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë.
- 2. Personeli akademik i UK-së ka këto detyra dhe përgjegjësi:**
 - a.** Të njohë, të respektojë, të zbatojë dhe të veprojë në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
 - b.** Të respektojë kohën në funksion të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, sipas orarit të punës dhe ta shfrytëzojë vetëm për kryerjen e detyrave. Koha e punës dhe e mësimdhënies përcaktohet nëpërmjet kontratës së punës;
 - c.** Të rrisë aftësitë profesionale akademike dhe të marrë pjesë në veprimtari formuese për këtë qëllim;
 - d.** Të mos kërkojë ose pranojë asnjë përfitim pasuror, për kryerjen e detyrave akademike, me përjashtim të pagës dhe privilegjeve të tjera, të përcaktuara me ligj, akte nënligjore dhe aktet e brendshme të UK-së;
 - e.** Të mbajë përgjegjësi të plotë për veprimet e tij, gjatë kryerjes së detyrës si personeli akademik në UK;
 - f.** Të zbatojë etikën institucionale në respektim të imazhit të institucionit dhe figurës profesionale ;
 - g.** Të zbatojë kodin e etikës në veshje e sjellje, gjatë kohës së ushtrimit të veprimtarisë akademike;
 - h.** Bazuar në Rregulloren e Programit të Digjitalizimit të Sistemit Universitar ESSE3, të institucionit, pedagogu:
 - I.** Deri në fund të muajit dhjetor, publikon online syllabuset e lëndëve, në programet e studimit në të cilat ai jep mësim.
 - II.** Mund të shikojë online grafikun e provimeve.
 - III.** Dy ditë nga data e provimit përkatës mund të përcaktojë online në grupet që jep mësim, studentët që futen apo jo në provim (fiton, nuk fiton, nuk frekuenton, pagesë) dhe mbi këtë bazë të printojë procesverbalet e provimeve.
 - IV.** Mund të dërgojë e-mail studentëve në lidhje me rezultatin e provimit.

- V. Vendos në procesverbalin e provimit vlerësimin e vazhduar në të gjitha sezonet e provimeve.
- VI. Publikon online rezultatin paraprak të provimeve deri 6 ditë nga data e provimit.
- VII. Shqyrton deri në 8 ditë nga data e provimit (me shkrim), ankimimin e studentëve në lidhje me rezultatin e tyre.
- VIII. Gjeneron, publikon online dhe dorëzon në sekretarinë mësimore procesverbalin e provimit deri 8 ditë nga data e provimit. Procesverbalet janë të lidhura me databazën, ku notat futen automatikisht brenda afatit kohor.
- IX. Për çdo dorëzim apo ndryshim të rezultateve të provimit pas kësaj date, pedagogu duhet t'i drejtohet dekanit të fakultetit të tij.

Neni 34 Personeli akademik i ftuar

1. Njësia bazë ka të drejtë të kërkojë të punësohen me kontratë për periudha të shkurtra kohe studiuës, personalitete, artistë vendas ose të huaj. Personeli i ftuar përbëhet nga punonjës me tituj shkencorë.
2. Përzgjedhja e personelit akademik të ftuar bëhet nga njësia kryesore mbi bazën e propozimeve të njësive bazë, pasi të jenë identifikuar modulet ku do të angazhohen, vëllimi i orëve mësimore (leksione/ seminare, laboratore etj.) që ata do të kryejnë, si dhe kualifikimi i kandidatëve.
3. Kontrata e punës e personelit akademik të ftuar bëhet nga rektori i UK-së.
4. Shpenzimet për personelin akademik të ftuar përballohen nga të ardhurat e universitetit.

Neni 35 Veprimtaria që kryen personeli akademik

1. Veprimtaritë që kryen personeli akademik në institucionet e arsimit të lartë janë:
 - a. Mësimdhënie
 - b. Kërkimi shkencor ose artistik
 - c. Kontribut institucional
 - d. Kontribut profesional
2. Mësimdhënia përfshin:
 - a. Veprimtari në auditor si vijon:
 - I. Leksione
 - II. Seminare
 - III. Lëndë speciale
 - IV. Ushtrime
 - V. Laboratorë
 - VI. Projekte kursi
 - b. Veprimtari jashtë auditorit, në mbështetje të procesit mësimor si vijon:
 - I. Ndjekje dhe/ose drejtim i praktikës mësimore ose profesionale
 - II. Konsultime/Këshillim studentësh,
 - III. Udhëheqje diplome të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë
 - IV. Kontroll i dijeve (provime, kolokuiume)

- V. Përgatitje individuale
- VI. Ekspozitë, garë dhe shfaqje
- VII. Recensë punimi diplome cikli i tretë i studimeve.

3. Kontributi në kërkimin shkencor dhe krijimtarinë artistike, përfshin:
 - a. Kërkim dhe/ose veprimtari krijuese
 - b. Pjesëmarrje në programe kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare, konfereca, seminare, kongrese, ëorkshope, krijimtari artistike në salla të indeksuara, etj.
 - c. Publikim monografish, artikujsh apo punimesh shkencore të natyrave të ndryshme në periodikë apo serial botimesh shkencore (joperiodike) me komitet shkencor vlerësues dhe drejtues.
 - d. Pjesëmarrje në borde revistash shkencore apo serial botimesh shkencore (joperiodike) apo veprimtari të tjera formuese të ciklit të tretë të studimit;
 - e. Udhëheqje në programe doktorale, apo veprimtari të tjera formuese të ciklit të tretë të studimit etj.
 - f. Përgatitja e projekteve dhe ndjekja e procesit të aplikimit në kuadër të thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtarre.
4. Kontributi institucional, përfshin veprimtarinë akademike dhe administrative në mbështetje të njësisë bazë, njësisë kryesore, institucionit dhe administratës publike, si vijon:
 - a. Hartimi i programeve të studimit
 - b. Hartimi rregulloreve apo dokumentacioneve
 - c. Përgatitje botimesh universitare
 - d. Pjesëmarrje në komisionet *ad hoc*
 - e. Pjesëmarrje në veprimtarinë e organeve të njësisë bazë, njësisë kryesore dhe IAL-së.
 - f. Pjesëmarrje në grupe pune të ngritura nga institucione të administratës publike.
5. Kontributi profesional përfshin:
 - a. Veprimtari për zhvillim dhe transferim teknologjie dhe/ose shërbime të tjera të lidhura me të;
 - b. Ekspertizë
 - c. Përhapje të njohurive shkencore e teknologjike në mbështetje të mësimdhënies
 - d. Angazhim si krijues artistik në lidhje me përfshirjen e studentëve
 - e. Trajnim për transferime të teknologjisë, të shkencës dhe inovacionit në mësimdhënie
 - f. Hartim projektsh kombëtare dhe ndërkombëtare
 - g. Angazhim si ekspert në grupe pune të ngritura me urdhër të Ministrit apo Kryeministrit, si dhe në nivel rajonal, bashkitë dhe qarqet administrative.

Neni 36

Ngarkesa mësimore vjetore për personelin akademik

1. Ngarkesa mësimore vjetore për personelin akademik me kohë të plotë në auditor është:
 - a. Kategoria “Profesor” 140 orë në auditor
 - b. Kategoria “Lektor” 165 orë në auditor
 - c. Kategoria “Asistent-Lektor” 195 orë në auditor.
2. Çdo orë e realizuar mbi këtë përcaktim është orë suplementare. Orët suplementare në auditor nuk mund të jenë më shumë se 200. Në raste specifike me propozim të drejtuesit të njësisë bazë dhe miratim të drejtuesit të njësisë kryesore, personeli

- akademik me kohë të plotë mund të mbulojë edhe 100 orë në auditor mbi limitin 200 orë.
3. Personeli akademik me kohë të plotë nëse kategorizohet me orientim kërkimor mund të ketë ulje të detyrimit të ngarkesës mësimore në auditor deri në 35% . Orët suplementare në auditor për personelin akademik me orientim kërkimor nuk mund të jenë më shumë se 100 orë.
 4. Personeli akademik me kohë të pjesshme mund të mbulojë ngarkesën vjetore në auditor:
 - a. Kategoria “Profesor” 120 orë në auditor
 - b. Kategoria “Lektor” 120 orë në auditor
 - c. Kategoria “Asistent Lektor” 120 orë në auditor.
 5. Personeli akademik me kohë të pjesshme nuk mund të ketë orë suplementare. Ky personel paguhet deri në ngarkesën maksimale të përcaktuar në auditor.
 6. Personeli akademik me kohë të pjesshme mund të përfshihet në veprimtari të tjera të cilat sipas përcaktimeve kanë kompesim financiar dhe nuk llogariten në limitet e orëve në auditor.
 7. UK-ja mund të angazhojë dhe personel me kohë të pjesshme të dedikuar në veprimtari të kërkimit shkencor i cili nuk ka detyrim mësimdhënien, por që ndihmon në veprimtaritë kërkimore–shkencore.
 8. Personeli akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, mund të përfshihet në grupet e punës për hartimin dhe aplikimin e projekteve të financuara nga programet e Bashkimit Evropian. Ngarkesa e paguar për përfshirjen në këto grupe pune është deri në 200 orë/projekte në vit (Kjo ngarkesë nuk përfshihet në llogaritjet e orëve maksimale të pikave 2 dhe 3 të këtij neni). Për shkrimin e projekteve të financuara nga Bashkimi Evropian, grupit të punës i njihen deri në 350 orë të cilat ndahen ndërmjet anëtarëve të grupit të punës i cili është angazhuar për përgatitjen e projektit. Projekti përcakton si institucion menaxhues të tij, UK-në. Grupi i punës miratohet nga drejtuesi i njësisë bazë dhe kryesore. Orët certifikohen vetëm pasi projekti ka certifikim formal të dorëzimit dhe merren komentet përsa i përket cilësisë së projektit, në rast se ai nuk rezulton fitues ose kur projekti rezulton fitues.
 9. Për autoritetet drejtuese të UK-së, mësimdhënia vjetore në auditor është:
 - a. Rektor 50 orë mësimore
 - b. Zëvendës rektor 60 orë mësimore
 - c. Dekan 70 orë mësimore
 - d. Zëvendës dekan 90 orë mësimore
 - e. Përgjegjës departamenti 90 orë mësimore
 10. Ngarkea e plotë mësimore vjetore e personelit akademik me kohë të plotë nuk mund të përmbajë në një vit akademik më shumë se 3 lëndë semestrale në bazë të programeve të përcaktuara nga njësia bazë, të shpërndarë në dy semestra, ose 2 lëndë vjetore dhe 1 semestrale, ose 3 lëndë vjetore.
 11. Ngarkesa e plotë mësimore vjetore e një anëtari të personelit akademik me orientim kërkimor-shkencor nuk mund të përmbajë në një vit akademik më shumë se 2 lëndë semestrale në bazë të programeve të përcaktuara nga njësia bazë, sipas përcaktimit të programeve të lëndës ose 2 lëndë vjetore.
 12. Doktorantët me kohë të plotë që frekuentojnë vitin e dytë ose të tretë të studimeve të doktoratës mund të angazhohen në veprimtari mësimdhënëse mbështetëse jashtë auditorit sipas përcaktimeve të pikave i dhe ii të pikës 2,b) Neni 35 si dhe në veprimtaritë kërkimore sipas përcaktimeve të pikës 3 me përjashtim të pikës 3 germa e) Neni 35. Angazhimi i doktorantëve në veprimtaritë mësimdhënëse të sipërcituara

kryhet në kuadër të parashikimeve të programit përkatës të doktoratës, nën mbikqyrjen e udhëheqësit të doktoratës, sipas nevojave të njësisë bazë dhe asaj kryesore, pa shpërblim financiar dhe jo më shumë se 50 orë në vit.

13. Ngarkesa e plotë mësimore vjetore e një anëtari të personelit akademik mund të reduktohet me propozim të njësisë bazë, aprovim nga njësia kryesore dhe me miratim nga Bordi i Administrimit në rastin e përfitimit të një burse studimi jo më pak se 1-mujore, si dhe në raste të veçanta të angazhimeve në kuadër të kontributit institucional.

14. Një orë mësimdhënie në auditor zgjat 50 minuta.

15. Institucioni përcakton në rregulloret e brendshme politikat e shpërblimit sipas funksioneve që kryhen nga personeli akademik, personeli ndihmës akademik si dhe ai administrativ. Këto politika miratohen nga Bordi i Administrimit.

16. Elementët e veprimtarive jashtë auditorit në ndihmë të procesit mësimor në IAL-të publike, njehsohen në orë si vijon:

- | | |
|--|-------------------------|
| a. provime / mbrojtje teze diplome | 0.4 / 0.5 orë /student; |
| b. kontrolle të pjesshme të programuara të dijeve | 0.25 orë/student; |
| c. udhëheqje teze diplome cikli I / II / III | 10 /20 /30 orë diplomë; |
| d. udhëheqje teze doktorate | 80 orë /vit; |
| e. mbikqyrje e projekteve të kursit | 1 orë /projekt; |
| f. mbikqyrje e detyrave të kursit | 0.3 orë /detyrë; |
| g. ndjekje dhe/ose drejtim i praktikave mësimore ngarkesa e përllogaritur si më poshtë: | |

1 ditë pune në praktikë është 5 orëshe; praktika në terren dhe praktika mësimore profesionale në shkollë, grupi mësimor duhet të jetë jo më i madh se 20 studentë; 1 orë ushtrime (mësime praktike) të moduleve/ lëndëve sportive është 0.8 orë.

Përorët e ushtrimeve (mësime praktike) të moduleve/ lëndëve sportive, që zhvillohen në terren sportiv, palestër grupi mësimor duhet të jetë jo më i madh se 18 studentë.

- | | |
|---|-------------------------|
| h. përgatitje shfaqjeje, ekspozite, gare | 10-30 orë /shfaqje; |
| i. recensë teze diplome cikli I / II / III | 5 / 10/15 orë /recensë; |
| j. oponencë teze doktorate | 25 orë /oponencë; |
| k. pjesëmarrje në juri: | |
| I. Kryetar | 15 orë |
| II. Anëtar | 10 orë |
| l. konsultime të programuara | deri në 30 orë në vit; |
| m. kolokuiume -1 në semestër | 0.15 orë /student; |

17. Çdo anëtar i personelit akademik i punësuar me kohë të plotë në IAL, duhet të përmbushë detyrimet për kohën vjetore të punës prej 1536 orë.

18. Personeli akademik i cili angazhohet në veprimtaritë e parashikuara në pikën 16, gërmat c, d, g, j, dhe k, të këtij neni, paguhet për ngarkesën e parashikuar si orë suplementare.

19. Çdo angazhim i personelit akademik në veprimtari të pagueshme dhe që nuk është parashikuar dhe miratuar në buxhetin vjetor të UK-së, duhet të marrë përpara ushtrimin të veprimtarisë miratimin e Bordit të Administrimit.

20. Personeli akademik angazhohet në veprimtari mësimdhënëse, kërkimore-shkencore artistike krijuese apo veprimtari të tjera, sipas profilit të kualifikimit të tij akademik dhe kontratës së punës të lidhur me UK-në.

Neni 37
Viti akademik sabatik

1. Personeli akademik i kategorisë “Lektor” dhe “Profesor”, me miratim të njësisë bazë ku zhvillon veprimtarinë akademike, ka të drejtë të shkëputet nga angazhimet e institucionit, një herë në shtatë vjet, për periudha kohe deri në një vit, për të punuar për përparimin e tij akademik.
2. Kjo periudhë mund të përdoret si e tërë ose me pjesë.
3. Rregullimi i marrëdhënieve juridike ndërmjet palëve për këtë periudhë bëhet nëpërmjet një marrëveshjeje në të cilën përcaktohen:
 - a. Kohëzgjatja e lejes sabatike
 - b. Objekti i lejes sabatike

Neni 38
Kohëzgjatja e punësimit të personelit akademik

1. Personeli akademik, që mban titullin “Profesor”, shërben në detyrë deri në moshën 68 vjeç, me përjashtim të rastit kur, me kërkesën e tij, largohet nga detyra. Mbështetur mbi nevojat e institucionit të arsimit të lartë dhe me pëlqimin e tij, ai mund të shërbejë në detyrë edhe pas moshës së lartpërmendur, përmes kontratave me kohëzgjatje deri në një vit, të përsëritshme ose jo.
2. Personeli akademik, që mban titullin “Profesor i asociuar”, shërben në detyrë deri në moshën 65 vjeç. Mbështetur mbi nevojat e institucionit të arsimit të lartë dhe me pëlqimin e tij, ai mund të shërbejë në detyrë edhe pas moshës së lartpërmendur, përmes kontratave me kohëzgjatje deri në një vit, të përsëritshme ose jo.

Neni 39
Masat disiplinore për personelin akademik

1. Llojet e masave disiplinore janë :
 - a. Tërheqje vëmendjeje (e cila mbahet në procesverbal)
 - b. Vërejtje me shkrim
 - c. Vërejtje me paralajmërim
 - d. Pezullim nga detyra
 - e. Largim nga detyra
2. Masat disiplinore jepen nga autoritetet drejtuese akademike, me përjashtim të largimit nga detyra që është kompetencë vetëm e rektorit.
3. Largimi nga detyra i personelit akademik të UK-së bëhet nga rektori, me propozimin e drejtuesit të njësisë bazë ku personeli akademik zhvillon veprimtarinë e tij dhe, pas miratimit të komisionit *ad hoc*, të ngritur nga Senati Akademik, në rastet e shkeljeve të rënda dhe të përsëritura të ligjit.
4. Shkeljete rënda të ligjit janë parashikuar në nenin 42 të Statutit të UK-së.

Neni 40

Procedura për dhënien e masave disiplinore

1. Drejtuesi i njësisë kryesore i propozon rektorit rastin e parashtruar nga përgjegjësi i departamentit për masë disiplinore, për shkelje të disiplinës në punë nga personeli akademik.
2. Rektori, i kalon për shqyrtim rastin Këshillit të Etikës, i cili shprehet me vendim për masën disiplinore, në rast shkelje të dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi.
3. Vendimi për caktimin e masës disiplinore për personelin akademik miratohet nga rektori.
4. Rektori ka të drejtë të japë masën disiplinore të pezullimit nga detyra për një periudhë nga 1 (një) ditë deri në 1 (një) muaj.
5. Masa disiplinore “tërheqje vëmendje” shlyhet brenda tre muajve, nëse punonjësi ndaj të cilit është marrë ajo, nuk kryen shkelje tjetër. Masat disiplinore “vërejtje me shkrim” dhe “vërejtje me paralajmërim” shlyhen brenda gjashtë muajve, nëse punonjësi ndaj të cilit është marrë ajo, nuk kryen shkelje tjetër. Pas shlyerjes së masës, punonjësi konsiderohet pa masë disiplinore.

Neni 41

Personeli ndihmësakademik

1. Personeli ndihmësakademik në UK ndahet në:
 - a. personel ndihmësakademik me karakter mësimor (laborantët dhe teknikët e TI)
 - b. personel ndihmësakademik me karakter administrativ.
2. Marrja në punë e personelit ndihmësakademik në UK kryhet me konkurrim publik.
3. Nisja e procedurës së punësimit me konkurs publik për personelin ndihmësakademik në UK vendoset me urdhër të rektorit, pas marrjes së propozimeve nga dekan i njësisë kryesore përkatëse, në rastin e vendeve të lira në këto njësi.
4. Kriteret e përgjithshme për punësim për çdo kategori të personelit ndihmësakademik janë:
 - a. Të jenë shtetas shqiptarë me zotësi të plotë për të vepruar.
 - b. Të përmbushin kërkesat ligjore për nivelin arsimor në përputhje me vendin e punës.
 - c. Të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës.
 - d. Të jenë në kushte shëndetësore të mira për të kryer detyrat përkatëse.
 - e. Të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi.
5. Për vendet e lira të personelit ndihmësakademik konkurrimi shpallet nga ky institucion, duke përcaktuar dhe kriteret e veçanta. Për vendet e lira në fakultete, dekanati përkatës në bazë të propozimeve të departamenteve përgatit kriteret e veçanta, të cilat i miraton rektori. Rektori bën shpalljen përkatëse të vendeve të lira si dhe të kriterëve për konkurrimin publik.
6. Për vendet e lira të personelit ndihmësakademik në nivel institucioni, konkurrimi shpallet nga ky institucion, duke përcaktuar dhe kriteret e veçanta të miratuara nga rektori pas propozimeve të drejtorit të drejtorisë përkatëse.
7. Komisioni i vlerësimit të kandidatave për vendet e lira të personelit ndihmësakademik në nivel fakulteti ngrihet me vendim të rektorit pas propozimit të dhënë nga dekan i përkatës dhe ka në përbërjen e tij 5 anëtarë, 3 prej të cilëve i përkasin

- fakultetit dhe 2 aparatit të rektoratit (zv.rektorin përkatës).
8. Për emërimin e personelit ndihmësakademik në nivel njësie kryesore, dekani i fakultetit i paraqet rektorit të UK-së kandidatin e renditur i pari në klasifikimin e bërë nga komisioni ad hoc.
 9. Komisioni i vlerësimit të kandidaturave për vendet e lira të personelit ndihmësakademik në nivel institucioni, ngrihet me vendim të rektorit dhe ka në përbërjen e tij 3 anëtarë, zv. rektorin përkatës, i cili është kryetar i komisionit, drejtorin e drejtorisë përkatëse dhe një specialist të fushës.
 10. Kontratat e punës për këtë kategori nënshkruhen nga rektori, mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë dhe në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë.

Neni 42

Personeli administrativ

1. Kategoritë e personelit administrativ dhe nivelet e pagave miratohen nga Bordi i Administrimit të institucionit, sipas legjislacionit në fuqi.
2. Punësimi i personelit administrativ bëhet me konkurs publik. Kriteret e përgjithshme të punësimit janë si vijon :
 - a. të jetë shtetas shqiptarë me zotësi të plotë për të vepruar.
 - b. të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës, për të cilin konkurron.
 - c. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës, për kryerje të veprës/ave penale.
 - d. të mos jetë marrë ndaj tij masa disiplinore e largimit nga puna (në rastin kur ka qenë i punësuar më parë).
3. Kriteret e veçanta dhe procedura e punësimit përcaktohen nga Bordi i Administrimit, mbështetur në Statutin dhe aktet e tjera të UK-së.
4. Të drejtat dhe detyrimet e personelit administrativ, përcaktohen në Rregulloren përkatëse të njësive ndihmëse për çështje ekonomiko-financiare dhe administrative, si dhe në kontratën individuale të punës, që nënshkruhet nga Administratori i UK-së.

Neni 43

Zgjidhja e kontratës së punës

1. Zgjidhja e kontratës së punës së personelit të UK-së bëhet në rastet e mëposhtme:
 - a. kur jep dorëheqjen.
 - b. kur bëhet i paaftë nga ana fizike apo mendore për të ushtruar detyrën.
 - c. në rastet e pamundësisë për të kryer detyrën.
 - d. kur largohet nga universiteti.
 - e. kur mbush moshën e pensionit të pleqërisë, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe/apo akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.
 - f. kur merr masën disiplinore të largimit nga detyra.
 - g. kur përfundon koha e parashikuar, në rastet e kontratave me afat të caktuar, sipas përcaktimeve të ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e

Shqipërisë” dhe ligjit nr.7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

2. Nëse lindin mosmarrëveshje gjatë apo në përfundim të detyrës mes punëmarrësit dhe punëdhënësit, palët mund t’i drejtohen gjykatës kompetente, nëse ato nuk zgjidhen me mirëkuptim.

B. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PUNONJËSIT NDIHMËSAKADEMIK DHE ADMINISTRATIV. DISIPLINA NË PUNË

Neni 44

Të drejtat e punonjësit ndihmësakademik dhe administrativ

Përveç të drejtave që parashikohen në Kushtetutë, Ligjin për arsimin e lartë, Statutin e universitetit dhe në kontratën e punës, punonjësi ka edhe këto të drejta:

1. E drejta për një punë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme në përputhje edhe me kushtet e përcaktuara në kontratën e punës.
2. E drejta për t’u ngritur në detyrë dhe për të lëvizur në mënyrë paralele.
3. E drejta për t’u trajnuar në lidhje me punën që kryen.
4. E drejta për të marrë pushimin e pagueshëm vjetor, të plotë ose të pjesshëm si edhe pushime të tjera të pagueshme
5. E drejta për t’u vënë në dijeni për çdo informacion që ka lidhje me detyrën funksionale.
6. E drejta për të shprehur lirisht pikëpamjet rreth çdo problemi që lidhet me detyrën që kryen.
7. E drejta për t’u organizuar e përfaqësuar.

Neni 45

Detyrimet e punonjësit ndihmësakademik dhe administrativ

Në respektim të disiplinës në punë, punonjësi është i detyruar:

1. Të respektojë, të zbatojë dhe të veprojë në përputhje me legjislacionin në fuqi, Statutin dhe rregulloret e universitetit, si dhe me çdo dispozitë tjetër të parashikuar në aktet e tjera me përmbajtje normative, që rregullojnë veprimtarinë e tij.
2. Të zbatojë dhe përmbushë urdhrat e titullarit dhe të eprorit nga i cili ka varësi, si dhe të ndjekë këshillat e tyre që lidhen me procedurat e punës apo të kryerjes së detyrës.
3. Të mbrojë interesat dhe pasurinë e institucionit.
4. Të ndihmojë punonjësit e tjerë të universitetit dhe të bashkëpunojë me ta, në përputhje me praktikën e përgjithshme dhe rregullat e institucionit.
5. Të respektojë orarin e punës, vetëm me urdhër të titullarit, për nevoja të institucionit është i detyruar të punojë jashtë orarit zyrtar, të cilat do të kthehen në ditë pushim.
6. Të informojë eprorin, në varësi të të cilit është, për çdo parregullsi në vendin e punës dhe defekt të teknikës së zyrës.
7. Të mbyllë të gjithë dokumentacionin apo mjetet e punës (në varësi të detyrës që kryen) përpara largimit nga vendi i punës, në mbyllje të orarit të punës.

Neni 46 **Shkeljet disiplinore**

Përbëjnë shkelje disiplinore veprimet apo mosveprimet si vijon:

1. Mosrespektimi në mënyrë të përsëritur i kohës dhe i orarit të punës.
2. Moskryerja e detyrave ose mosrespektimi i përsëritur i afateve të caktuara për kryerjen e detyrave.
3. Sjellja jo e rregullt gjatë kohës së punës me eprorët, kolegët, vartësit, studentët apo publikun.
4. Dëmtimi i pronës së institucionit, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar, apo keqpërdorimi i saj.
5. Kryerja, brenda ose jashtë kohës së punës, i veprimeve, të cilat çënojnë interesat e detyrës që ushtron punonjësi në universitet, ose të tilla që pengojnë përmbushjen e saj.
6. Shkelja e Rregullores së Etikës.
7. Moszbatimi i dispozitave ligjore në përmbushjen e detyrave funksionale.
8. Mosrespektimi i detyrave të tjera të parashikuara në statut, rregullore apo akte të tjera me përmbajtje normative që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë së universitetit.

Neni 47 **Masat disiplinore**

1. Në rast të shkeljes së disiplinës në punë mund të merren këto masa disiplinore:
 - a. Tërheqje vëmendjeje (e cila mbahet në procesverbal);
 - b. vërejtje me shkrim;
 - c. paralajmërim për largim nga detyra;
 - d. largim nga detyra.
2. Masat disiplinore të përcaktuara përkatësisht në shkronjat (a), (b) dhe (c) mund të shlyhen, në qoftë se brenda një viti nga dita e dhënies së tyre nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore. Masat disiplinore të shlyera hiqen nga dosja personale.

KREU VI **PROGRAMET E STUDIMIT DHE ORGANIZIMI I TYRE**

Neni 48 **Format e studimeve dhe pranimi i studentëve**

1. Format e studimeve në UK janë:
 - a. studime me kohë të plotë;
 - b. studime me kohë të zgjatur.
2. Studimet me kohë të zgjatur mund të ofrohen në:
 - a. Programet e studimit një deri në dyvjeçare me karakter profesional pas arsimit të mesëm;

- b. Programet e ciklit të dytë “Master Profesional” ;
 - c. Programet e ciklit të tretë “Master Ekzekutiv”
3. Programet e studimit, që japin të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar, organizohen vetëm në formën e studimeve me kohë të plotë.
 4. Pranimet e studentëve në UK në të gjitha programet e studimit bëhen me vendim të Senatit Akademik, në përputhje me standardet shtetërore, të kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore. Këto standarde verifikohen dhe certifikohen nga ministria përgjegjëse për arsimin, përpara deklarimit të kuotave të pranimit nga të gjitha institucionet e arsimit të lartë.

Neni 49

Hapja dhe riorganizimi i programeve të studimit

1. Për hapjen dhe riorganizimin e një ose disa programeve të studimit, UK-ja duhet të depozitohet në MASR dokumentacionin dhe formularin sipas akteve ligjore në fuqi (Udhëzim Nr. 31, datë 29.12.2017) deri në datën 30 nëntor për vitin akademik pasardhës.
2. Hapja dhe /ose riorganizimi i një ose disa programeve të studimit bëhet duke u mbështetur në vlerësimin e nevojave për njohuri, aftësi dhe kompetenca në tregun e punës, si dhe duke u provuar se është në gjendje të ofrojë garancitë e nevojshme akademike e infrastrukturore dhe mbështetjen e nevojshme financiare për veprimtarinë e kërkuar.
3. Hapja e programeve të studimit bëhet me urdhër të ministrit të MASR-së, pas plotësimit të kriteve dhe kërkesave ligjore në fuqi.

Neni 50

Dokumentacioni për hapjen e programeve të reja të studimit për të gjitha ciklet

1. Dokumentacioni që duhet të depozitohet për hapjen e programeve të reja të studimit për të gjithë ciklet, përbëhet nga:
 - a. Kërkesa e hapjes së programit/eve të reja të studimeve, në të cilën specifikohen njësia bazë që do ta ofrojë atë, emërtimi, cikli, lloji dhe kodi i programit të studimit, kreditet që fitohen, kohëzgjatja normale, forma dhe gjuha e studimit, sipas akteve ligjore në fuqi (Udhëzim Nr. 31, datë 29.12.2017)
 - b. Të dhënat për aktin e hapjes dhe të lejës për fillimin e veprimtarisë akademike të institucionit dhe aktin e hapjes/riorganizimit të njësisë kryesore që e ofron, sipas akteve ligjore në fuqi (Udhëzim Nr. 31, datë 29.12.2017)
 - c. Propozimin e njësisë bazë, shoqëruar me argumentet përkatëse që mbështesin nevojën për hapjen e programit/eve të ri/reja.
 - d. Vendimi i Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit, që miraton hapjen e programit/eve të studimit.
 - e. Mandat pagesën për vlerësimin nga eksperti të programit sipas përcaktimeve në VKM-së Nr.418, datë 10.5.2017 dhe VKM-së Nr.109, datë 15.2.2017.
 - f. Lista e plotë emërore e personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, për të gjithë programet e studimit, së bashku me ngarkesat dhe formën e punësimit, si dhe titullin dhe gradën përkatëse. Dosja e personelit përmban:

I. Jetëshkrimin;

- II.** Kontratën e punës për personelin efektiv ose një aktmarrëveshje dypalëshe për personelin e planifikuar për t'u angazhuar me kohë të plotë në rast të hapjes së programit;
 - III.** Dokumente që vërtetojnë shkollimin e kualifikimet, titujt dhe gradat (fotokopje);
 - IV.** Letrën e angazhimit të çdo anëtari të personelit akademik të planifikuar për t'u angazhuar me kohë të pjesshme dhe lejen e punëdhënesit kryesor (sipas nenit 64 pika 2 e Ligjit Nr.80/2015).
 - V.** Në rastin e hapjes së një programi studimi në gjuhë të huaj, personeli akademik i rekrutuar duhet të plotësojë së paku një nga kriteret e mëposhtme:
 - VI.** Të ketë fituar së paku një diplomë të një programi studimi në një nga ciklet e studimeve universitare të kryer në gjuhën në të cilën do të zhvillohet programi i studimit.
 - VII.** Të zotërojë nivelin C1 të njohjes së gjuhës respektive, në të cilën do të ofrohet programi, e vërtetuar përmes testeve ndërkombëtare, të cilat ndodhen në listën e miratuar nga MASR-ja për pranimet në ciklin e dytë.
 - VIII.** Deklaratë mbi numrin e përgjithshëm të studentëve ekzistues dhe të kuotave të studentëve të parashikuar për programin/ete ri/e reja që kërkohet/n të hapen. Kjo deklaratë shoqërohet me deklaratën nga UK-ja të nënshkruar nga titullari dhe me vulën e institucionit, mbi përmbushjen e standarteve akademike dhe të infrastrukturës dhe mbi sigurimin e mjeteve të nevojshme financiare për përfundimin e studimeve nga secili student i regjistruar, sipas akteve ligjore në fuqi (Udhëzim Nr. 31, datë 29.12.2017)
- g.** Modeli i kontratës së shërbimit (regjistrimit) që studenti lidh me UK-në, si dhe tarifa e shkollimit për studentët, bëhet sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
 - h.** Në rast se UK-ja parashikon zgjerim të infrastrukturës ekzistuese në dispozicion të programeve, depozitohet:
 - Relacioni i verifikimit të godinës së re, i përpiluar nga një person juridik apo fizik i licensuar nga organi kompetent shtetëror, sipas kuadrit ligjor në fuqi.
 - Planimetria dhe planvendosja e godinës/pjesës së re të institucionit, leja e shfrytëzimit të godinës, së bashku me bazën materiale dhe didaktike. Aktin e zotërimit të godinës apo kontratës së qirasë me afat së paku 3-vjeçar, të shoqëruar me vërtetimin e pronësisë së qiradhënësit.
 - i.** Dokumentacion mbi programet e studimit të plotësuar në të gjithë elementët e tij, në zbatim të VKM-së për elementët e programeve të studimit:
 - Rregullorja e UK-së
 - Rregullore mësimore e programit të studimit
 - Plani mësimor për çdo program studimi
 - Programet e lëndëve (syllabuset) të nënshkruara nga hartuesit/titullarët e tyre. Në rastin kur do aplikohet për hapjen e më shumë se një programi studimi në të njëjtën kohë, syllabuset e lëndëve që shfaqen në më shumë se një program studimi depozitohen në një kopje të vetme.
 - 2.** Gjithë dokumentacioni i mësipërm duhet të depozitohet edhe i skanuar në format elektronik (PDF) në një CD/flashdrive të cilat paraqiten së bashku me dokumentacionin për aplikim.

Neni 51

Hapja e programeve të përbashkëta të studimit

Në rast bashkëpunimi me një institucion tjetër vendas ose të huaj të arsimit të lartë për hapjen e programeve të përbashkëta të studimit, së bashku me dokumentacionin e përshkruar në nenin 48 të kësaj Rregulloreje, kërkohet depozitimi edhe i:

1. Aktit të themelimit/licensimit të institucionit të vendit të origjinës.
2. Aktit të akreditimit të institucionit partner ose të programit të studimit.
3. Marrëveshjes specifike për programin konkret të studimit ku të parashikohen modalitetet e ofrimit të tij, si autorësia dhe pronësia e syllabuseve të depozituara, gjuha dhe metoda e mësimit dhe provimeve, shkëmbimi i stafit pedagogjik, etj. Kjo marrëveshje mund të jetë dhe në formën e rregullores së përbashkët mësimore.
4. Llojit të diplomës (e dyfishtë, e shumëfishtë, e përbashkët) dhe modelin e diplomës së miratuar nga të dyja palët.
5. Deklaratë për plotësimin e standardeve akademike dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi, e nënshkruar nga titullari dhe me vulën e institucionit.

Neni 52

Procedura për shqyrtimin e aplikimeve për hapjen e programeve të reja të studimit të të gjitha cikleve

1. Kërkesa dhe dokumentacioni i përcaktuar më sipër depozitohen në MASR. Struktura e ngarkuar së bashku me strukturat juridike, brenda tri javëve bën shqyrtimin paraprak të dokumentacionit. Në rastet kur dokumentacioni është i paplotë apo konstatohen mangësi/pasaktësi, MASR-ja i kërkon UK-së të bëjë plotësimin/saktësimin e dokumentacionit, brenda katër javëve nga data e kthimit për plotësim/saktësim. Në mungesë të plotësimit/saktësimin të dokumentacionit të kërkuar, praktika përkatëse refuzohet dhe arkivohet, duke konsideruar që subjekti ka hequr dorë në heshtje nga kërkesa e bërë.
2. Dokumentacioni i përcaktuar si më sipër, i kalon për vlerësim ekspertit, të caktuar nga MASR-ja, i zgjedhur nga lista e ekspertëve të miratuar.
3. Eksperti brenda tri javësh dorëzon raportin e vlerësimit në MASR. Në rastet kur dokumentacioni është i paplotë, apo konstatohen mangësi/pasaktësi nga eksperti, subjektit i kërkohet plotësimi i tij brenda tri javësh nga marrja e njoftimit nëpërmjet ministrisë.
4. Dokumentacioni i plotësuar, i kalon për rivlerësim ekspertit, i cili brenda tri javësh, dorëzon raportin e rivlerësimit në MASR. Praktika nuk mund të shqyrtohet më shumë se dy herë. Në rastet kur dokumentacioni është përsëri i paplotë praktika përkatëse refuzohet dhe arkivohet.
5. Në rast kur vlerësimi përfundimtar i MASR-së është pozitiv, ministri miraton hapjen e programit të ri të studimit.
6. Në rast ankese nga ana e subjektit, ministri i MASR-së i kërkon mendim të argumentuar me shkrim Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator. Në përfundim është ministri i MASR-së që vendos mbi refuzimin apo vijimësinë e praktikës së depozituar. Në rast refuzimi praktika arkivohet në MASR.

Neni 53

Dokumentacioni për riorganizimin e programeve të studimit të të gjitha cikleve

1. Dokumentacioni që UK-ja duhet të depozitojë për riorganizim të programeve të studimit përbëhet nga:
 - a. Kërkesa e institucionit për riorganizim programesh studimi, lloji, forma dhe gjuha e studimit, shoqëruar me të dhënat për aktin e hapjes/riorganizimit të programeve të studimit ekzistuese që kërkohen të riorganizohen. Në kërkesë argumentohen arsyet që mbështesin kërkesën për riorganizimin e programit.
 - b. Vendimi i Senatit dhe i Bordit të Administrimit
 - c. Planet mësimore të programeve të propozuara.
 - d. Rregulloren e programeve të studimit që riorganizohen.
 - e. Programet e lëndëve (syllabuset) të nënshkruara nga titullari i lëndës.
 - f. Lista e stafit akademik në funksion të programeve të studimit dhe forma e angazhimit (me kohë të plotë, me kohë të pjesshme).

Neni 54

Procedura e shqyrtimit të riorganizimit të programeve të studimit

1. Kërkesa dhe dokumentacioni depozitohen në MASR. Shqyrtimi mbi plotësimin dhe rregullsinë e praktikës së depozituar me dokumentet e kërkuara si më sipër, bëhet nga njësia përgjegjëse dhe struktura juridike në MASR, brenda tri javëve nga depozitimi i kërkesës. Në rastet kur dokumentacioni është i paplotë, apo konstatohen mangësi/pasaktësi, MASR-ja i kërkon IAL-së të bëjë plotësimin/saktësimin e dokumentacionit brenda katër javëve nga data e kthimit për plotësim/saktësim. Në mungesë të plotësimit/saktësimin të dokumentacionit të kërkuar, praktika përkatëse refuzohet dhe arkivohet.
2. Dokumentacioni i kalon për vlerësim ekspertit. Eksperti brenda tri javësh dorëzon raportin e vlerësimit në MASR. Në rastet kur dokumentacioni është i paplotë, apo konstatohen mangësi/pasaktësi nga eksperti, subjekti i kërkohet plotësimi i tij, brenda tri javësh nga marrja e njoftimit.
3. Dokumentacioni i plotësuar nga subjekti, i kalon për rivlerësim ekspertit. Eksperti brenda tri javësh dorëzon raportin e rivlerësimit në MASR. Praktika nuk mund të shqyrtohet me shumë se dy herë. Në rastet kur dokumentacioni është përsëri i paplotë praktika refuzohet dhe arkivohet.
4. Në rast kur vlerësimi përfundimtar i MASR-së është pozitiv, ministri miraton programin e riorganizuar të studimit.
5. Në rast ankese nga ana e subjektit, ministri i MASR-së i kërkon mendim të argumentuar me shkrim Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator. Në përfundim është ministri i MASR-së që vendos mbi refuzimin apo vijimësinë e praktikës së depozituar. Në rast refuzimi, praktika arkivohet në MASR.
6. Në rastin kur riorganizimi i programit, bëhet për shkak të ndryshimeve në legjislacionin për arsimin e lartë, përshtatja e programeve të studimit me ndryshimet ligjore bëhet me vendim të Senatit Akademik. MASR-ja pas njoftimit me shkrim nga UK-ja për ndryshimet e bëra në programet e studimit, në përputhje me kërkesat e reja të legjislacionit, merr masa për reregjistrimin e formave të reja të diplomave (nëse është e nevojshme).

Neni 55

Procedurat për mbylljen e programeve të studimit të të gjitha cikleve

1. Akti për hapjen e një programi studimi anulohet, në rastet si më poshtë:
 - a. UK-ja për arsye të ndryshme i drejtohet ministrit të MASR-së me kërkesën për mbylljen e një ose disa programeve të studimit. Kërkesa duhet të shoqërohet me vendimet përkatëse të Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit. Institucioni është përgjegjës për pasojat juridike të ardhura nga mbyllja e programit për studentët që kanë përfunduar programin apo janë në proces ndjekjeje të programit.
 - b. Në rast se UK-ja nuk e aktivizon programin brenda dy viteve akademike të njëpasnjëshme nga dalja e urdhrimit të hapjes, leja e dhënë për hapjen e këtij programi studimi bëhet e pavlefshme.
 - c. Në rastin kur programi i aktivizuar i studimit bëhet joaktiv për dy vite akademike të njëpasnjëshme, leja e dhënë për hapjen e këtij programi studimi bëhet e pavlefshme.
 - d. Programi i studimit i bërë i pavlefshëm, mund të rihapet, pasi UK-ja depoziton në MASR projektin për rihapjen e tij, si kërkesë për program të ri.
 - e. Bazuar në konstatime të vërtetuara mbi mosrespektimin e kriterëve të ligjshmërisë dhe /ose të akreditimit të një programi studimi.
2. Bazuar në rastet e përcaktuara në gërmën “a” të nenit të mësipërm, ministri i MASR-së urdhëron mbylljen e programit përkatës në fund të vitit akademik.
3. Studentët që nuk kanë përfunduar ende studimet në programin që mbyllet kanë të drejtë të transferojnë studimet brenda të njëjtës institucion ose në një institucion tjetër të arsimit të lartë.

Neni 56

Programet e studimit në UK

1. Programet e studimit organizohen në module dhe vlerësohen në kredite, në përputhje me Sistemin Europian të Transferimit të Krediteve (ECTS).
2. Sasia normale e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student është 60 kredite.
3. Programet e studimit në UK hartohen nga njësitë bazë dhe i paraqiten për miratim Senatit
4. Programet e studimit në UK janë të organizuara në tri cikle të njëpasnjëshme: cikli i parë, cikli i dytë dhe cikli i tretë, referuar niveleve 6-8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
5. UK ofron dhe certifikata/diploma profesionale, referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
6. UK-ja shpall publikisht programet e studimit që ofron para fillimit të aplikimeve për pranimin e studentëve.
7. Çdo program studimi ka strukturën dhe përmbajtjen e tij, të cilat hartohen në përputhje me standardet e parashikuara në Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë, në respektim të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe duke marrë në konsideratë kërkesat e tregut të punës, dhe punësimin e ardhshëm të studentëve.

Neni 57

Programet e studimit me karakter profesional

1. UK-ja mund të ofrojë programe studimi me karakter profesional, pas arsimit të mesëm, me 60 ose 120 kredite formimi, referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Kohëzgjatja e tyre normale është një ose dy vite akademike dhe në përfundim lëshohet respektivisht “Certifikatë profesionale” ose “Diplomë profesionale” në fushën e arsimit të kryer.
2. Kreditet e grumbulluara gjatë studimeve me karakter profesional, mund të transferohen në studimet e ciklit të parë, që referohet në nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, sipas kriterëve të përcaktuara në rregulloret e programeve të studimit të hartuara nga njësitë bazë që ofrojnë programe të tilla.
3. UK-ja mund të njohë kredite të formimeve universitare në një program studimi, sipas kriterëve të përcaktuara, njohuri dhe aftësi të profesioneve të certifikuara nga legjislacioni në fuqi, si dhe njohuri të veprimtarive formuese të nivelit pas shkollës së mesme, që janë në përputhje me objektivat specifike të programit përkatës të studimit.
4. Në këtë rast, numri maksimal i krediteve të njohura nuk i kalon 60 (gjashtëdhjetë) kredite për programet e studimit të ciklit të parë dhe 40 (dyzet) kredite për programet e ciklit të dytë.

Neni 58

Programet e Ciklit të Parë të Studimeve

1. Programet e ciklit të parë të studimeve, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, organizohen me 180 kredite (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është tri vite akademike.
2. Studentët në programet e ciklit të parë të studimeve diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome.
3. Studentët që do të përgatitin një punim diplome do të përmbushin kriteret që përcaktohen nga njësia bazë në Rregulloret përkatëse të programeve të studimit. Në përfundim të programeve të ciklit të parë lëshohet diploma “Bachelor” në fushën e arsimit të kryer.

Neni 59

Pranimi në Ciklin e Parë të Studimeve

1. Pranimi i studentëve në programet e studimit të ciklit të parë në UK, bëhet sipas kuotave të paracaktuara të propozuara nga njësitë bazë dhe të miratuara nga Senati Akademik dhe është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson:
 - a. Kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave.
 - b. Kriterin e rëndësisë (koeficienti i përcaktuar për shkollën nga vjen) si dhe gruplëndët apo mesataren e tyre, sa i takon përputhshmërisë me fushat dhe programet e studimit në UK.
 - c. Kriteret shtesë të pranimit pasqyrohen në Rregulloret e njëjësive bazë

Neni 60

Programet e Ciklit të Dytë të Studimeve

1. Cikli i dytë i studimeve në UK përfshin programet e studimit “Master i shkencave” dhe “Master profesional”, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Programet e studimit “**Master i shkencave**” pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike, si edhe me aftësi për kërkim shkencor në një fushë të caktuar. Këto programe:
 - a. organizohen me jo më pak se 120 kredite formimi në vijim të ciklit të parë dhe kanë kohëzgjatje normale dy vite akademike.
 - b. përmbyllen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Master i shkencave” në fushën e arsimimit të kryer.
3. Programet e studimeve “**Master profesional**” pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara profesionale në një fushë të caktuar. Këto programe :
 - a. organizohen me 60 ose 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është një vit ose dy vite akademike.
 - b. përmbyllen me provim përfundimtar formimi, ose punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Master profesional” në fushën e arsimimit të kryer.
 - c. Për studentët që do të kryejnë punim diplome, njësitë bazë mund të vendosin një notë mesatare që pasqyrohet në Rregulloret e programeve të studimit.
 - d. Një kopje e punimit të diplomës të dorëzohet në bibliotekat e njësive kryesore.

Neni 61

Pranimi në Programet e Ciklit të Dytë të Studimeve

1. Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret e pranimit të vendosura nga njësitë bazë ku ata aplikojnë.
2. Kriteret e pranimit të kandidatëve në programet e ciklit të dytë të studimeve përcaktohen nga njësia bazë ofruese e programit. Kriteret bëhen publike nga njësia kryesore përkatëse pasi miratohen nga Senati Akademik.
3. Kriter pranimi në një program studimi të ciklit të dytë “Master i shkencave” është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian : anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri. Niveli i gjuhës përcaktohet me akt nënligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.
4. UK mund të njohë kredite të përfituara në programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional”, me qëllim transferimin e tyre në programet e studimit “Master i shkencave”. Kriteret dhe procedurat e njohjes së krediteve përcaktohen në rregulloren e njësive bazë.

Neni 62

Programet e ciklit të tretë të studimeve

1. Cikli i tretë i studimeve përfshin programet e studimeve Master ekzekutiv, programet e studimeve specializuese afatgjata, si dhe studimet e doktoraturës, referuar nivelit 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Programet e studimeve Master ekzekutiv ofrojnë arsimim të një niveli të lartë shkencor dhe profesional. Ato kanë kohëzgjatje normale një ose dy vite akademike dhe organizohen

përkatësisht me 60 ose 120 kredite. Ato përmbillen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diploma «Master ekzekutiv » në fushën e arsimimit të kryer.

3. Një kopje e punimit të diplomës të dorëzohet nga doktoranti në bibliotekat e njësive kryesore.

Neni 63

Kriteret e posaçme për hapjen e programeve të reja të ciklit të tretë të studimit “Doktoratë”

1. Kriteret të përgjithshme për hapjen e programeve të reja të ciklit të tretë të studimit Doktoratë përcaktohen si më poshtë vijon :
 - a. Programet e studimit « Doktoratë » mund të hapen në UK, kur ka programe studimi të licensuara dhe akredituara/riakredituara të ciklit të parë dhe të dytë në të njëjtën fushë ose fushë të përafërt me atë të programit « Doktoratë ».
 - b. Për këtë duhet të paraqitet dokumentacioni sipas nenit 50 të kësaj Rregulloreje dhe kriterëve të posaçme sipas këtij neni, për hapjen e programeve të reja të ciklit të tretë të studimit « Doktoratë ».
 - c. Programet e studimit të doktoratës realizojnë formimin e bazuar mbi hartimin e projekteve individuale për aftësimin e pavarur të kërkimit shkencor, duke u dhënë doktorantëve një kulturë ndërdisiplinare në kuadër të një projekti shkencor inovativ, që ka për qëllim përgatitjen e tyre shkencore dhe profesionale. Së bashku me dokumentacionin për hapjen e programeve të studimit duhet të dorëzohen edhe projektet kërkimore-shkencore të hartuara për programin e studimit.
 - d. UK-ja duhet të nxisë nivelin e zhvillimit të kërkimit shkencor dhe ndihmon në aftësimin e studentit për të përfunduar me sukses programin e studimit;
 - e. Në kuadër të programit të studimit, UK-ja duhet të organizojë veprimtari me ndikim në formimin e përgjithshëm si dhe duhet të këshillojë studentët të marrin pjesë në veprimtari shkencore, seminare dhe debate ndërdisiplinore, të lidhura ngushtë me fushën specifike në të cilën ndjekin studimet dhe që i ndihmojnë në punën e tyre kërkimore sipas përcaktimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme të UK-së.
 - f. UK-ja duhet të ndihmojë në aftësimin e studentit për përvetësimin e metodologjive të kërkimit për veprimtari krijuese të pavarura si, artikuj shkencorë, prezantime, qasje standarde për referenca, bibliografi, indekse dhe të shkruarit e përmbajtjes, si bazë për përpunimin e tezës së doktoratës, punën e pavarur, përdorimin e burimeve të informacionit, administrimin dhe përpunimin e informacionit, përdorimin e teknologjive bashkëkohore për studime e komunikime, përvetësimin e metodave të avancuara të analizës dhe përpunimit të të dhënave, njohjen dhe përvetësimin e terminologjisë së specializuar lidhur me fushën kërkimore të doktorantit si edhe, përvetësimin e aftësive komunikuese në nivel shkencor.
 - g. Për realizimin e projektit kërkimor, UK-ja duhet të garantojë personelin e saj akademik të nevojshëm me tituj dhe grada shkencore.
 - h. Që UK-ja të ofrojë këtë program studimi duhet të ketë struktura administrative dhe kërkimore të mjaftueshme për veprimtaritë e parashikuara për kryerjen e kërkimeve dhe mund të bashkëpunojë me një apo më shumë IAL, vendase apo të huaja, në bazë të marrëveshjeve të lidhura midis tyre, në mbështetje të procesit dhe përmirësimit të standardeve.
 - i. Programet e studimit kanë një kohëzgjatje jo më pak se tre vite akademike dhe jo më shumë se pesë vite akademike dhe zhvillohen me kohë të plotë. Në rastet kur

doktoranti është i punësuar si personel akademik, kërkimor shkencor në një institucion tjetër të arsimit të lartë, të kërkimit bazë ose të zbatuar, programi i studimit mund të zhvillohet me kohë të zgjatur. Në këtë rast UK-ja përcakton vetë tarifën shtesë të studimit.

Neni 64

Personeli akademik i programit të studimit të ciklit të tretë “Doktoratë”

1. Personeli akademik i programit të studimit të ciklit të tretë « Doktoratë » duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme :
 - a. Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit, përbëhet nga pedagogë me tituj akademikë të kategorisë « Profesor ».
 - b. Në rastet kur programet e studimit do të kryhen bashkarisht me një IAL të vendeve anëtare të BE-së, Kanadasë dhe SHBA-së, udhëheqësi i IAL-së së huaj mund të jetë edhe me gradën shkencore « Doktor »/PhD.
 - c. Drejtuesi shkencor i studentit është përgjegjës për drejtimin, këshillimin, vlerësimin e ecurisë të studentit si dhe përparimin e punës kërkimore të zhvilluar.
 - d. Njësia bazë ngarkon një prej anëtarëve të personelit akademik të programit të studimit që mban titullin akademik të kategorisë « Profesor », në cilësinë e përgjegjës të programit të studimit.

Neni 65

Organizimi i programit të studimit të ciklit të tretë “Doktoratë”

1. Programi i studimit i ciklit të tretë “Doktoratë” duhet të organizohet si më poshtë:
 - a. Përgjegjësi i programit të studimit ndjek të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me planifikimin dhe zbatimin e programit të kërkimeve, duke siguruar praninë dhe angazhimin e personelit akademik të kualifikuar në fushën shkencore të këtij programi.
 - b. Njësia bazë propozuese harton rregulloren e programit të studimit në të cilën parashikohen të gjitha proceset dhe elementët përbërës të nevojshëm për realizimin e këtij programi. Rregullorja miratohet nga Senati Akademik.
 - c. Në përfundim të çdo viti akademik, drejtuesi shkencor miraton raportin e veprimtarive të kryera nga doktorantët në përputhje me rregulloren e programit të studimit.
 - d. Në rast se këto programe studimi zhvillohen bashkërisht me një IAL tjetër mbi bazën e marrëveshjeve ndër-institucionale përkatëse, seli administrative dhe institucion përgjegjës për realizimin dhe mbarëvajtjen e tyre është IAL-ja pranë së cilës zhvillohet pjesa më e madhe e veprimtarisë dhe mbahet dokumentacioni i procesit mësimor.
 - e. IAL-ja përgjegjëse për realizimin dhe mbarëvajtjen e programit të studimit duhet të disponojë burimet finaciare, infrastrukturën dhe personelin e nevojshëm akademik për realizimin e programit të studimit.
 - f. Për realizimin e programeve të përbashkëta të studimit me institucione të huaja të arsimit të lartë, mund të zbatohen standarde të ndryshme nga ato shtetërore, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.
 - g. Kriteret, kuotat, tarifat dhe modalitetet e pranimit në këto programe studimi propozohen nga njësia/njësitë bazë propozuese e/të programit të studimit, në

përputhje me standardet shtetërore të cilësisë dhe miratohen nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit.

- h.** Gjatë periudhës së studimeve në një program studimi, studenti nuk mund të ndjekë njëkohësisht programe të tjera studimi, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer.
- 2.** Studimet e doktoratës zhvillohen me kohë të plotë pranë njësisë bazë ose me kohë të zgjatur në ato raste kur doktoranti është i punësuar si personel akademik në një institucion tjetër të arsimit të lartë apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar.
- 3.** Për të mundësuar zhvillimin e studimeve të doktoraturës, UK-ja, njësitë kryesore dhe ato bazë, hartojnë projekte kërkimore-shkencore dhe zhvillimi për këto studime. Ato aplikojnë për financim pranë AKKSHI-t apo institucioneve të tjera financuese.
- 4.** Kur studimet e doktoratës zhvillohen në bashkëpunim midis institucioneve të arsimit të lartë, pjesë të procesit kërkimor, mund të zhvillohen pranë institucioneve bashkëpunuese.
- 5.** Numri i studentëve doktorantë përcaktohet nga njësia bazë dhe projekti kërkimor i çdo doktoranti përcaktohet në varësi të projekteve kërkimore të kësaj të fundit.
- 6.** Studimet e doktoratës ndërtohen mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor në fushat e përcaktuara nga njësia bazë ose njësia kryesore. Këto programe:
 - a.** kanë në themel kërkimin shkencor dhe veprimtaritë krijuese.
 - b.** zgjasin jo më pak se tri vite akademike dhe jo më shumë se pesë vite akademike.
 - c.** në përfundim të studimeve të doktoratës lëshohet diploma me gradën shkencore “Doktor”.
- 7.** Për kryerjen e studimeve të doktoratës, studenti mund të përfitojë edhe financime nga subjekte të tjera apo të vetëfinancohet.
- 8.** Drejtuesit shkencorë të doktorantëve duhet të kenë titullin “Profesor” ose “Profesor i asociuar” dhe mund të udhëheqin, respektivisht, një numër të caktuar doktorantësh në të njëjtën kohë. Ky numër përfshin të gjitha udhëheqjet që personeli akademik i kategorisë “Profesor” ndjek në të gjitha institucionet e arsimit të lartë ku ai është i angazhuar dhe përcaktohet në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë.
 - a.** Në rastet kur një pjesë e studimeve të doktoratës kryhet në një institucion të arsimit të lartë të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, SHBA-ve dhe Kanadasë, bashkudhëheqësi në institucionin pritës mund të jetë me gradën shkencore “Doktor”(PhD)
- 9.** Të dhëna më të hollësishme në lidhje me programet e ciklit të tretë të studimeve përcaktohen në Rregulloren e studimeve të doktoratës.

Neni 66

Kriteret për fitimin e gradës shkencore “Doktor”

- 1.** Studimet e doktoratës zhvillohen me kohë të plotë pranë njësisë bazë ose me kohë të zgjatur në ato raste kur doktoranti është i punësuar si personel akademik në një institucion tjetër të arsimit të lartë apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar, pranë institucioneve të arsimit të lartë të llojit “universitet” ose “akademi”, të cilat plotësojnë kriteret ligjore për të qenë të tilla.
- 2.** Grada “Doktor” fitohet pas mbrojtjes me sukses të tezës së disertacionit, në përfundim të studimeve të doktoratës në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, sipas

kritereve dhe brenda afateve të përcaktuara nga legjislacioni për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.

3. Studimet e doktoratës zhvillohen në formën e grupeve kërkimore, që drejtohen nga personeli akademik, që ka titullin akademik “profesor i asociuar” ose “profesor”.
Numri i doktorantëve në përbërje të secilit grup kërkimor, i cili përfshin të gjitha udhëheqjet që personeli akademik ndjek në të gjitha institucionet e arsimit të lartë ku ai është i angazhuar, është:
 - a. Jo më shumë se 7 (shtatë), në rastin e personelit akademik që mban titullin “profesor”;
 - b. Jo më shumë se 5 (pesë), në rastin e personelit akademik që mban titullin “profesor i asociuar”;
 - c. Jo më shumë se 3 (tre), në rastin kur personeli akademik “profesor i asociuar” ose “profesor”, është i angazhuar me kohë të pjesshme.
4. Kandidati aplikon individualisht në programin e studimit të miratuar në fushat e kërkimit shkencor, të ofruara nga njësi bazë ose njësi kryesore. Njësi bazë miraton programet individuale të kërkimit të kandidatëve vetëm për ato fusha, të cilat u përkasin programeve të miratuara të doktoratës që ajo ofron. Kur fushat e kërkimit janë të ndërthurura ndërmjet dy ose më shumë njësive bazë, njëra prej njësive bazë caktohet përgjegjëse për ofrimin e programit të kërkimit të kandidatit, në dakordësi ndërmjet tyre.
5. Njësi kryesore, në rregulloren e ciklit të tretë të studimeve, përcakton kriteret specifike:
 - a. që kandidati duhet të plotësojë për t’u pranuar apo për të transferuar studimet në programin e studimit, sipas fushës së kërkimit;
 - b. për vlerësimin vjetor të ecurisë së kandidatëve dhe vazhdimin e punës për zhvillimin e projektit kërkimor gjatë periudhës së studimeve të doktoratës;
 - c. që kandidati duhet të plotësojë përpara mbrojtjes përfundimtare të tezës së disertacionit;
 - d. kur studimet e doktoratës ndërpriten, shtyhen ose pezullohen;
 - e. për afatet e pagesës për të gjithë ciklin e programit.
6. Kriteret bazë, që duhet të plotësojë kandidati përpara mbrojtjes së disertacionit, janë:
 - a. Të ketë realizuar si autor i parë ose i dytë, kur autor i parë është udhëheqësi shkencor, së paku 3 (tre) referime, 2 (dy) nga të cilat të jenë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të BE-së, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “*Proceedings*”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN;
 - b. Të ketë botuar, së paku, 3 (tre) artikuj shkencorë në revista shkencore, nga të cilat 2 (dy) të jenë botuar ose pranuar për botim në revista të indeksuara të vendeve të OECD-së, BE-së ose G20-ës, me bord editorial, ku së paku, në njërin prej tyre të jetë autor i parë dhe në tjetrin autor i dytë.
7. Kandidati harton disertacionin sipas formatit të miratuar në rregulloren e ciklit të tretë të studimeve. Disertacioni duhet të sjellë risi teorike dhe/ose empirike në fushën përkatëse të kërkimit, si dhe të jetë një kontribut në avancimin e njohurive shkencore. Disertacioni hartohet në gjuhën shqipe dhe një përmbledhje e tij (2000-4000 fjalë) në një nga pesë gjuhët e BE-së: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht, në format të shtypur dhe elektronik. Disertacioni miratohet nga udhëheqësi shkencor përpara dorëzimit.

8. Kandidati dorëzon disertacionin së bashku me dosjen, pranë drejtuesit të njësisë kryesore, i cili ia përcjell për vlerësim njësisë bazë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e dorëzimit. Pas vlerësimit nga njësi bazë, disertacioni dhe dosja e kandidatit i përcillen Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”, brenda 30 (tridhjetë) ditëve. Komisioni, nëse e vlerëson pozitivisht dosjen, brenda 30 (tridhjetë) ditëve ngre jurinë për vlerësimin e disertacionit. Juria cakton datën e mbrojtjes së disertacionit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga formimi i saj. Disertacioni prezantohet përpara jurisë, e cila e vlerëson atë. Juria harton raportin e vlerësimit dhe ia dërgon Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”, i cili, brenda 10 (ditëve), merr vendimin për dhënien e gradës shkencore “doktor” dhe ia përcjell për procedura të mëtejshme drejtuesit të njësisë kryesore.
9. Nëse njësi bazë jep vlerësim negativ për disertacionin dhe/ose dosjen, kandidati ka të drejtë të riparqesë disertacionin dhe/ose dosjen të plotësuar pas një periudhe jo më të shkurtër se 3 (tre) muaj.
10. Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”, i cili monitoron procesin për dhënien e gradës shkencore “doktor”, përbëhet nga jo më pak se 5 (pesë) anëtarë të zgjedhur të njësisë kryesore ku ofrohet programi i doktoratës, që kanë titullin akademik “profesor i asociuar” ose “profesor”.
11. Juria për mbrojtjen e gradës shkencore “doktor” ngrihet nga Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” dhe ka në përbërje 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët, të paktën 2 (dy) anëtarë u përkasin njësisë bazë nga institucione homologe, vendase ose të huaja. Dy anëtarë të jurisë caktohen oponentë për vlerësimin e disertacionit, njëri prej të cilëve i përket njësisë bazë nga insitucione homologe, vendase ose të huaja. Anëtarët e jurisë propozohen nga njësi bazë, me miratimin e drejtuesit të njësisë kryesore. Numri i anëtarëve të propozuar është jo më pak se 8 (tetë).
12. Lista e të diplomuarve në programet e ciklit të tretë përcillet nga IAL-të në ministrinë përgjegjëse për arsimin, për t’u pasqyruar në regjistrin shtetëror të gradave shkencore e titujve akademikë dhe në regjistrat përkatës të IAL-së. Në përfundim të studimeve lëshohet diplomë për dhënien e gradës shkencore “doktor”, e nënshkruar nga drejtuesi i njësisë kryesore dhe rektori.
13. Procedura më të detajuara për fitimin e gradës shkencore “Doktor” përcaktohen në rregulloren e ciklit të tretë të studimeve, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë.
14. Lista e plotë e revistave shkencore, të botuara brenda vendit, botohet në muajin shkurt të çdo viti nga ministria përgjegjëse për arsimin e lartë, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI).

Neni 67

Kriteret e posaçme për hapjen e programeve të reja të ciklit të tretë të studimit, “Master Ekzekutiv”

1. Kriterete përgjithshme për hapjen e programeve të reja të ciklit të tretë të studimit, “Master Ekzekutiv” jepen si më poshtë:
 - a. Në rast hapjeje të një programi të tillë, UK-ja duhet të paraqesë dokumentacionin e përshkruar në nenin 50 dhe kriterëve të posaçme që do përshkruhen më poshtë.
 - b. Programet e studimit “Master Ekzekutiv” mund të hapen në UK në programe studimi të licensuara dhe të akredituara/riakredituara të ciklit të parë dhe të dytë në të njëjtën fushë ose fushë të përafërt me atë të programit “Master Ekzekutiv”, por që plotësojnë njëkohësisht kushtet e mëposhtme:

- c. Kanë akreditim institucional;
- d. Kanë përvojë në ofrimin e programeve të ciklit të tretë;
- e. Dëshmojnë se kanë personelin akademik për të plotësuar, menjëherë pas licensimit të programit, strukturën e departamentit që ofron programin e studimit.
- f. Programet e studimit mund të hapen dhe të zhvillohen bashkërisht me IAL të tjera mbi bazën e marrëveshjeve ndërinstucionale përkatëse. Në këtë rast institucioni përgjegjës për realizimin dhe mbarëvajtjen e tyre është IAL-ja pranë së cilës zhvillohet pjesa më e madhe e veprimtarisë dhe mbahet dokumentacioni i procesit mësimor.
- g. IAL-ja përgjegjëse për realizimin dhe mbarëvajtjen e programit të studimit duhet të disponojë burimet finaciare, infrastrukturën dhe personelin akademik të nevojshëm për realizimin e programit të studimit.
- h. Për realizimin e programeve të përbashkëta të studimit me institucione të huaja të arsimit të lartë, mund të zbatohen standarde të ndryshme nga ato shtetërore, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.

Neni 68

Personeli akademik i programit të studimit të ciklit të tretë “Master Ekzekutiv”

1. Personeli akademik i programit të studimit përbëhet nga personel akademik i kategorisë “Profesor” i punësuar me kohë të plotë ose të pjesshme në UKNë personelin akademik të programit të studimit mund të përfshihet edhe personeli akademik i IAL-ve partnere në hapjen e programeve të studimit mbi bazën e marrëveshjeve ndërinstucionale.
2. Në varësi të shkallës së specializimit të programit të studimit, mund të jenë pjesë e personelit të programit edhe specialistë të fushës me përvojë profesionale në fushën e programit, numri i të cilëve nuk mund të jetë më i lartë se 30% e numrit të personelit akademik.

Neni 69

Organizimi i programit të studimit të ciklit të tretë “Master Ekzekutiv”

1. Programet e studimit hapen në përputhje me Standardet Shtetërore të Cilësisë për programet e studimit të ciklit të tretë, me kohëzgjatje 1 ose 2 vite akademike (respektivisht me 60 ose 120 kredite).
2. Struktura e programit të studimit pasqyrohet e plotë në planin mësimor ndërsa modalitetet e realizimit të programit të studimit dhe të veprimtarive të tij pasqyrohen në rregulloren e programit të studimit.
3. Veprimtaritë mësimore mund të zhvillohen në formën e leksioneve, seminareve, laboratorëve, praktikave mësimore, vizitave mësimore, konferencave, mësimi ndërveprues, stazheve.
4. Praktikant mësimore dhe stazhet mund të zhvillohen pranë institucionit të arsimit të lartë ose pranë institucioneve të tjera bashkëpunuese, në varësi të objektivave formuese dhe të strukturave që disponon vetë UK-ja.
5. Veprimtaritë mësimore, për programet e studimit me kohëzgjatje 1 vit akademik, nuk duhet të përmbajnë më pak se 360 orë në auditor.
6. Veprimtaritë mësimore, për programet e studimit me kohëzgjatje 2 vite akademike, nuk duhet të përmbajnë më pak se 720 orë në auditor.

7. Programet e studimit përmbillen me tezë diplome.
8. Njërit prej anëtareve të personelit akademik të programit të studimit që mban të paktën titullin “Profesor i Asociuar” i ngarkohet në cilësinë e përgjegjës, drejtimi i programit të studimit. Përgjegjësi i një programi studimi në UK nuk mund të ngarkohet me përgjegjësinë e drejtimit të një programi tjetër studimi që realizohet nga UK-ja. Për planifikimin dhe zbatimin e planit të studimit, përgjegjësi i programit të studimit bashkëpunon me personelin akademik të këtij programi.
9. Kriteret, kuotat, tarifat dhe modalitetet e pranimit në këto programe studimi propozohen nga njësia/njësitë bazë propozuese e/të programit të studimit, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë dhe miratohen nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit.
10. Gjatë periudhës së studimeve në një program studimi, studenti nuk mund të ndjekë njëkohësisht programe të tjera studimi, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer.

Neni 70

Pranimi në programet e ciklit të tretë të studimeve

1. Pranimi në programet e ciklit të tretë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë fituar diplomën “Master i shkencave” dhe plotësojnë kriteret e pranimit.
2. Kriteret e pranimit në programet e ciklit të tretë përcaktohen nga njësitë bazë, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë dhe pasqyrohen në Rregulloren e tyre të studimeve. Këto kriterë bëhen publike nga institucioni dhe i përcillen QSHA-së, si dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin.
3. Kriter pranimi në një program studimi të ciklit të tretë është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: *anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht*, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin. Nëse individ i ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
4. Lista e studentëve fitues dërgohet në QSHA, në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.
5. Lista e të diplomuarve në programet e ciklit të tretë përcillet nga UK-ja në ministrinë përgjegjëse për t’u pasqyruar në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë.

Neni 71

Programet e përbashkëta të studimit

1. Programet e përbashkëta të studimit realizohen në UK, në bashkëpunim me një ose disa institucione të tjera të arsimit të lartë, publik ose jopublik, brenda ose jashtë vendit.
2. Procesi i realizimit të programeve të përbashkëta mund të kryhet në një nga/ose në institucionet pjesëmarrëse, në përputhje me marrëveshjen e bashkëpunimit.
3. Në përfundim të studimeve lëshohet diplomë e dyfishtë ose e shumëfishtë nga institucionet pjesëmarrëse.
4. Në kushtet e realizimit të programeve të përbashkëta të studimit me institucione të huaja të arsimit të lartë, mund të zbatohen standarde të ndryshme nga ato shtetërore.

5. Hapja e programeve të përbashkëta të studimit bëhet me miratimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Neni 72

Programet e studimeve të formimit të vazhduar

1. UK-ja mund të ofrojë programe të studimeve të formimit të vazhduar, si formë e të mësuarit gjatë gjithë jetës. Këto programe shërbejnë për plotësim, thellim e konsolidim të njohurive dhe mund të ofrohen si kurse kualifikimi, shkolla verore dhe veprimtari të ngjashme. Programet e studimeve të formimit të vazhduar ndihmojnë individët në rritjen e kualifikimit dhe të aftësive profesionale.
2. Struktura e këtyre programeve, kohëzgjatja dhe kreditet e tyre përcaktohen në mënyrë të pavarur nga secila njësi baze përgjegjëse, në bashkëpunim me ministrinë e linjës, nëse kanë kompetencë, sipas kuadrit ligjor për profesionet e rregulluara, dhe bëhen publike nga njësia kryesore.
3. Në përfundim të programeve të studimeve të formimit të vazhduar, UK-ja lëshon certifikatat përkatëse, të cilat regjistrohen në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.
4. UK-ja mund të ofrojë edhe kurse përgatitore për programet e studimeve që ofron.

Neni 73

Programet e studimit në fushën e mësuesisë

1. Programet e studimit në fushën e mësuesisë për arsim parashkollor dhe arsim fillor, organizohen në dy cikle:
 - a. program i ciklit të parë, “Bachelor”, që formon mësues të arsimit parashkollor;
 - b. program i ciklit të dytë ”Master profesional”, që formon mësues të arsimit fillor.
2. Programet e studimit për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve ”Master”, me 120 kredite, sipas fushave përkatëse të formimit.
3. Programet e ciklit të dytë të studimit në fushën e mësuesisë duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik.
4. Programet e ciklit të dytë të studimit, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.

Neni 74

Ndjekja e një programi të dytë studimi

1. Individët që kanë përfunduar një program studimi, kanë të drejtë të ndjekin një program të dytë studimi të të njëjtit cikël. Në këtë rast, kandidatët përballojnë koston e plotë të studimeve. Përfshihen nga ky rregull studentët e shkëlqyer, me notë maksimale në hyrje.
2. Për ndjekjen e një programi të dytë studimi, si rregull, parapëlqehen për aplikim kandidatët me diplomë të përafërt me programin e dytë në të cilin kërkojnë të studiojnë. Nga numri i aplikantëve përzgjidhen ata me mesatare më të lartë, brenda

- numrit të përcaktuar të kuotave të pranimit.
3. Kriteria specifike për t'u pranuar në një program të dytë studimi përcaktohen në rregulloret e njësive bazë.
 4. Procedura që ndiqet në këtë rast është si më poshtë:
 - a. Kandidatët që kërkojnë të ndjekin një program të dytë studimesh në programet e ciklit të parë apo të dytë aplikojnë pranë UK-së. Numri i programeve që mund të aplikojnë dhe afatet përcaktohen në udhëzimet që nxjerr MASR-ja para fillimit të çdo viti akademik.
 - b. Këta kandidatë duhet të plotësojnë kriterin e notës mesatare të parashikuar në VKM, si dhe kriteret e përcaktuara nga njësiti bazë që ofrojnë këto programe studimi.
 - c. Kandidati nuk duhet të ndjekë njëkohësisht dy programe studimi, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer, me notë maksimale në hyrje.
 - d. Të gjithë kandidatët që dëshirojnë të aplikojnë për program të dytë studimi paraqesin pranë sekretarive mësimore dokumentet që parashikon Udhëzimi i MASR-së për këtë qëllim.
 - e. Komisioni i ekuivalentimit të moduleve dhe programeve i ngritur pranë çdo njësie bazë bën vlerësimin e dosjeve të kandidatëve në zbatim të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi si dhe kriterëve të tjera të vendosura nga njësia bazë dhe të shpallura nga dekani përkatës në mjediset e fakulteteve, bazuar në pikëzimin për çdo kriter vlerësimi.
 - f. Këto komisione kryejnë renditjen e kandidatëve dhe vlerësojnë kandidatin me statusin fitues/jo fitues.
 - g. Listat me renditjen e kandidatëve sipas pikëve të marra, publikohen në mjediset e çdo fakulteti. Fituesi i fundit përcaktohet me vijë të kuqe në varësi të kuotave të ofruara për çdo program studimi.
 - h. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit në komisionin që ka bërë vlerësimin e dosjeve të tyre, brenda tri ditëve kalendrike nga dita e shpalljes së rezultateve. Këto komisione duhet të shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave.
 - i. Pas shpalljes së listave përfundimtare me renditjen e kandidatëve edhe në faqen elektronike të UK-së, fillon procesi i regjistrimit të tyre.

Neni 75 **Profili i programit**

1. Programi i studimit mund të organizohet në profile, të cilat ofrojnë specializime në drejtime të ngushta të fushës së programit të studimit, në fusha integruese ose ndërdisiplinore të përafërta.
2. Emërtimi i profilit të programit të studimit shënohet në diplomën, që lëshohet në përfundim të tij.

Neni 76 **Ndryshimi i programeve të studimit**

1. Programet e studimit të akredituara mund të riorganizohen deri në masën 20 përqind të programit.
2. Njësia bazë i propozon ndryshimet deri në masën 20% drejtuesit të njësisë kryesore, i cili i përcjell ato në Senatin Akademik.

3. Senati Akademik, pas miratimit të ndryshimeve të propozuara, njofton Ministrinë përgjegjëse për Arsimin e Lartë jo më vonë se gjashtë muaj para fillimit të vitit akademik.

Neni 77 **Gjuha e studimeve**

1. Programet e studimit në UK ofrohen në gjuhën shqipe. Këto programe mund të ofrohen dhe në një nga gjuhët zyrtare të Bashkimit Europian, të miratuar në aktin përkatës të hapjes së programit të studimit. Përjashtohen nga ky rregull :
 - a. programet e përbashkëta të studimit të ofruara nga UK-ja me institucione të huaja të arsimit të lartë ;
 - b. programet e studimit që kanë për objekt mësimin e gjuhëve të huaja.
2. Në rastin e programeve të studimit që ofrohen nga UK-ja në gjuhë të huaj, studentët duhet të dëshmojnë njohjen e gjuhës së huaj përkatëse në nivelin B1-C1.

Neni 78 **Kohëzgjatja e studimeve**

1. Kohëzgjatja maksimale e studimeve në një program studimi nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve që parashikon programi, pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studenti i ka pezulluar studimet.
2. Studenti, që nuk arrin të përfundojë studimet brenda kohëzgjatjes maksimale të programit, ka të drejtë të aplikojë për të rifilluar studimet, në të njëjtin program studimi ose në një program tjetër.
3. Ai u nënshtrohet kritereve dhe procedurave të shpallura për regjistrimin në programin e studimit të ofruar nga UK-ja.
4. Kreditet e grumbulluara nga studenti gjatë periudhës së mëparshme të studimeve mund të transferohen, me vendim të njësisë bazë që pranon studentin, sipas kritereve të përcaktuara në rregulloren e saj.

Neni 79 **Transferimi i studimeve**

1. UK-ja ofron mundësinë për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda vetë universitetit apo universiteteve të tjera.
2. Kuotat në dispozicion për transferimin e studentëve nga IAL-të e tjera ose brenda UK-së përbëhen nga kuotat e paplotësuara nga regjistrimet e vitit të mëparshëm dhe kapacitetet që mund të krijohen, si rezultat i çregjistrimit të studentëve gjatë vitit akademik. Transferimet pranohen në fillim të çdo viti akademik, jo më vonë se fundi i javës së pestë të semestrit të parë.
3. Kuotat në dispozicion të transferimeve mund të shfrytëzohen edhe nga studentë, të cilët ndërpresin studimet në një program për t'u regjistruar në një program të të njëjtit cikël studimi, që i përket një fushe të ndryshme studimesh nga ajo e mëparshme, nëse numri i krediteve, që njihen është i mjaftueshëm për t'u regjistruar në vitin e dytë të studimeve.

4. Transferimet lejohen nga një program studimi i njëjtë ose i ngjashëm i të njëjtit cikël dhe lloj, të ndjekur nga kandidati në IAL-të publike ose jopublike të licensuara dhe të akredituara për programin përkatës të studimit, vendase apo të huaja, në fusha studimi të njëjta ose të përafërta.
5. Periudhat e studimit dhe detyrimet e programeve të studimit, të shlyera në institucione të tjera të vendit ose të huaja, njihen dhe njësohen, nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin, në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm.
6. Njohja kryhet nga universiteti pranë të cilit është paraqitur kërkesa për vazhdimin e studimeve, konform akteve nënligjore në fuqi.
7. Kriteret e procedurat e njohjes së krediteve dhe transferimi i studimeve përcaktohen në rregulloren e njësisë bazë, në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akte të tjera nënligjore.
8. Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve, me qëllim vazhdimin e studimeve, merret nga Komisioni i Ekuivalentimit të Njësisë Bazë që pranon studentin sipas kësaj procedure:
 - a. Kandidatët që kërkojnë transferim studimesh në programet e ciklit të parë apo të dytë aplikojnë pranë UK-së. Numri i programeve që mund të aplikojnë dhe afatet përcaktohen në udhëzimet që nxjerr MASR-ja para fillimit të çdo viti akademik.
 - b. Kandidatët që aplikojnë për transferim studimesh në programet e studimeve 2-vjeçare me karakter profesional, nuk kanë detyrimin të plotësojnë kriterin e notës mesatare të parashikuar në VKM.
 - c. Kandidati nuk duhet të ndjekë njëkohësisht dy programe studimi, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer, me notë maksimale në hyrje.
 - d. Të gjithë kandidatët që dëshirojnë të aplikojnë për transferim të studimeve paraqesin pranë sekretarive mësimore dokumentet që parashikon udhëzimi i MASR-së për këtë qëllim.
 - e. Komisioni i ekuivalentimit të moduleve dhe programeve, i ngritur pranë çdo njësie bazë, bën vlerësimin e dosjeve të kandidatëve dhe përzgjedhjen e tyre në bazë të meritës, për ata kandidatë që plotësojnë kriteret e parashikuara në aktet ligjore e nën- ligjore në fuqi, si dhe kriteret specifike për çdo program studimi sipas kuotave përkatëse të shpallura paraprakisht nga njësia bazë.
 - f. Këto komisione kryejnë renditjen e kandidatëve bazuar në pikëzimin për çdo kriter vlerësimi të vendosur paraprakisht nga njësia bazë dhe të shpallura nga dekani përkatës në mjediset e çdo fakulteti, dhe vlerëson kandidatin me statusin fitues/jo fitues.
 - g. Listat me renditjen e kandidatëve sipas pikëve të marra, publikohen në mjediset e çdo fakulteti. Fituesi i fundit përcaktohet me vijë të kuqe në varësi të kuotave të ofruara për çdo program studimi.
 - h. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit në komisionin e ekuivalentimit në njësinë bazë që ka bërë vlerësimin e dosjeve të tyre, brenda tri ditëve kalendarike nga dita e shpalljes së rezultateve. Këto komisione duhet të shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave.
 - i. Pas shpalljes së listave përfundimtare me renditjen e kandidatëve edhe në faqen elektronike të UK-së, fillon procesi i regjistrimit të tyre.

Neni 80

Elementët e programeve të studimit të ofruara nga UK-ja

Elementët që përbëjnë strukturën e programeve të studimit në UK, janë përcaktuar në aktet nënligjore (VKM Nr.41, datë 24.1.2018) dhe konstistojnë në:

- a.** Kreditet sipas ECTS;
- b.** Kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit;
- c.** Objektivat formuese dhe kompetencat profesionale;
- d.** Veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit;
- e.** Kategoritë e veprimtarive formuese që karakterizojnë një program studimi;
- f.** Planin mësimor;
- g.** Kuotat e pranimit dhe grupet mësimore;
- h.** Programin lëndor (syllabuset);
- i.** Profilin e programit;
- j.** Diplomën dhe suplementin.

Neni 81

Kreditet sipas ETSC-së

Kreditin e formimit të arsimit të lartë i referohet ETSC-së dhe shpreh volumin e punës mësimore për arritjen e rezultateve të pritshme mësimore.

- a.** Një krediti i korrespondojnë 25 (njëzet e pesë) orë mësimore pune të studentit.
- b.** Sasia mesatare e punës së kryer gjatë një viti studimesh në arsimin e lartë, nga një student me kohë të plotë, është 60 (gjashtëdhjetë) kredite ose 1500 (një mijë e pesëqind) orë mësimore pune të studentit, të cilat përfshijnë orë në auditor dhe orë pune të pavarur të tij.
- c.** Orët për punë të pavarur të studentit zenë jo më pak se gjysmën e fondit të përgjithshëm të 1500 orëve mësimore vjetore.
- d.** Ngarkesa mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime e laboratore, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave të zhvilluara në auditor, është deri në 25 orë mësimore 50-minutëshe.
- e.** Kreditet korresponduese për çdo veprimtari formuese fitohen nga studentët vetëm për vlerësim pozitiv, në verifikimin përfundimtar të dijeve të fituara prej tyre. Për vlerësimin e dijeve të përfutuara përdoren forma të ndryshme kontrolli, që kombinojnë vlerësimin e vazhdueshëm me atë përfundimtar (i cili mund të jetë provim, por jo vetëm).
- f.** Vlerësimi i vazhdueshëm përfaqëson 30% të vlerësimit total. Përbërësit e vlerësimit të vazhdueshëm përcaktohen nga çdo pedagog në programin lëndor (syllabus) dhe pasqyrohen në Rregulloren e programit të studimit.

Neni 82

Kontrolli i dijeve dhe instrumentet e vlerësimit

- 1.** Kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet testimeve me shkrim e me gojë, eseve, detyrave të kursit, punëve në grup, projekteve, prezantimeve, praktikave dhe tezave të diplomës.
- 2.** Kontrolli i dijeve shërben për vlerësimin e progresit të studentit dhe mat përvetësimin e objektivave formuese e të kompetencave profesionale të programit nga studenti.

3. Kriteri i vlerësimit përshkruan atë çfarë pritet të bëhet nga studenti dhe në çfarë niveli, me qëllim demonstrimin e arritjeve të objektivave formuese dhe të kompetencave profesionale.
4. Metodatat e vlerësimit janë strategjitë, teknikat, mjetet dhe instrumentet për grumbullimin e informacionit për të përcaktuar masën, në të cilën studenti demonstroi përvetësimin e objektivave formues e të kompetencave profesionale të programit.

Neni 83

Kontrolli përfundimtar i dijeve me provim

1. Kontrolli përfundimtar i dijeve mund të bëhet me provim i cili mund të jetë me shkrim; me gojë ose i kombinuar (me shkrim e gojë). Zgjedhja e formës së provimit bëhet nga pedagogu/ët i lëndës, pasqyrohet në programin lëndor (syllabus) dhe në rregulloren e programit të studimit si dhe ju bëhet e ditur studentëve që në fillim të semestrit.
2. Provimet me shkrim zhvillohen për ato lëndë (module) që kanë karakter teorik dhe praktik. Tezat e provimit me shkrim duhet të përmbajnë pyetje dhe ushtrime që kërkojnë mendimin logjik të studentit, duke shmangur ato pyetje që kërkojnë thjesht riprodhimin mekanik të njohurive. Nëpërmjet ushtrimeve duhet të kontrollohet edhe përvetësimi i njohurive teorike nga studentët.
3. Provimet me gojë duhet të zhvillohen në përputhje me veçoritë e lëndës (modulit), sidomos për lëndë (module) që kërkojnë shprehje me gojë të studentëve apo që janë thjesht teorike. Tezat e provimit me gojë duhet të përmbajnë pyetje që kërkojnë mendimin logjik të studentit, duke shmangur ato pyetje që kërkojnë thjesht riprodhimin mekanik të njohurive, duhet të jenë pyetje sintezë që përfshijnë njohuritë dhe kompetencat kryesore që duhet të zotërojnë studentët në atë lëndë (modul).

Neni 84

Objektivat formuese dhe kompetencat profesionale

1. Objektivat formuese dhe kompetencat profesionale në një program studimi përcaktojnë formimin, njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që përfiton studenti deri në përfundim të programit të studimit.
2. Objektivat formuese dhe kompetencat profesionale:
 - a. i atribuohen përbërësve të veçantë mësuesorë, si dhe programit të studimit në tërësi;
 - b. përcaktohen në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve gjatë përshkrimit të kualifikimeve individuale, për sa u përket njohurive, aftësive dhe kompetencave të fituara me përfundimin e studimeve.
 - c. vlerësohen nëpërmjet procedurave të bazuara në kritere të qarta e transparente.
3. Objektivat formuese dhe kompetencat profesionale ndahen në:
 - a. përcaktues/e, të cilët/cilat janë të njëjtë/a për programet e studimit me të njëjtin emërtim, të ofruar nga institucione të ndryshme të arsimit të lartë.
 - b. specifike/e, të cilët/të cilat diferencojnë programet e studimit me të njëjtin emërtim, të ofruara nga IAL të ndryshme. Këto objektiva e kompetenca përcaktohen veçmas nga secili institucion ofrues i programit të studimit.

Neni 85

Veprimtaritë formuese dhe përbërësit mësimore të programit të studimit

1. Veprimtaritë formuese, që karakterizojnë një program studimi, përbëhen nga përbërësit mësimore të cilët ndahen në:
 - a. Mësim në auditor, si leksione, seminare, ushtrime, laboratore, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor;
 - b. Studim individual, si studim e punim relacionesh, detyrash apo projektesh;
 - c. Përgatitje për provime;
 - d. Përgatitje e tezës së diplomës;
 - e. Veprimtari të tjera, si praktika profesionale, praktika në terren apo stazh pranë subjekteve publike ose private.
2. Ndarja e orëve mësimore në auditor në orë për leksione, seminare, ushtrime e laboratore për çdo disiplinë, përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit, në bazë të krediteve që ka secila disiplinë.
3. Studentëve, në përfundim të programit të studimit u përlllogaritet nota mesatare e ponderuar, që merr në konsideratë edhe kreditet respektive për çdo disiplinë apo veprimtari tjetër formuese.

Neni 86

Kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi

1. Programi i studimit përbëhet nga veprimtari formuese të cilat realizohen me kredite ECTS.
2. Veprimtaritë formuese grupohen në kategoritë e mëposhtme:
 - a. **Lëndë bazë** të programit të studimit, që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme;
 - b. **Lëndë karakterizuese**, që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik, sipas karakteristikave të tij;
 - c. **Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese** në një ose më shumë grupe disiplinash të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe gruplëndë me zgjedhje;
 - d. **Lëndë plotësuese**, të fokusuara në përfitimin e aftësive në gjuhë të huaj, aftësive informatike dhe telematike, aftësive komunikuese e prezantuese, aftësive që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës dhe në praktikat profesionale të zhvilluara pranë subjekteve publike e private, sipas marrëveshjeve të përbashkëta të nënshkruara për këtë qëllim;
 - e. **Detyrime përmbyllëse**, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës ose me provimin përfundimtar.
3. Pesha që zë secila kategori e veprimtarive formuese brenda programit të studimit, sipas llojit të programit përcaktohet si më poshtë vijon :

Kategoria	Tipi i komponentit mësimor	Cikli i parë	Cikli i dytë		
		Bachelor	Master profesional	Master i shkencave/ Master i arteve	Master i shkencave (i integruar)
A	LËNDË BAZË – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme	15% - 20% (kredite)	5%-10% (kredite)	5%-10% (kredite)	15% - 20% (kredite)
B	LËNDË KARAKTERIZUESE – përgatitje për disiplinën shkencore	50% - 55% (kredite)	30% - 40% (kredite)	50% - 60% (kredite)	45% - 55% (kredite)
C	LËNDË NËNDISIPLINORE/INTEGRUESE – nëndisiplina, profile dhe gruplëndë me zgjedhje	12% -15% (kredite)	20%-30% (kredite)	12% -20% (kredite)	12% -15% (kredite)
D	LËNDË PLOTËSUESE – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale	10-15% (kredite)	10% (kredite)	10% (kredite)	6 – 8 % (kredite)
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	3%-5% (kredite)	10% - 20% (kredite)	10-15% (kredite)	3%-5% (kredite)

4. Përqindja totale e lëndëve të kategorive A dhe B nuk duhet të jetë më pak se 70% në rastin e programeve “Bachelor” dhe “Master i shkencave i integruar”, dhe jo më pak se 60% në rastin e programeve “Master i shkencave”. Në rastin e “Master i arteve” ky raport vendoset sipas specifikave të vetë programit të studimit.
5. Veprimtaritë formuese mund të jenë:
- a. të detyrueshme
 - b. të zgjedhura nga vetë studentët, ndërmjet atyre të ofruara nga institucioni, dhe koherente me programin e studimit, të realizuara këto gjatë viteve akademike të programit të studimit.

Neni 87 Plani mësimor

Në planin mësimor të çdo programi studimi përcaktohen:

- i. lëndët e programit të studimit të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese, si dhe në vite e semestra;
- ii. kreditet përkatëse
- iii. pedagogët përgjegjës

Neni 88
Kuotat e pranimit

1. Pas propozimeve nga njësitë bazë, Senati Akademik i UK-së miraton kuotat e lira për regjistrimet e reja të studentëve për çdo program studimi. Këto kuota duhet të jenë në përputhje me standardet e përcaktuara për raportin personel akademik me kohë të plotë për student dhe normativën e përcaktuar për sipërfaqen e shfrytëzueshme për student:
- a. Standardi i raportit personel akademik me kohë të plotë/student, sipas fushave kryesore të studimit, është si më poshtë:

Fusha	Personeli akademik	Studentë
Shkencat natyrore	1	45
Inxhinieri dhe teknologji	1	35
Shkenca mjekësore dhe të shëndetit	1	35
Shkenca bujqësore dhe të veterinarisë	1	45
Shkenca sociale	1	45
Shkenca humane dhe arte	1	45

- b. Normativa e sipërfaqes së shfrytëzueshme sipas fushave të studimit është si më poshtë:

Fusha	Sipërfaqja në m ² për studentë
Shkencat natyrore	2.5 m ²
Inxhinieri dhe teknologji	5 m ²
Shkenca mjekësore dhe të shëndetit	5 m ²
Shkenca bujqësore dhe të veterinarisë	2.5 m ²
Shkenca sociale	2.5 m ²
Shkenca humane dhe arte	2.5 m ²

- c. Kuotat e pranimit llogariten mbi bazën e studentëve aktivë që ndjekin programet e studimit. Ato bëhen publike nga UK-ja dhe i përcillen QSHA- së dhe MASR-së.
- d. Në varësi të ecurisë së regjistrimeve, kapaciteti i kuotave të programeve mund të përshtatet në përputhje me interesin e studentëve, për programet e të njëjtit cikël studimi, që ofrohen nga njësitë bazë të së njëjtës njësi kryesore, duke mos tejkaluar, në asnjë rast totalin e kapacitetit të deklaruar të kuotave, të përcaktuar në nivel njësie kryesore.

Neni 89
Grupet mësimoretë studentëve

Grupet mësimore në programet e studimit të ciklit të parë, të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimit të ciklit të dytë organizohen me numër studentësh. Numri i studentëve që përmban grupi mësimor sipas fushës së programit të studimit duhet të jetë si më poshtë:

Fusha studimit	Nr. stud/ sem.	Nr. stud./ lab	Nr. stud./prakt	Nr.stud./leksion
<i>Shkenca natyrore</i>	35	25	25	6 grupe sem.
<i>Inxhinieri dhe teknologji</i>	25	20	20	6 grupe sem.
<i>Shkenca mjekësore dhe të shëndetit</i>	25	20	20	6 grupe sem.
<i>Shkenca bujqësore dhe të veterinarisë</i>	35	25	25	6 grupe sem.
<i>Shkenca sociale</i>	35	25	25	6 grupe sem.
<i>Shkenca humane dhe arte</i>	35	25	25	6 grupe sem.

Neni 90
Programi lëndor (syllabuset)

Programi i lëndës që do të përdoret për hartimin e syllabuseve duhet të përmbajë:

- Titullari /pedagogu i lëndës
- Ngarkesa
- Tipologjia e lëndës
- Viti akademik/semestri kur zhvillohet
- Lloji i lëndës
- Programi i studimit
- Kodi i lëndës
- Adresa elektronike e titullarit/pedagogut të lëndës
- Përmbledhje dhe rezultatet e të nxënit
- Konceptet themelore
- Temat e lëndës
- Forma e kontrollit të dijeve
- Frekuentimi
- Kontrolli i vazhdueshëm
- Literatura
 - a. Literatura bazë e detyrueshme
 - b. Literatura e rekomanduar
- Vërejtje përfundimtare nga pedagogu i lëndës

Neni 91
Diploma dhe suplementi

1. Diplomat që lëshohen në përfundim të programeve të studimit të ciklit të parë, të dytë si dhe ato të ciklit të tretë “Master Ekzekutiv”, shoqërohen me suplementin e diplomës.

2. Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë dhe përshkruan natyrën, nivelin, përmbajtjen dhe rezultatet e studimeve që janë kryer nga mbajtësi i diplomës, si dhe fushën e punësimit.

Neni 92

Viti akademik dhe organizimi i mësimdhënies

1. Studimet në UK zhvillohen në vite akademike. Data zyrtare e fillimit të vitit akademik shpallet nga ministri përgjegjës për arsimin.
2. Viti akademik organizohet në dy semestra, që realizojnë 20 deri në 25 orë mësimore 50- minutëshe leksione, seminare, praktika, laboratorë në një javë.

Neni 93

Frekuentimi

1. **Frekuentimi i leksioneve:** Në përputhje me veçoritë e lëndës, çdo pedagog, me miratim të Përgjegjësit të departamentit, mund të parashikojë në syllabusin përkatës peshën specifike të frekuentimit të leksioneve në vlerësimin përfundimtar me notë të studentit.
2. **Frekuentimi i seminareve:** Si rregull është i detyrueshëm deri në masën 75%. Në përputhje me veçoritë e lëndës, çdo pedagog, me miratim të Përgjegjësit të departamentit, duhet të parashikojë në syllabusin përkatës peshën specifike të frekuentimit të seminareve në vlerësimin përfundimtar me notë të studentit.
3. **Frekuentimi i punëve laboratorike dhe mësimi praktik:** Është i detyrueshëm në masën 100%, në të kundërt studentit nuk hyn në provimin e lëndës.
4. **Projektet e kursit:** Janë të detyrueshme të shlyhen në masën 100%, në të kundërt studentit nuk hyn në provimin e lëndës.

Neni 94

Orari i mësimi

1. Koha dhe auditori i zhvillimit të mësimi pasqyrohet në orarin e shpallur nga sekretaria mësimore.
2. Orari është i detyrueshëm për studentët dhe pedagogët.

Neni 95

Regjistri i pedagogut

1. Regjistri mësimor është dokumenti zyrtar që evidenton dhe vërteton zhvillimin e orës së mësimi nga pedagogët dhe pjesëmarrjen e studentëve në procesin mësimor.
2. Regjistri i pedagogut plotësohet për çdo orë mësimi. Ai firmoset nga vetë pedagogu i lëndës dhe përgjegjësi i departamentit që mbulon disiplinën.
3. Regjistri i pedagogut është objekt kontrolli periodik. Me anën e tij verifikohet realizimi i programit dhe ngarkesa mësimore vjetore. Ai duhet të përdoret dhe të ruhet të paktën për një periudhë 1-vjeçare.
4. Çdo korrigjim në këtë regjister duhet të siglohet.

5. Mospjesëmarrja e studentëve në elementët e mësimit me frekuentim të detyrueshëm vlerësohet me mungesë në regjistrin e pedagogut. Çdo pedagog është i detyruar të shënojë në regjister emërtimin e lëndës, programin e studimit, grupin, kursin përkatës, vitin akademik, elementët e mësimit të zhvilluar, si dhe të pasqyrojë saktë mungesat dhe elementë të vlerësimit në proces.
6. Regjistri plotësohet sipas përcaktimeve të bëra në udhëzimin në modelin tip të regjistrit të pedagogut.

KREU VII

PROCEDURAT E VLERËSIMIT TË STUDENTËVE

Neni 96

Organizimi i provimeve

1. Në përfundim të procesit mësimor (në orët e fundit të mësimit), çdo pedagog që është përgjegjës lënde duhet t'u komunikojë studentëve në auditor:
 - fitimin ose jo të së drejtës për t'u futur në provimin e lëndës (modulit) përkatëse;
 - rezultatin e vlerësimit të vazhdueshëm në seminare, laboratore, tema e detyra kursi apo në forma të tjera të kontrollit të ushtruar gjatë semestrit, të specifikuar në syllabusin e hartuar nga pedagogu.
- Dyditë para provimit vendos online këto rezultate dhe printon listën emërore të studentëve të regjistruar. Rezultati i vlerësimit të vazhdueshëm merret parasysh në të gjitha sezonet e provimeve.
2. Studentët nuk lejohen të futen në provime gjatë sezonit të rregullt të verës, nëqoftëse nuk kanë shlyer detyrimet në bibliotekën universitare.
 3. Tezat e provimit hartohen nga titullari i lëndës (modulit) dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit ku pedagogu titullar bën pjesë.
 4. Gjatë zhvillimit të provimit me shkrim nuk lejohet ndërrimi i tezës.
 5. Studentit i lejohet ndërrimi i tezës në provimin me gojë, por ndëshkohet me një zbritje prej dy notash në shkallën prej 10 notash të vlerësimit.

Neni 97

Provimet me gojë

1. Problemet kryesore që përmbajnë tezat e provimit me gojë për lëndën (modulin) përkatëse duhet t'u jepen studentëve qysh më parë nga pedagogu, në formën e fondit të pyetjeve. Këto probleme duhet të jenë në formën e standardeve që kërkohen për përvetësimin e lëndës nga studentët.
2. Pedagogu ose pedagogët në provimin me gojë duhet të argumentojnë notën që i vihet studentit, duke patur parasysh përmbushjen nga ana e tij të detyrimeve në leksione dhe seminare, realizimin cilësor të detyrave të kursit, të kolokuiumeve etj., që janë pasqyruar në rezultatin e vlerësimit të vazhduar.
3. Numri i tezave për provimin me gojë varet nga vëllimi i lëndës (modulit), nga sasia e leksioneve dhe e seminareve etj. Një kopje e tezave të provimit me gojë dorëzohet në departament një javë para zhvillimit të provimit, për t'u shqyrtuar dhe për t'u firmosur nga përgjegjësi i departamentit.

4. Studentët, në provimin me gojë, i shkruajnë përgjigjet e tyre sipas pyetjeve të tezës dhe pasi përgjigjen, ia dorëzojnë atë komisionit, duke shkruar emrin dhe mbiemrin përkatës.
5. Pedagogu i lëndës i mban këto fletore në departament deri në ditën e dorëzimit të pasqyrës së rezultateve në sekretarinë mësimore të njësisë kryesore.

Neni 98 **Provimet me shkrim**

1. Numri i ushtrimeve që përmban një tezë e provimit me shkrim varet nga vëllimi i lëndës (i modulit), numri i leksioneve dhe i seminareve etj. Një tezë e provimit me shkrim përmban pyetje teorike dhe/ose ushtrime që vlerësohen në total me 70 pikë. Për çdo ushtrim vihen pikët përkatëse, në varësi të karakterit të ushtrimit.
2. Ushtrimet ose pyetjet që zgjidhen për tezën e provimit me shkrim duhet të përfshijnë në mënyrë tërësore lëndën a modulën përkatëse, të jenë të formuluar qartë, të mos lënë shteg për përgjigje dykuptimëshe, në mënyrë që vetë studenti të jetë të gjendje të bëjë vlerësimin për përgjigjet që ka shkruar.
3. Në qoftë se numri i studentëve dhe madhësia e auditorit nuk lejon që të përdoret vetëm një tezë me shkrim, pedagogu mund të hartojë edhe një tezë tjetër (B), e cila duhet të plotësojë po ato kërkesa, sikurse teza A.
4. Pedagogu i lëndës/modulit bën gjenerimin e procesverbalit në sistemin digjital, sipas afateve të përcaktuara në Rregulloren e Programit të Digjitalizimit të Sistemit Universitar ESSE3.
5. Tezat e zgjidhura të provimit me shkrim dhe fletoret e provimeve të studentëve ruhen nga pedagogu deri në përfundim të afatit të ankimimit për provimin, të parashikuar në nenin 101, pika 1.

Neni 99 **Dokumentacioni i provimit**

1. Një kopje e tezave të provimit me gojë dhe me shkrim për çdo lëndë (modul) ruhen në departament. Ato rinovohen herë pas herë, në varësi të ndryshimit të programit të lëndës (modulit). Pasqyra e rezultateve e provimit me gojë dorëzohet në sekretari brenda 2 ditëve nga data e zhvillimit të provimit.
2. Rezultati paraprak i provimit me shkrim publikohet online deri 6 ditë nga data e zhvillimit të provimit. Deri 8 ditë nga data e zhvillimit të provimit pedagogu gjeneron, publikon online dhe dorëzon në sekretarinë mësimore pasqyrën e rezultateve të provimit.

Neni 100 **Organizimi i provimit**

1. Provimet dhe riprovimet në të gjitha ciklet e studimeve zhvillohen sipas afateve të caktuara në strukturën e vitit akademik. Provimet dhe riprovimet zhvillohen në 5 sezona: sezoni i dimrit (shkurt, mars); sezoni i verës (qershor, korrik); sezoni i vjeshtës (shtator), sezoni plotësues dhe sezoni para provimit të diplomës me tre provime.
2. Në sezonin e vjeshtës dhe atë plotësues për çdo lëndë apo modul do të ketë vetëm një datë provimi. Ato miratohen dhe shpallen nga dekani jo më vonë se dy javë para

fillimit të sezonit. Në sezonin plotësues studenti mund të shlyejë vetëm provimet e mbartura nga vitet e mëparshme.

3. Afatet e përcaktuara për provimet dhe riprovimet janë të detyrueshme për zbatim si nga pedagogët, ashtu dhe nga studentët. Ndryshimi i datës së provimit bëhet vetëm me miratim të dekanit.
4. Studenti nuk lejohet të hyjë për të dytën herë në provimin e një lëndë (moduli), brenda të njëjtit sezon. Ai në sezonin e vjeshtës mund të shlyejë në total 14 provime, por jo më shumë se 2 (dy) provime në një ditë. Në sezonin plotësues studenti mund të shlyejë deri në 6 provime por jo më shumë se dy në ditë.
5. Studenti paraqitet në provim me një dokument identifikimi ose në mungesë të tij me një vërtetim nga sekretaria mësimore.
6. Provimi zhvillohet në orën dhe datën e caktuar. Në rast pamundësie të zhvillimit të provimit ditën e caktuar, për arsye madhore, dekani, me urdhër me shkrim, njofton moszhvillimin e provimit dhe cakton një datë të mëvonshme, e cila u bëhet e njohur studentëve menjëherë.
7. Komisioni i provimit të një lëndë (moduli) përbëhet nga jo më pak se dy vetë, nga të cilët njeri duhet të jetë pedagogu i lëndës (modulit). Nëse titullari i lëndës apo anëtari tjetër, për arsye madhore, nuk mund të marrin pjesë në provim, përgjegjësi i departamentit cakton me shkrim pedagogun që do t'i zëvendësojë.
8. Detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të komisionit të provimit përcaktohen në rregulloren e fakultetit.
9. Ndalohet hyrja në provim e personave të jashtëm, qofshin dhe anëtarë të stafit akademik të universitetit, me përjashtim të drejtuesit të departamentit, të njësisë kryesore, anëtarëve të Rektoratit dhe personave të tjerë të autorizuar me shkrim nga dekani ose rektori për të kryer kontroll.

Neni 101 Kohëzgjatja e provimeve

1. Kohëzgjatja e provimit me shkrim është jo më shumë se 2 orë.
2. Pas dhënies së tezës në provimin me shkrim, nuk lejohet futja në provim e studentëve të tjerë të grupit apo kursit përkatës.
3. Anëtarët e komisionit të provimit mbikëqyrin zhvillimin korrekt të provimit gjatë gjithë kohës, nga dhënia e tezës deri në përfundimin e provimit.

Neni 102 Mbarëvajtja e provimit

1. Në raste flagrante, kur studenti kërkon t'i imponohet ose të kërcënojë me forma të ndryshme anëtarët e komisionit të provimit, këta të fundit duhet të ndërpresin provimin dhe të kërkojnë ndihmën e të gjitha instancave deri tek organet e ruajtjes së rendit publik për rivendosjen e kushteve normale të zhvillimit të provimit.
2. Kur ndaj anëtarëve të komisionit të provimit ushtrohet dhunë nga studenti (apo nga ndonjë person tjetër i porositur prej tij), ky konsiderohet një akt flagrant kriminal dhe si i tillë, përbën premisë që Dekanati përkatës t'i propozojë Rektoratit përjashtimin nga universiteti të studentit. Për autorët e akteve të tilla, pedagogët ngrenë padi për ndjekje penale.

Neni 103

Studenti mbetës dhe ankimimi për provim

1. Studenti ka të drejtë të ankohet në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat proceduriale gjatë zhvillimit të provimit ose për vlerësim të pamërituar. Ankesa bëhet me shkrim brenda ditës së marrjes së rezultatit për provimin me gojë dhe jo më vonë se 8 ditë për provimin me shkrim, nga data e dhënies së tij dhe i drejtohet dekanit të fakultetit. Ai përcakton nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës brenda dy ditëve. Ky vendim është i formës së prerë.
2. Në rast se vërtetohen praktika që bien ndesh me dispozitat e kësaj rregulloreje, atëherë, me propozimin e përgjegjësit të departamentit, dekani vendos për ndryshimin e komisionit të provimit dhe për rihënien e provimit brenda ditës ose të nesërmen, pas përfundimit të tij.
3. Studenti që për çfarëdo arsye nuk paraqitet në provimin e një disipline, humbet të drejtën e provimit dhe konsiderohet mbetës për atë lëndë (modul) në atë sezon. Gjithashtu studentit vlerësohet mbetës, kur:
 - a. nuk është i përgatitur;
 - b. tërhiqet nga provimi;
 - c. kopjon ose mashtron me mjete ndihmëse jo të lejueshme (në këtë rast ai përjashtohet nga provimi).
 - d. pengon zhvillimin e rregullt të provimit (në këtë rast ai përjashtohet nga provimi).

Neni 104

Sistemi i vlerësimit

1. Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash. Nota kaluese më e ulët është nota pesë.
2. Në format e kontrollit me shkrim dhe me gojë përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht kthehet në notë. Konvertimi i pikëve në notë bëhet sipas kësaj skeme: 1-39 pikë, nota 4; 40-50 pikë, nota 5; 51-60, nota 6; 61-70 pikë, nota 7; 71-80 pikë nota 8; 81-90 pikë, nota 9; dhe nga 91-100 pikë, nota 10.
3. Për vlerësimin përfundimtar të studentit mblidhen pikët e vlerësimit të vazhduar me vlerësimin në provim. Vlerësimi përfundimtar mund të bëhet për një lëndë të vetme apo për një lëndë që përfshin disa module. Në këtë rast studentit duhet të vlerësohet pozitivisht në të gjitha modulet që e përbëjnë atë që të quhet kalues dhe i llogaritet një notë e vetme me mesataren e ponderuar që mban parasysh edhe kreditet e secilit modul. Në rast se nota mesatare përfundimtare nuk del numër i plotë, nota vihet një më shumë se pjesa e plotë.

Neni 105

Njohja me rezultatet e provimit

1. Pedagogu u bën me dije studentëve rezultatet e provimit në përfundim të provimit me gojë dhe për provimin me shkrim, brenda 6 ditëve nga data e zhvillimit të tij.
2. Në rast se provimi zhvillohet në formën e pyetjeve me përgjigje alternative, pedagogu shpall dhe çelësin e zgjidhjes.
3. Një kopje të pasqyrës së detyrimeve dhe provimit (origjinalin) e mban sekretaria mësimore e njësisë kryesoredhe një kopje e mban sekretaria e departamentit.

4. Studentët informohen mbi rezultatet e provimit në librezën e tyre elektronike, por nëse nuk e kanë marrë këtë informacion për arsye të ndryshme, mund të informohen pranë sekretarisë së departamentit.

Neni 106

Riprovimet dhe mbartja e provimeve

1. Studenti, i vlerësuar mbetës në dy sezonet e rregullta të provimeve (të dimrit dhe të verës), ka të drejtë të përdorë të gjitha datat e shpallura nga njësia kryesore në sezonin e vjeshtës.
2. Për të kaluar në vitin e dytë (semestri i tretë), studenti duhet të ketë përfituar minimumi 20 kredite. Për të kaluar në vitin e tretë (semestri i pestë), studenti duhet të ketë përfituar minimumi 60 kredite nga viti i parë dhe i dytë i programit të studimit.
3. Ridhënia e provimeve për lëndët (modulet) e pashlyera, lejohet gjatë vitit në vazhdim në sezonet e shpallura të provimeve (tri herë në vit) ose deri në vitin e fundit të studimeve.
4. Për të kaluar në semestrin e parë të vitit të dytë, studenti që ndjek studimet në ciklin e dytë, "Master Profesional" me më shumë se 60 ECTS, duhet të ketë përfituar minimumi 30 kredite. Për të kaluar në semestrin e e parë të vitit të dytë, studenti që ndjek studimet në ciklin e dytë, "Master i Shkencave", duhet të ketë përfituar minimumi 45 kredite.
5. Studenti i vitit të fundit, i cili, në përfundim të provimeve të vitit të tretë, rezulton me detyrime mësimore, i shlyen ato në sezonin e vjeshtës dhe diplomën e mbron në këtë sezon.
6. Studentit përsëritës i njihen të gjitha detyrimet e shlyera, por duhet të shlyejë detyrimet e reja, që lindin për shkak të ndryshimeve që mund të jenë bërë në planin mësimor të programit të studimit.
7. Studenti me bursë humbet të drejtën e saj për vitin që përsërit.

Neni 107

Mobilitetet kombëtare dhe ndërkombëtare

1. Studentët që lëvizin në kuadrin e programeve ku UK-ja është palë, kanë status të veçantë dhe lirohen nga detyrimet e kësaj rregulloreje për frekuentimin.
2. Atyre u njihen provimet e dhëna jashtë shtetit për lëndët (modulet) e ngjashme, kur programet barazvlerësohen. Kur kthehen në fakultet, duhet të shlyejnë detyrimet për disiplinat e tjera, të cilat nuk duhet të kalojnë masën 50% të detyrimeve vjetore të planit ekzistues mësimor.
3. Në këto raste, shlyerja e detyrimeve mësimore bëhet me plan individual, të hartuar nga departamenti përkatës dhe të miratuar nga dekani i fakultetit, në përputhje me nenet e kësaj rregulloreje

Neni 108

Diplomimi

1. Në përfundim të kursit të plotë të studimeve, studenti ka të drejtë të diplomohet me mbrojtjen e një teze diplome ose me provim formimi sipas përcaktimeve që janë bërë në këtë rregullore.

2. Departamentet përcaktojnë listën e temave për diploma në fillim të semestrit të pestë për ciklin e parë të studimeve, në fillim të semestrit të parë për ciklin e dytë të studimeve “Master Profesional” me 60 kredite dhe në fillim të semestrit të tretë për ciklin e dytë të studimeve “Master i Shkencave” me 120 kredite. Ky përcaktim bëhet duke u mbështetur në fushat e studimit që mbulon departamenti. Drejtuesit e tezave të diplomës miratohen nga përgjegjësi i departamentit.
3. Studenti merr përsipër shpenzimet për realizimin e temës së diplomës. Diplomimi bëhet në sezonin e verës (korrik) dhe në sezonin e vjeshtës (shtator). Studentit i lejohet të mbrojë diplomën vetëm mbasi të ketë shlyer provimet e prapambetura.
4. Në rastin e provimit të formimit, mënyrën se si do të përgatiten dhe se si do të zhvillohet tezat dhemodalitete të tjera, duhet të jenë të pasqyruara në rregulloret përkatëse të programeve të studimit.
5. Diploma nënshkruhet nga dekani i fakultetit përkatës dhe rektori i universitetit. Nënshkrimi i rektorit shoqërohet me vulën zyrtare të universitetit.
6. Dorëzimi i diplomave bëhet me ceremoni në Ditën Akadematike të Universitetit të Korçës. Dita Akadematike zhvillohet në muajin korrik, pas përfundimit të vitit akademik. Data përcaktohet me vendim Rektorati. Në ceremoninë e dorëzimit të diplomave marrin pjesë studentët, drejtues të fakultetit, të universitetit, si dhe të ftuar të tjerë.
7. Për studentët që kanë përfunduar studimet me të gjitha notat dhjeta, jepet certifikata “Medalje e Artë”. Për studentët, që gjatë studimeve kanë marrë mbi 70% të notave 10 (dhjeta) dhe pjesën tjetër vetëm 9 (nënta), jepet certifikata “Student i Shkëlqyer”. Studentëve, që në përfundim të studimeve e kanë mesataren e përgjithshme mbi 8, u shënohet emri në Librin e Nderit të Universitetit.

Neni 109 Tërheqja e diplomës

1. Tërheqja e diplomës bëhet nga vetë i diplomuari, i cili nënshkruan dhe evidentohet në regjistrin përkatës. Nëse prania e të diplomuarit është objektivisht e pamundur, tërheqja e diplomës mund të bëhet nga një i afërm, i pajisur me prokurë të posaçme. Në të dy rastet i interesuari duhet të paraqesë dokument identifikimi.
2. Nëse diploma nuk është plotësuar në rregull, i interesuari nuk duhet ta tërheqë atë dhe të kërkojë pajisjen me diplomë të rregullt. Nëse i interesuari e tërheq diplomën e parregullt, në rast se i humbet ose i dëmtohet dhe bëhet e papërdorshme, Universiteti nuk lëshon dublikatë.
3. Për raste tepër të veçanta, lejohet vetëm dhënia e listës së notave të fituara dhe vërtetimi me fotografi, i cili është i barasvlerëshëm me diplomën, pasi të nënshkruhet nga dekani i njësisë kryesore përkatëse dhe rektori i universitetit. Nënshkrimet e tyre vërtetohen me vulën e universitetit.

Neni 110 E drejta e studentit për përmirësim note

1. Studenti ka të drejtë të përmirësojë notat e 2 lëndëve për çdo vit akademik, në rast se i ka shlyer të gjitha detyrimet paraardhëse. Studenti provohet vetëm një herë për përmirësim note dhe vetëm në sezonin e riprovimeve (vjeshtë). Mbetet në fuqi nota me të cilën studentit vlerësohet në fund.

2. Kërkesa për përmirësim note i paraqitet sekretarisë mësimore para sezonit të riprovimeve.

Neni 111 **Detyrimet e studentit**

1. Studenti është i detyruar:
 - a. Të njohë me hollësi rregullat e universitetit dhe detyrimet e tij, të jetë i vetëdijshëm për zbatimin e tyre. Në të kundërt, universiteti nuk mban përgjegjësi për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjohja e tyre.
 - b. Të zbatojë të gjitha rregullat që rrjedhin nga Statuti i universitetit, nga kjo rregullore, si dhe nga çdo akt tjetër ligjor e nënligjor. Të shlyejë të gjitha detyrimet e përcaktuara në planin mësimor dhe programet e lëndëve (moduleve).
 - c. Të zhdëmtojë, sipas rregullave në fuqi, të gjitha dëmtimet e vlerave materiale të kryera prej tij.

Neni 112 **Rastet e shkeljeve dhe masat që merren ndaj studentit**

1. Shkelje të rregullave të institucionit konsiderohen të gjitha veprimet e kryera nga ana e studentit që çënojnë personalitetin e pedagogut apo të çdo punonjësi tjetër të shkollës; normat etiko-morale të shoqërisë, si: kopjimi në provime, falsifikimi i dokumenteve të ndryshme zyrtare, etj; aktet e rrugaçërisë, të vjedhjes etj. Këto veprime, konsiderohen shkelje të rregullave të institucionit, kur nuk bartin elementë të veprës penale.
2. Ndaj studentit që kryen këto veprime, merren këto masa disiplinore:
 - a. vërejtje me shkrim;
 - b. përjashtim nga universiteti për një vit;
 - c. përjashtim nga universiteti.
3. Vendimin për përjashtimin e studentit një vit nga universiteti e merr Dekanati; vendimin për përjashtimin nga universiteti e merr Rektorati i universitetit, mbi bazën e propozimit të Dekanatit.

Neni 113 **Regjistrimi i studentit**

1. Kandidati që shpallet fitues në ciklin e parë, të dytë, ose të tretë Master Ekzekutiv, ka të drejtë të ndjekë studimet në vitin e parë akademik në programin e studimit të kërkuar, nëse regjistrohet në sekretarinë mësimore të fakultetit dhe paguan tarifën e shkollimit sipas afateve të përcaktuara në udhëzimet përkatëse. Në rast të kundërt, ai humbet përfundimisht të drejtën e regjistrimit.
2. Në fillim të çdo viti akademik studentit është i detyruar të regjistrohet në sekretarinë mësimore të fakultetit për vitin në vazhdim brenda muajit tetor dhe të paguajë tarifën e detyrimeve për vitin akademik. Nëse nuk likuidon detyrimet deri në datën **31 janar** të çdo viti akademik, studentit pengohet për të hyrë në provim. Në ato raste kur studentit ka provime para datës 31 janar duhet të paguajë tarifën e shkollimit *një javë para datës së provimit*, ndryshe nuk futet në provim.

3. Kandidati fiton statusin e studentit, pasi ai është regjistruar në sekretarinë mësimore, ka plotësuar të gjitha detyrimet dhe zotëron vërtetimin e regjistrimit. Statusi i studentit përfundon me marrjen e diplomës, me përjashtimin ose largimin e tij nga universiteti.

Neni 114

Ndërprerja dhe rifillimi i studimeve

1. Studenti mund t'i ndërpresë studimet pasi të ketë njoftuar paraprakisht për këtë ndërprerje dekanin e fakultetit përkatës. Ai mund t'i rifillojë studimet para apo pas konsumimit të lejës, në fillim të çdo semestri apo në të njëjtën datë pas së cilës ai është larguar. Në çdo rast duhet të ketë përmbushur të gjitha detyrimet që përmban rregullorja mësimore e programit të studimit që ai vazhdon.

Neni 115

Praktika profesionale

1. Studentët që vazhdojnë studimet në ciklin e parë ose të dytë e kanë të detyrueshme kryerjen e praktikës profesionale, kur ajo përfshihet në planin mësimor dhe strukturën e vitit akademik.
2. Me fillimin e vitit akademik sekretaria e departamentit u komunikon studentëve kohën e kryerjes së praktikës profesionale dhe programin e saj.
3. Studenti që nuk realizon programin e praktikës profesionale u nënshtrohet rregullave të vendosura si për të gjitha veprimtaritë e tjera formuese.
4. Praktikrat profesionale zhvillohen në institucione, ndërmarrje shtetërore ose private, sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e pedagogut të caktuar nga departamenti përkatës. Studenti detyrohet të respektojë rregullat e institucionit ku kryen praktikën profesionale.

Neni 116

Organizimi i praktikës profesionale

1. Pranë çdo fakulteti organizohet dhe funksionon komisioni i praktikës profesionale. Detyrat e tij përcaktohen në rregulloren mësimore të programit të studimit përkatës.
2. Kohëzgjatja e praktikës profesionale është përcaktuar në rregulloren mësimore të çdo programi studimi. Qendrat ku do të zhvillohen praktikrat përcaktohen nga drejtuesit e fakulteteve dhe duhet të jenë të miratuara nga institucionet përkatëse, të cilat duhet të kenë detyrime të kontraktuara me UK-në. Kontrata lidhet për një afat jo më pak se 1 vit.
3. Mënyra e zhvillimit dhe e vlerësimit të praktikës profesionale përcaktohet në rregulloren mësimore të çdo programi studimi.

KREU VIII KËRKIMI SHKENCOR

Neni 117 Kërkimi shkencor në UK

1. UK-ja, në përputhje me legjislacionin në fuqi, kryen veprimtari kërkimore-shkencore, studime, projekte për zhvillim dhe veprimtari të tjera krijuese, duke garantuar integrimin e veprimtarisë kërkimore në atë të mësimdhënies.
2. Veprimtaria kërkimore-shkencore synon të mbështesë zhvillimin e vendit dhe rritjen e cilësisë së arsimit. Nëpërmjet veprimtarisë kërkimore-shkencore personeli akademik dhe studentët fitojnë aftësi për kërkime të pavarura në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm profesional dhe të karrierës akademike.
3. Personeli akademik është i lirë të kryejë veprimtari kërkimi dhe zhvillimi për të tretë, por me kusht:
 - a. plotësimin e detyrimeve ndaj UK-së, sipas marrëveshjes së punës;
 - b. plotësimin e detyrimeve të njësisë përbërëse të UK-së, bazë dhe kryesore, për kërkim shkencor, sipas pikës 1 të këtij neni.

Neni 118 Veprimtaritë kërkimore në UK

1. Kërkimi shkencor, bazë dhe i aplikuar, me interes të gjerë për rajonin, është veprimtari që ndërmerret për të përmbushur misionin e njësisë për kërkim shkencor, sipas standardeve bashkëkohore. Kërkimi shkencor bazë nënkupton studime plotësuese dhe saktësi të mëtejshme për probleme ende të pazgjidhura në fushat e veprimtarisë së njësisë kryesore. Këto studime duhet të synojnë ritmet e zhvillimit teorik bashkëkohor, në koherencë me arritjet në fushat përkatëse, brenda dhe jashtë vendit. Kërkimi shkencor shoqërohet me rinovime teknologjike në fushën analitike, të përpunimit të informacionit etj., për të garantuar cilësinë dhe besueshmërinë e tyre. Veprimtaria kërkimore-shkencore dhe aplikative është pjesë integrale e projektbuxhetit të UK-së për çdo vit pasardhës.
2. Temat dhe afatet e kërkimit, drejtimet dhe vëllimi i punëve përcaktohen nga UK-ja dhe njësitë përbërëse të tij, mbështetur në fushat prioritare të zhvillimit të rajonit dhe vendit, në Planin strategjik të zhvillimit të UK-së, në rëndësinë e kërkimit për arsimimin e studentëve, programet e bashkëpunimit shkencor, aftësimin e personelit akademik, si dhe në burimet financiare në dispozicion.
3. Njësitë kryesore, nëpërmjet strukturës së ngritur për menaxhimin dhe koordinimin e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, hartojnë planin afatmesëm disaveçar të zhvillimit të tyre. Mbështetur në planin e zhvillimit hartohen programet vjetore të veprimtarisë së tyre, duke caktuar e vendosur raporte të drejta ndërmjet mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në përputhje me misionin që ato kanë. Plani i zhvillimit paraqitet në Rektorat dhe miratohet në Senatin Akademik.
4. Njësia bazë, mbështetur në propozimet e asamblesë së saj akademike, si dhe në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2015-2020), përcakton fushat bazë të kërkimit në departament, si dhe prioritetet e kërkimit shkencor në terma afatshkurtër dhe afatmesëm.

5. Mbështetur në prioritetet e kërkimit të caktuara në departament, njësia bazë është përgjegjëse për hartimin e Planit Strategjik të kërkimit shkencor në nivel njësie bazë. Ky plan përgatitet nga grupi i koordinimit të kërkimit shkencor i ngritur brenda njësisë.
6. Plani Strategjik zërthehet në objektiva strategjike, për të cilët parashikohen masa veprimi dhe rezultate të pritshme, që përkojnë me treguesit e arritjeve.
7. Plani Strategjik shoqërohet edhe me planin e veprimit ku përcaktohen afatet, subjektet përgjegjëse dhe kostoja financiare për ato veprimtari që parashikojnë faturë financiare.
8. Grupi i koordinimit të kërkimit shkencor harton planin vjetor të kërkimit brenda muajit shtator të çdo viti akademik.
9. Forma kryesore e realizimit të veprimtarisë kërkimore është projekti. Punonjësit kërkimorë shkencorë të profileve të ndryshme, brenda dhe jashtë njësive bazë të njësive kryesore, janë të lirë të grupohen e të hartojnë projekte në përputhje me fushat e kërkimit shkencor dhe programet publike të zhvillimit të vendit apo sektorëve të veçantë, të ndjekin procedurat e caktuara për shqyrtimin e miratimit të projekteve dhe pas miratimit, të vihen në dispozicion të zbatimit të tyre në kohë e me cilësinë e kërkuar.
10. Grupi i koordinimit të kërkimit shkencor brenda njësisë bazë trajnohet nga Sektori i Projekteve, Kërkimit Shkencor dhe Botimeve për shkrimin e projekteve.
11. Për hartimin e projektpropozimeve me financim nga buxheti i UK-së, ndiqet formati standard i miratuar në rektorat.
12. UK-ja kryen shërbime për të tretë si ekspertiza, analiza, këshillime, monitorime, shërbime informacioni etj. Këto veprimtari kryhen me financime të palëve të interesuara. Të ardhurat nga këto veprimtari shkojnë tërësisht në favor të UK-së.
13. Masa e shpërbimit të personelit pjesëmarrës në këtë veprimtari, përcaktohet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
14. Grupi i koordinimit të kërkimit shkencor brenda njësisë bazë, si dhe njësia për menaxhimin dhe koordinimin e veprimtarive kërkimore-shkencore në fakultet, janë përgjegjëse për vlerësimin e cilësisë së artikujve të propozuar për botim në numrin përkatës të revistës “Buletini Shkencor”.
15. Sektori i projekteve, kërkimit shkencor dhe botimeve është përgjegjës për redaktimin gjuhësor të artikujve të vlerësuar për botim në numrin përkatës të revistës “Buletini Shkencor”, si dhe për çështje të tjera të karakterit teknik, me qëllim plotësimin e standardeve të kërkuara për një botim shkencor.
16. Njësia për menaxhimin dhe koordinimin e veprimtarive kërkimore-shkencore është përgjegjëse për respektimin e afateve të përcaktuara për prokurimin e botimit të numrit përkatës të revistës “Buletini shkencor”, si dhe për dorëzimin e kopjes që i takon çdo artikullshkruesi.
17. Njësia për menaxhimin dhe koordinimin e veprimtarive kërkimore-shkencore është përgjegjëse të dërgojë pranë dekanateve përkatëse në kohën e caktuar, propozimet e çdo njësie për mbulim shpenzimesh nga buxheti i universitetit të veprimtarive të parashikuara në planin vjetor të punës kërkimore-shkencore të njësisë bazë.

Neni 119

Planifikimi dhe vlerësimi i veprimtarive kërkimore

1. Veprimtaritë kërkimore planifikohen mbi bazën e planit të zhvillimit strategjik të UK-së, të programeve dhe projekteve të miratuara, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në

institucionet e arsimit të lartë në Republikën Shqipërisë”, e Planit Strategjik të kërkimit shkencor në nivel njësisht akademike, si dhe akte të tjera ligjore e nënligjore.

2. Kërkesa për financimin e programit vjetor të kërkimit shkencor bazë dhe të aplikuar nga buxheti i shtetit, bëhet nga njësitë kryesore në përputhje me aktet ligjore e nënligjore.
3. Performanca e punës kërkimore e të gjitha llojeve e niveleve vlerësohet nga njësitë bazë e kryesore të UK-së dhe nga Senati Akademik.
4. Procedura e vlerësimit të performancës së punës kërkimore-shkencore përcaktohet në manualin e vlerësimit të veprimtarive kërkimore shkencore në UK-së.
5. Programet e studimeve të ciklit të tretë dhe në masë më të vogël, programet e studimeve të ciklit të dytë, konsiderohen punë kërkimore dhe i nënshtrohen planifikimit.
6. Veprimtaria kërkimore-shkencore në UK rregullohet nëpërmjet Rregullores për Etikën në Veprimtarinë Kërkimore dhe Botuese miratuar me Urdhër Nr. 105, dt. 23.03.2012, të ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

Neni 120

Vlerësimi periodik i veprimtarive kërkimore-shkencore të njërive bazë në UK

Metodologjia dhe kriteret e vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njërive bazë janë përcaktuar në VKM Nr.165, datë 21.03.2018. Njësitë bazë për efekt të procesit të vlerësimit, grupohen sipas fushave e nënfushave kryesore natyrore, inxhinierike e teknologjike, mjekësore, bujqësore, sociale e humane (shtojca 1, VKM-ja e mësipërme). Procesi i vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njërive bazë realizohet çdo katër vjet nga AKKSHI, në përputhje me kriteret e mëposhtme:

1. Kriteri bibliometrik:

- a. Lista e artikujve të botuar në revista ndërkombëtare shkencore me faktor impakti, si dhe në revista akademike ndërkombëtare të indeksuara dhe të recensuara;
- b. Lista e artikujve të botuar brenda vendit në revista shkencore dhe buletine shkencore të njohura nga MASR-ja;
- c. Lista e monografive shkencore të botuara brenda vendit, të vlerësuara si punime shkencore nga njëria bazë;
- d. Lista e kapitujve të librave akademikë, të redaktuar, të recensuar dhe të botuar në vendet e BE-së, OECD-së dhe G20-ës dhe të vlerësuara si punime shkencore nga njëria bazë;
- e. Lista e kapitujve të librave akademikë, të redaktuar, të recensuar dhe të botuar brenda vendit, si dhe të vlerësuara si punime shkencore nga njëria bazë.

2. Kriteri i impaktit të veprimtarisë kërkimore-shkencore:

- a. Lista e patentave apo e shpikjeve të regjistruara pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Intektuale apo autoriteteve të huaja;
- b. Lista e projekteve kërkimore-shkencore të fituara nga programet kuadër të BE-së për kërkim shkencor, si koordinator projekti ose si partner në projekt;
- c. Lista e sipërmarrjeve të reja, të krijuara si rezultat e punës kërkimore-shkencore të njërive bazë;
- d. Lista e kontratave të shërbimit me objekt studimor.

3. Kriteri infastruktural:

- a. Lista e laboratorëve shkencorë të akredituar ose jo;
- b. Lista e bibliotekave të profilizuara dhe kapaciteti fizik i tyre, i shprehur në vende/poste pune-kërkimi;
- c. Lista e arkivave dhe e koleksioneve shkencore;
- d. Lista e abonimeve në revista apo e botimeve shkencore periodike, përfshirë edhe ato elektronike.

4. Kriteri i kapaciteteve njerëzore:

- a. Lista e personelit akademik të njësisë bazë me tituj akademike: "profesor", "profesor i asociuar", "lektor" dhe "asistent lektor", me kohë të plotë, në momentin e deklaramit;
- b. Lista e konferencave shkencore ndërkombëtare të organizuara nga njësia bazë në bashkëpunim me homologët e saj, në vendet e BE-së, OECD-së dhe G20-ës;
- c. Lista e konferencave shkencore kombëtare të organizuara nga njësia bazë;
- d. Lista e pjesëmarrjes së personelit akademik të njësisë bazë, me referime shkencore, në konferenca shkencore ndërkombëtare në vendet e BE-së, OECD-së dhe G20-ës;
- e. Lista e pjesëmarrjes me referime shkencore të personelit akademik të njësisë bazë në konferenca shkencore kombëtare;
- f. Lista e çmimeve ndërkombëtare shkencore të fituara nga personeli akademik i njësisë bazë në vendet e BE-së, OECD-së dhe G20-ës;
- g. Lista e çmimeve kombëtare shkencore të fituara nga personeli akademik i njësisë bazë;
- h. Lista e programeve të "Master ekzekutiv", "specializime afatgjata në mjekësi" dhe "doktoratë";
- i. Lista e personelit akademik të njësisë bazë, anëtarë në komitetet ose bordet shkencore të revistave shkencore periodike në vendet e BE-së, OECD-së dhe G20-ës;
- j. Lista e personelit akademik të njësisë bazë, anëtarë në komitetet ose bordet shkencore të revistave shkencore joperiodike në vendet e BE-së, OECD-së dhe G20-ës;
- k. Lista e personelit akademik të njësisë bazë, anëtarë në komitetet ose bordet shkencore të revistave shkencore vendase, të njohura nga MASR-ja;
- l. Lista e personelit akademik të njësisë bazë, anëtarë në komitetet ose bordet shkencore për botime shkencore joperiodike vendase;
- m. Lista e personelit akademik të njësisë bazë, anëtarë të komiteteve shkencore të konferencave shkencore ndërkombëtare, të organizuara në vendet e BE-së, OECD-së dhe G20-ës;
- n. Lista e recensuesve nga personeli akademik i njësisë bazë për artikujt shkencorë të botuar në vendet e BE-së, OECD-së dhe G20-ës;

5. Kriteri i ndërkombëtarizimit:

- a. Lista e studimeve dhe kërkimeve lëndore ose ndërdisiplinore të aplikuara me partner të vendeve të BE-së, OECD-së dhe të tjerë;
- b. Lista e personelit akademik të njësisë bazë, të angazhuar në institucionet e arsimit të lartë të vendeve të OECD-së dhe BE-së, e matur person/në javë;
- c. Lista e personelit të huaj akademik të njësisë bazë nga vendet e OECD-së dhe BE-së, të ftuar pranë njësisë bazë, e matur person/në javë;

- d. Lista e programeve të studimit për “Master i shkencave” dhe të ciklit të tretë, të përbashkëta me IAL-të e huaja nga vendet e OECD-së dhe të BE-së, që përfundojnë me lëshimin e një diplome të përbashkët apo të dyfishtë.

Neni 121 **Organizimi i vlerësimit**

1. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) organizon, administron, monitoron dhe publikon rezultatet e procesit të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë. Vlerësimi për çdo tregues që përbën kriteret e vlerësimit, në nivel njësie bazë, realizohet nëpërmjet një sistemi pikëzimi algoritmik, në mënyrë automatike nga platforma elektronike, Sistemi Shqiptar i Informacionit të Kërkimit Shkencor–ACRIS.
2. UK-ja pas marrjes së njoftimit nga AKKSHI, njofton dhe vendos afate për personelin akademik të njësive bazë, që të realizojë procesin përkatës të plotësimit të të dhënave të kërkuara, në portalin “Vlerësimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore”, në platformën ACRIS.
3. Drejtuesi i njësisë bazë udhëzon, monitoron dhe ndjek të gjitha vetëdeklarimet e të dhënave të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësisë bazë, duke kërkuar nga të gjithë anëtarët përgjegjshëmri në plotësimin e informacionit, sipas kriterëve të përcaktuara në portalin “Vlerësimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore”.

Neni 122 **Detyrat dhe përgjegjësitë gjatë procesit të vlerësimit periodik të kërkimit shkencor**

Drejtuesit e njësisë bazë dhe të njësisë kryesore në UK gjatë procesit të vlerësimit janë:

- a. Të caktojë një person kontakti brenda njësisë bazë që të ndjekë procesin e realizimit në afat të vlerësimit;
- b. Të koordinojë, të monitorojë dhe të ndjekë procesin e hedhjes së të dhënave nga personeli akademik i njësive bazë brenda afatit të përcaktuar.

Neni 123 **Organizimi i procesit të vlerësimit periodik të kërkimit shkencor**

1. Anëtarët e personelit akademik të njësisë bazë do të kenë akses individual të përdoruesit të kodifikuar dhe të mbrojtur, për vetëdeklarimin e veprimtarisë kërkimore – shkencore të drejtimeve kryesore të fushave të kërkimit dhe të disiplinave specifike.
2. Drejtuesi i njësisë bazë ka akses individual të përdoruesit të kodifikuar dhe të mbrojtur që shërben për ndjekjen dhe monitorimin e të dhënave të deklaruara nga anëtarët e personelit akademik të njësisë bazë.
3. AKKSHI është përgjegjëse në bashkëpunim me Qendrën Ndërinstitucionale të RASH-it për administrimin e portalit, sigurimin dhe ruajtjen e të dhënave të publikuara, zbatimin e standardeve të përgjithshme të vlerësimit dhe certifikimin e rezultateve të vlerësimit.

KREU IX
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 124
Rregulloret e Fakulteteve

Rregullimi i mëtejshëm i të drejtave dhe detyrimeve të organeve dhe autoriteteve drejtuese të fakulteteve në përputhje me Statutin e UK-së dhe këtë rregullore, do të bëhet nga rregulloret e fakulteteve dhe të njësisive të tjera, të cilat hartohen nga fakultetet përkatëse dhe miratohen në Senatin Akademik.

Neni 125
Interpretimi i Rregullores

Të drejtën e interpretimit përfundimtar të Rregullores e ka rektori i Universitetit “Fan S. Noli.”

Neni 126
Miratimi dhe ndryshimi i Rregullores

Rregullorja e Universitetit “Fan S. Noli” miratohet dhe ndryshohet nga Senati Akademik.

Neni 127

Kjo Rregullore e shtrin veprimtarinë duke filluar nga viti akademik 2018-2019.